

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-32  
A64

SOTIR  
ANDONI

TROKTHET  
E KUAJVE  
NEPER NATE  
tregime

821.885-32

884-32  
A64

SOTIR ANDONI

# TROKTHET E KUAJVE NËPËR NATË

(Tregime)



188

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



1889 APRIL 3 AM 3 PM

1910 AGO 11

1911

## NËNOLJA DHE UNË

Kur vajzat e reja në fshatin tim, nuk pëlqenin të merrnin për burrë këtë apo atë djalë, nënët dhe plakat e kishin gati mu në majë të gjuhës një fjalë, që e dëgjoja thua jse përditë:

— Pse?! E ç'të bëmë ty?! Dabake!

Por edhe kështu vajzat nuk përkuleshin lehtë, aq më shumë sepse mendimet dhe vendimet e tyre nuk donin, tua nënshtronin plakave dhe tezeve, por më fort dëshirave të veta, jo më pak edhe atyre vështrimeve: dhe këngëve të hedhura dhe të pri-tura që dëgjoheshin nëpër dasmat dhe nëpër arat ku prashitej misri, apo ku korrej gruri.

Sidoqoftë Dabakja që mbahej aq shumë nëpër go-jë, ishte për mua një grua e çuditshme, grua e mbetur qyqare e pa njeri, e cila me sjelljet dhe me jetën që bënte vështrohej si një përjashtim.

Ajo ishtë veshur murgeshë nuk e di që në ç'kohë, u shërbente shenjtorëve në kishë duke ndezur dhe duke shuar qirinj, mbante në shtëpi një farë alipsani, për të cilin thoshte se ishte nga koc-kat e një shenjtori dhe e përdorte këtë alipsan për

të shëruar të sëmurët. Dabakja hapte varret pér të vdekurit, mbante kyçet e kishave por... ajo që ngjallte kureshtjen dhe habinë time më të madhe ishte pasditja e çdo të premteje! Nër këto pasdite të lemerisura pér mua, gjithë rruga ku ishte shtëpia jonë nuk gjente prehje dhe qetësi! Dabakja, prifti i fshatit dhe psallti i kishës, mblidheshin kokë më kokë dhe qanin e vajtonin aq me të madhe, sa disa herë mua më dukej sikur atje ishin mble-dhur maçokët e gjithë fshatit, kishin futur kokët nëpër disa vorbe të mëdha dhe cirreshin e ulërinin! Por nuk ishin maçokët ata që qanin, ishin njerëz si ti e si unë që qanin me kuje pér Jesu Krishtin, i cili na qenkësh kryqëzuar bashkë me dy vrasës dhe katilë që këtu e njëmijë e nëntëqind e sa vjet më parë!

Këto vajtime e ofshamje mund të vijonin edhe gjer sot e kësaj dite, sikur të mos dilte ndonjë fshatar i cili, duke mbajtur faqen me dorë, kërkonte psallt Simeonin pér t'i shkulur dhëmbin e prishur. Sepse Simeoni kishte një darë të madhe dhe një zanat të rrallë. Ai u shkulte dhëmbët njerëzve në të gjitha fshatrat anembanë, e bënte këtë pa kurrfarë bari, por vetëm duke përdorur kanxhat e hekurta të darëve bashkë më disa psallme dhe lutje kishëtare, të cilat medoemos e zbutnin dhembjen. Darët e Simeonit vetëm pér dy punëra hynin në veprim: Pér të shkulur dhëmbët dhe pér të kurdisur sahatin e vjetër të Dabakes! Ky sahat i saj i murit, me një fushë laramane e të ndotur me njolla vaji e nafte, punonte vetëm po ta mbaje përmbyss dhe, meqenëse nuk i kishte mbetur asnjë nga vidat e pasme, merrte revan të punonte ende, vetëm e vetëm kur zemberekun e tij e përmblidhte psallt Simeoni me da-

rën e tij të rrallë dhe profesionale! Sa për rastet e dendura, kur sahati i Dabakes ngekte fare, akrepët e tij çoheshin në vend me ndihmën e gishtit dhe të zotit!

Dabakja ka hyrë në jetën time jo vetëm sepse ishte fqinjë dhe i kishim shtëpitë ngjitur e thua jse njëra mbi tjetrën, ajo ka hyrë në jetën time sepse tri herë me radhë, kur isha i vogël, kishin ardhur engjëjt krahëdritë që të më merrnin për në mbretërinë e amëshuar, por... Dabakja ua kishte vënë «sinorin te thana». Ajo më kishte dhënë të pi ja ujë kroi të shkuar nëpër kockat e verdha të alipsaneve të saj dhe... vdekje ndal! Engjellushet krahëdritë ja kishin mbathur vrapt duke e lënë të qetë të përpëlitez në shtrat një farë vocërraku malarik, i cili e kishte barkun si daulle, qafën sa një fije spangoje dhe mendjen çamarroke, të mprehtë dhe tinzare, që e kishte fare të lehtë të përfytyronte dhe të shpikte këngë e përralla sa habiteshin të gjitha plakat e fshatit.

Këto që them janë fare të vërteta, por do të ishin të meta dhe gjysmake sikur të mos tregoja edhe pjesën e dytë të lidhjeve që patën të bëjnë me jetën time dhe të Dabakes.

Thuhej se Dabakja në të ri të saj paska qenë një vajzë e bukur. Pastaj në shtëpi i ra lëngjyeri, të cilin sot e quajnë tuberkuloz dhe ja rrëmbeu nga kjo jetë një nga një të gjithë njerëzit e shtëpisë. Kështu që nga dëshpërimi Dabakja u lëshua pas fesë dhe u vesh murgeshë. Kishte një kopësht të gjerë mbjellë me ftonj, kopshtin e punonte vetë, ftonjtë i ndante për shpirtërat e të vdekurve të saj, kurse kur ishte në moshën tridhjetë vjeç thoshin: «i krisi një dërrasë». Unë, që asaj kohe isha tepër

i vogël, mendoja se «dërrasa e krisur» duhej me-doemos të ishte ajo e dollapit të madh, ku Dabakja mbante ato ftonjtë e mëdhenj e verdhashë.

Kur mosha e Dabakes nisi të merrte të tatë-pjetën, murgesha jonë mundohej me mish e me shpirt të gjente një vajzë, së cilës do t'i linte trashëgim shtëpinë, kopshtin dhe livadhin, shërbimet e kishës, kazmën, me të cilën hapeshin varret e të vdekurve si edhe atë erën e tharme të temjanit, të alipsaneve dhe të qirinje të djegur. Dhe rasti i kërkuar... erdh!

Motra e babait tim, Sofia, ishte atëhere jo më shumë se nëntmbëdhjetë vjeç. Ishte një vajzë e bukur me ca sy të mëdhenj e rrumbullakë që, kur më shihnin mua, nuk di përse merrnin një pamje më të ndritur. Një e dy dhe Sofia (e thërrisin edhe Sofika) më rrëmbente në krahë, më puthte faqet e gushën, pastaj m'i puthte një pér një sytë e majën e hundës sime, që të them të drejtën nuk e kisha aspak të vogël. Dashuria e teto Sofikës pér mua ishte aq e madhe, sa ajo nuk lodhej kurrë duke vë-në në vend tekat e mia, ajo s'lodhej duke më tre-guar përralla e vjersha, ajo më merrte në krahë dhe më çonte atje ku të më shkrepej mua. Por ja se një ditë prej ditësh, nuk di se ç'ka ndodhi e ç'ka u tha, por Sofika jonë ja plasi një të qare e një vajtimi me dënesa, që unë s'kisha se si ta shpjegoja. Dëgjoja se si mundoheshin ta ngushëllonin njerëzit e shtëpisë, e ca më shumë nëna ime, por më kot. Ajo rrinte e struktur në katoin e errët duke mbajtur njérën dorë pas kadës së madhe të turshive dhe... qante e qante e s'kishte të mbaruar.

Pastaj mësova se Sofika jonë, ajo tetoja ime e dashur dhe e dhembshur ishte goditur keq mu në

zemrën e saj prej vajze. Sofika na ishte e fejuar me djalin më çapkën të fshatit. Por ky djale capkën kishte shkuar në kurbet, ashtu si shkonte rëndom asaj kohe rinia mashkullore e fshatit. Aty në mërgimin e largët, ky çapkëni i fshatit tonë na ishte njohur me një vajzë lesviane, këngëtore e lozonjare që ja kishte çartuar mendjen dhe e kishte bërë të harronte edhe fshatin, edhe zakonin, edhe besën edhe teton time fatkeqe.

Te trari përpara shtëpisë sonë, unë dëgjoja pleqtë e mëhallës tek kuvendonin e çanin dërrasa:

— A s'kam thënë unë oreë, vëndi i huaj të josh e të prish?

— Ç't'i bësh fukarallikut, vëllaaa!

— Ç'është e drejta, femra të bukura ka atje në Lesvo, bëj hesap, isha një herë...

— S'di ç'mund të thoni, or vellezër, — u hodh e foli më i riu nga pleqtë — asnjë vit s'ka shkuar që kur isha vetë në Lesvo. Dhe atë çupën që ja prishi mendjen çapkënit e kam parë vetë! E jo Tole të ishe, e jo dhespot të ishe... po... besa besën edhe patrik i Stambollit të ishe, ta prishte terezinë e kokës.

Dyzet ditë e dyzet net tetova ime e bukur as hëngri, as piu e as vuri gjumë në sy. Sa vinte tretej e drobitej. Kur i flisnin dhe e këshillonin, ajo vetëm një fjalë thoshte:

— Lërmëni! Lërmëni!

Ja, ishte ajo kohë kur hyri në mes Dabakja fqinjë dhe e ktheu përbysë të gjithë jetën e tetos sime fatkeqe. Sofia u vesh me të zeza, hodhi edhe një shami ca më të zezë mbi kokë, lutej e falej gjithë ditën, pastaj dalëngadalë, filloi të bashkohej edhe

ajo në ato ulerimat e të premteve kur logoritej dhe lemerisej krejt mëhallë jonë.

Pastaj fare papritur një tjetër tërmet në shtëpinë tonë. Thanë se erdhi e kërkoi dorën e Sofikës një djalë i ri, që sapo ishte kthyer nga mërgimi.

Atëhere plasi në shtëpi një sherr e një shamatë që s'kishte ndodhur kurrë ndonjëherë. Të gjitha grattë, nuset dhe vajzat u ngritën kundër Sofikës, sepse kjo nuk pranonte kurrsesi që të martohej. Bënte ç'bënte, binte më gjunjë përpara ikonave, gjunjëzohej në metani e falej, pastaj ngrinte kryet, i dukej fytyra tashmë e zverdhur dhe sytë ca më të mëdhënë dhe fliste:

— Lërmëni! Lërmëni!

U munduan ta sillnin Sofien në rrugë të mbarë, u munduan me fjalë e me të lutura, provuan me kërcënime dhe me të shkulur flokësh, por më kot, ajo një fjalë dinte:

— Lërmëni! Lërmëni!

Në ditë të tilla, kur zemra ime prej kalamani nuk donte të dëgjonte zënka e grindje, ikja poshtë në katua dhe hidhja kovën në pus. Zhurmat e kovës ishin të dashura për mua dhe më pëlqenin, kurse përfytyrimi im ndizej dhe e mbante frymën thellë atje në fund të pusit... Për atje kisha dëgjuar të thuheshin disa skena fantastike, të cilat e tërbonin fare përfytyrimin tim në një masë të tillë, sa më dilnin edhe natën në èndërr.

Si e thashë, unë asaj kohe isha fare i vogël, aq i vogël, sa i bija maces me lugë. Por në atë moshë më tërhiqte fort pusi ynë i madh që e kishim në katojn e poshtëm të shtëpisë. Anash katoit ishin edhe dy bodrumë me fare pak dritë. Atje hynte shpeshherë nëna ime duke trokëllitur një tufë me

zinxhirë dhe prej andej dilte gjithnjë një erë e mirë prej gjize të kripur dhe prej domatesh të vëna turshi. Pusi kishte një kokë të madhe prej guri të lëmuar, mbi të cilin dalloheshin gjurmët që qindra vjet me radhë kishin gërryer zinxhirët e kovave, apo të vedrave. Përmbi grykën e pusit vendosej një dërrasë e rëndë që quhej kapak, i cili mbante erë dëllinje.

Pra kisha shumë qejf ta hidhja kovën në pus dhe kështu dy-tri herë në ditë zbrisja atje. Pasi e hidhja kovën, tundja litarin disa herë, gjersa ndjeja në krahët e mi të njomë një farë rëndimi. Pastaj duke i shtrënguar me forcë ata pak dhëmbë që kisha, duke shtrënguar muslat e njomë, e tërhiqja, e tërhiqja. Kova fërkohej pas gurëve të mureve të brendshme të pusit, lëshonte disa zhurma shumë të dashura për mua, lëshonte aty-këtu edhe disa gllënka uji që zbrisnin tatëpjetë duke shkaktuar disa kërkëllima që i kujtoj me mall e dashuri edhe sot e kësaj dite.

Por jo më kot unë shkoja te pusi. Unë shkoja, sepse më kishin thënë se në atë pusin tonë dikur kishte hedhur kovën vetë Ali Pasha i Janinës! Po... kur e kishte nxjerrë kovën, në vend që ajo të ishte me ujë... ajo na kishte brenda vetë të Bukurën e Dheut! Dhe kjo e Bukura e Dheut na paskësh qenë fati i Aliut të Janinës. Dhe kësaj së Bukurës së Dheut na i thënkeshin emrin CILE! Dhe kjo Cilja e bukur, jo si e dalë nga pusi, po si e rënë nga qielli, na paskësh pasur ca sy aq të ndritshëm, aq të thellë, sa medoemos të kujtonin thellësitë e pusit ku edhe xixëllimat nuk mungojnë. Por, me të dalë në dritë, kjo Cilja na e paskësh kuptuar: se na qenkësh për t'u martuar me Aliun e Tepelenës. Por sa i qe afruar pa-

shait, i kishte mbajtur erë duhan dhe nargjile! Dhe me t'i ardhur era duhan, na paskësh dashur të hynte përsëri në fund të pusit... nuk deshte burrë që të pinte duhan. Atëhere Aliu mjekërbardhë e mjekërgjatë kishte nxjerrë nga këllëfi shpatën e tij të madhe dhe... Cilja e bukur dashur, padashur i qe shtruar fatit të vet! Dhe, pasi ky Ali Pasha e kishte mbajtur për nuse, njerëzia ndër ne na i këndonte kësaj Ciles një këngë! Dhe kjo kënga e bukur që hidhej valle ndër ne edhe kur unë u rrita, na thënkesh kështu:

«*Në sheshet në puset  
janë mbledhur nuset!  
— Cile, ku ma hëngre drekën?  
— Leskovik të shkretën!  
— Cile, ku ma hëngre darkën?  
— Gju më gju me Ali Pashën!»*

Por më vonë unë mësova se kjo Cilja e këngës, kjo Cilja e Aliut, na paskësh qenë vetë Vasiliqia, zemerbardha e zemërmadhja, e lindur dhe e rritur prej një néné e një babe, çamër që të dy, që dinin dhe që flisnin vetëm shqipen si ti e si unë vetë!

Kështu që unë, kur isha i vogël, përfytyroja Vasiliqinë ndenjur gju më gju me Ali Pashain mu atje në mes të oborrit tonë nën ato kanatet e vjetra të dritareve tona që asaj kohe nuk kishin njojur xhamë, por vetëm disa copëra dërrasash që uleshin e ngriheshin si qepena.

Midis Aliut dhe Vasiliqisë së bukur, në mes të pëqireve të tyre, kishin një sepet të bardhë prej atyre që shisnin ndër ne kurbatkat ezmere e lozo-njare. Në këtë sepetin e bardhë kishte bukë gruri

gatuar me thelpinj arre. Aliu dhe Cilja hanin drekën dhe mjekra e bardhë e pashait arrinte gjer te kraharori ca më i bardhë i Vasiliqisë që kishte dalë nga ujërat e pusit tonë!

— O nëne!  
— Bir i nënës!  
— Po kjo Cilja a kishte motra, moj?  
— Po kishte, o të keqen!  
— Po ç'u bënë motrat e Ciles, o nëne?  
— Po janë gjithnjë atje në fund të pusit tonë,  
o bir, presin radhën e fatit të tyre, o bir. Ti hap  
sytë, se s'është çudi dhe fap... të del ndonjëra në  
kovë edhe ty vetë!

— Më del, o nëne?  
— Të del, o të keqen! Një ditë i ka dalë një  
xhaxhait tënd, atij që ka shkuar kurbet, në Vllahi,  
por xhaxhanë e pa me cigare mbi buzë dhe... fap,  
hyri sérish në fund të pusit!

— Po xhaxhai a s'kishte pallë si Aliu i Janinës?

— Po pallë të atillë ka pasur vetëm Ali Pasha,  
biro, prandaj të keqen nëna, ti të mos vësh cigare  
në gojë, jo si ca malukatër që, pa dalë nga djepi,  
ndezin cigare me xhufkë misri!

Gjer këtu dhe në kokë m'u ndez një mendim  
tjetër. Ja thashë nënës:

— Po vëllezër a kanë ato të Bukurat e Dheut?  
— Kanë posi.  
— Po sikur, o nëne, sikur të më dalë vëllai i  
Vasiliqisë dhe t'i japim për nuse tetë Sofikën tonë?  
Kurrë s'mund ta merrja me mend tallazin që  
plasi në shtëpi!

Teto Sofia u vërsul dhe më kapi për gryke. Me

siguri që sytë e mi do të kishin kërcyer përpjetë si pofka, sikur të mos më ishin lëshuar në ndihmë të gjithë njerëzit e shtëpisë. Dhe dashuria dhe miqësia prej gjaku e prej fisi që kisha me teton mori fund njëherë e përgjithnjë.

\*  
\*      \*

Erdhi pranvera! Gjerdhet e thata që mbanin erë myk ajo i veshi e i mbuloi me bisqe të njoma. Hodhën shtat kërcinjtë e mollëdheut, u rrit bari dhe, si legëtyra të trasha u gërshetuan nëpër hunjtë trëndafilat e butë. Dhe i gjithë ai shpërthim i natyrës krijoj fole dhe labirinte të gjelbëra, ku strukeshin bilbilat e gërgisnin njëri-tjetrin. Kënga e tyre më bënte ta harroja urinë unë, që asaj kohe haja dhjetë ngastra misrnikë brenda një dielli. Dallëndyshet na u derdhën nëpër fshat duke sjellë cicërimat e tyre bashkë me shembëlltyrën më të gjallë se si punohej për të ngritur shtëpinë. Fati i mbarë m'u duk se trokiti edhe në portën tonë. Dy dallëndyshe bishtgérshëra e sqepgjilpëra na hynë në shtëpi dhe nisën ta ndërtonin çerdhen në tremën tonë! Sa me gaz e me brohori e kam pritur ardhjen e tyre. I numëroja sa herë hynin e sa herë dilnin, numëroja sa herë sillnin fije bari e sa herë sillnin cikërima balte. Por numëroja gjer më dhjetë, e pastaj filloja nga e para, sepse përmbi dhjetën nuk dija të numëroja. Isha te pusi, me kovën varur tatëpjetë dhe me mendjen te foleja përpjetë kur... ngjau diçka e egër dhe e papritur! Teto Sofia jonë, e veshur kokë e këmbë me rroba të zeza, qëlloi me fshesë çerdhen fatkeqe

të dallëndysheve! Balta e njomë u përplas në dysheme, ajo spërkatë dhe surratin e tetos sime dhe shembi përgjithnjë ëndrrat e mia pér të parë zogjtë e vegjël të dallëndysheve! Oh, sa shumë kam qarë asaj dite! U gajasa aq fort, sa më dhembnin ijet dhe zëri m'u ngjir! Kur Dabakja e gjeti të udhës që të më sillte pranë alipsanet dhe të më afronte te goja një kupë ujë të shkuar nëpër to, nuk di se ku e gjeta fuqinë dhe lëshova një shqelm të tillë, që nuk e kisha lëshuar kurrë ndonjëherë gjer asaj dite. Dhe përsëri plasi sherri e shamata në shtëpi. Nëna u përfyt keq me tetë Sofien, unë pashë disa skena tepër të shëmtuara kur ato të dyja i vërsuleshin njëra-tjetërës me thonj dhe me dhëmbë duke pasur të lëshuar gjer poshtë flokët e tyre.

Kur më gufone kraharori nga gajasja, pyeta nënën:

— Po përse u bë kaq e ligë tetë Sofia, o nëno?

— Se ashtu e mëson Qoftëlargu! Mbaroi ajo, u bë nënole!

— Po pse më shan e më mallëkon mua, o nëne?

— Se e ka gjuhën gërmotërë!

Kisha dëgjuar se gërmotëra ishte një gjemb i keq që, kur të shponte, të enjtej dhe të digje vendi një javë të tërë. Dhe e përgjoja nënolen tonë kur hante bukë, e përgjoja që t'i shihja gërmotëren në majë të gjuhës, por më kot. Nuk ja shihja dot. E pyeta nënën time pér këtë hetimin tim, por ajo ma ktheu:

— Vetëm kur të qeshë, vetëm atëhere i duket gjembi!

Por tashmë nënolja jonë nuk queshte kurrë dhe unë kurrë nuk pata rastin t'ja shihja gërmotëren në

majë të gjuhës. Vetëm mësova një këngë, e cila m'u duk se kishte të bënte me teton time:

«Kjo ime kunatë, një e hollë e gjatë,  
një e hollë e gjatë, nga goja afratë,  
nga goja afratë, nga gjuha lopatë!»

Edhe më vonë erdhën djem e trokitën në portën tonë për dorën e Sofies, por më kot. Atëherë filluan të flisnin se nënolja jonë kishte shtënë dashuri pas engjëjve, pas të vdekurve. Filluan të thoshin se ajo mbante erë temjan dhe qirinj të djegur. Kur nuk e kthyen dot në rrugë të mbarë, nënolja jonë nisi për çdo të premte të merrte pjesë në të qarat për Jesu Krishtin në shtëpinë fqinjë të Dabakes.

E quditshme ishtejeta ime asaj kohe! Nga njëra anë dëgjoja këngët e bukura për Vasiliqinë e për Isuf Arapin, këngët për Marko Boçarin, këngë për lindjet e këngë për dasmat e pastaj... pastaj psallme dhe të qara!

Ishë ajo kohë kurjetaime mori një kthesë krejt të papritur. Te fqinjët tanë përballë shtëpisë sonë erdhën disa miq nga një fshat i largët. Ishin burrë e grua dhe na kishin një vajzë të vogël në moshën time. Dhe kësaj vajzës së vogël, na i kishin vënë një emër të bukur dhe e quanin Lola. Dhe kjo Lola e vogël ishte aq e bukur, sa mua më shkoi mendja se kjo duhej të ishte motra e Vasiliqisë. Kjo duhej të kishte dalë nga ujërat e pusit tonë!

Me Lolën unë u njoha shpejt e shpejt, ashtu si njihen fëmijët; pa pyetur për shëndetin e për

emrin apo mbiemrin, pa pyetur për fisin dhe pa i dhënë dorën njëri-tjetrit.

Kështu që ne me Lolën dilnim e shëtisnim nëpër fshatin tonë, bridhnik anash arave nga kishte kumbulla me lëng të embël, përgjonim qyqet kur këndonin dhe bënim me qindra e qindra lodra foshnjarka, ashtu si keni bërë edhe ju të gjithë kur ishit si unë dhe si Lola ime. Veç nga shtëpia e Dabakes nuk e çova kurrë. As për teto Sofien nuk i tregova, as përsë ajo ishte veshur në të zeza. Veç te pusi ynë e çova dhe ia tregova. Dhe kur ajo nuk desh kurrsesi të afrohej te gryka e gurtë, atëhere m'u mbush mendja se ajo vërtet prej andej kishte dalë. Dhe unë tanë kisha frikë se mos i dilnin të motrat, zgjatnin duart e tyre të gjata me llërët e bardha dhe ma rrëmbenin!

Asaj nate unë pashë edhe një èndërr! Në këtë èndërr m'u duk vërtet sikur e nxora Lolën nga vedra jonë e pusit! Dhe në mëngjez zura të vrisja mendjen dhe s'i bija dot në të; a vërtet pashë èndërr, apo me gjithë mend e nxora Lolën nga kova e pusit?! Përt'i rënë punës në të, e çova edhe një herë Lolën te pusi ynë atij mëngjezi. Por nuk di sesi ndodhi dhe Lola u struk pas meje dhe nisi të qante. Unë ndjeja në kraharon dridhjet e trupit të saj të brish-të, por më vinte të qaja edhe vetë. Por në fund të fundit unë nuk qava, sepse nuk më lanë ato kundërmimet e trëndafilave e as era e bozilokut që vinin në katua nëpër atë portën e gjerë nga hy-nin për të mbushur ujë të gjitha çupat e mëha-llës.

Por vetëm dhjetë ditë dhe pastaj kaloi përgjith-një ajo lumturia e parë e jetës sime. Kur u zgjova një mëngjez e dola të kérkoja Lolën, ajo nuk ishte

më. Unë më kot e kërkoja dhe më kot fillova të qaja, më kot ngula këmbë dhe më kot nisa të cirresha e të vajtoja. Kur njerëzit e shtëpisë u shtruan të hanin drekë, unë qaja e s'kish burrë e as grua që të më pushonte. Qaja i gajasur dhe dënesat më mbyt-nin grykën. Nëna u merakos se mos shtihesha në sëmundje dhe m'u lut nga zemra që të pushoja. Unë pushova, por jo nga lutjet e nënës. Heshta vetëm, sepse filloi të më dhembte kraharori. Në një çast të tillë, kur i vogli ha fjalë e kuvend, nëna më pyet:

— Po pse e do kaq shumë këtë Lolë, more bir?

Unë atëhere ja ktheva me fjalë të shkëputura, të sakatuara e gjysma-gjysma, nga dënesat që më zinin grykën.

— E dua, o nëne, se e kam në zemër!

Një e thënë e këtillë shkaktoi aq të qeshura e gaz në shtëpi, sa unë nuk dija se si ta shpjegoja. Veç një njeri nuk qeshi. Dhe ky njeri ishte nënolja! Pastaj, fjalë pas fjale, nëna ime dhe Sofia u kapën përsëri, njëra hidh e tjetra prit, gjersa sherri u poq dhe u vijua me një përlleshje e me disa sharje, të cilat më bënë që t'i hyja edhe më thellë gjuhës amëtare.

Atëhere nëpër një rrëmujë të tillë, nuk di se kush më mori e më shtriu të flija, jo në ndonjë shtrat, as në ndonjë kënd. Më futën të flija në qosh-kun më të errët të dollapit të madh ku mbanim velenxat e rënda prej leshi. Atje mbante erë finjë dhe erë dërrase të thatë prej panje.

Kur u zgjova, e kisha gojën të hidhur helm, shpirtin të ngrysur dhe isha tepër i mërzitur. Dola përsëri në oborr e, sapo hodha sytë nga pusi, lotët më rrodhën përsëri. Pastaj u ula në një qoshe dhe fi-

llova tē qaja ngadalë, fshehtazi e shtruar, si shi vjeshte. Mu nē krye tē oborrit, nē skajin mē tē thellë tē korridorit, ishte ulur nënolja jonë, Sofia, veshur e tēra nē tē zeza dhe nuk di se ç'ka po endte nē avlémend. Por penjét e fijet i qenë ngatërruar, sovajkat i hidhte dhe i pérplaste me duf, disa herë kafshonte buzët, grindej me vetëveten, shahej e pastaj mē vështronte mua me aq mëri e inat, sa egër-sinë e syve tē saj nuk dija se si ta shpjegoja. Ajo, dy-tri herë m'u vërsul me kanosje:

— Pusho, mor noprani!

Fjalën «noprani» unë s'e kisha dëgjuar gjer atë-here dhe pandeha se ishte sharja më e rëndë, që s'duhej duruar nē asnë mënyrë. Kështu që shtrën-gova dhëmbët, u kreksa paksa dhe ja ktheva në-noles:

— Po... kur qan ti me ata priftërinjtë e tu e me Dabaken... gjuhë gërmotërë!

Në çast ajo kërceu me inat nga froni i avlë-mudit. Po me aq vrull e nxitim, sa nëpër atë fus-tanin e saj tē stërmadh e tē zì iu dukën dy gjunjët tē zbardhëlyer, e si tē lyer me brymë...

— Dale, pa ta ndreq unë ty!

Më kapi pér zverku, kurse dorën e saj tē djathëtë ma kaloi me egërsi dhe me rrëmbim mbi kraha-ror. Kështu ma gërvishi keq kafazin e kraharorit tim vocrrak dhe më bërtiti:

— Ja dhe Lolën ta shkula nga zemra, ja... nē pus do tē ta hedh! Oj... na e paska nē zemër... çapaçuli!

Ajo hyri shpejt e shpejt nē katua, unë e ndoqa pas, ajo zvarrisi kapakun e pusit dhe e vendosi dorën e saj tē djathëtë mu nē grykë tē pusit.

— Ja, nē pus ta hedha, plas në vend tanë!

Të them të drejtën, aq fort kam qarë asaj pas-diteje, sa edhe tjegullat e shtëpisë kërcyen përpjetë dhe lojtën nga vendi!

U mblohdh shtëpia dhe u mblohdh mëhallat e të-rë, erdhën gjyshja e nëna, u munduan të më qetë-sonin, po... A ishte gjë e paktë? Më kishin shkulur nga zemra Lolën time aq të bukur e aq të dashuri! Më kishin rrëmbyer nga zemra Lolën me ata sytë e ndritshëm dhe ma kishin flakëritur mu në pus!

Të nesërmen në mëngjerez, pasi mbushën ujët në pusin tonë çupat e mëhallës, shkova atje fshehur-fshehur si hajdut dhe hodha kovën në të. Pastaj e nxora. Si gjithnjë! Ujë e asgjë tjetër. Shenja e Lolës së mjerë nuk dukej gjékundi. Atëhere mendova se atje poshtë Lola e gjorë nuk kishte asgjë pér të ngrënë; nuk kishte veçse ujë. Mendoja: «Po a i ka gjetur motrat e saj? A kujdesen vallë ato pér Lolën time, atje poshtë?» Vrava mendjen dhe mëtë fund vendosa të bëja diçka. Në barin e kash-toreve sonë kishim vënë thana pér t'u zbutur. Mbusha njërin xhep me thana të kuqe, xhepin tjetër e mbusha me lajthi prej atyre që kisha mbledhur vettë, e sërisht shkova te pusi. Zvarrisa kapakun e madh që mbante erë dëllinje dhe, duke hetuar anembanë nga frika e nënoles gjuhëlopatë e gojëafratë, ja hodha Lolës në pus edhe thanat e kuqe edhe lajthtitë. Pastaj prita. Asnjë përgjegje. Rrëmbeva kovën dhe e hodha nëpër grykën e pusit. E tunda dhe e shkundë disa herë, pastaj e lashë të qetë: «Ta shohë Lola dhe ta kuptojë...» Heshtje. Qetësi. Ndiheshin krim-bat që u hynin thellë e më thellë trarëve të shtë-pisë... Por... fare papritur u drodha megjithësej, gjunjët m'u lëkundën dhe zëri i çjerrë i nënole Sofisë më trembi aq shumë, sa desh më shpëtoi nga duart

litari i kovës, kurse kërcinjtë e mi të njomë m'u lagën fare...

— I ziii! O i ziii! Po të shpëtoi kova në pus, do vij të të mbyt atje, ja me këta thonj!

Ngrita kryet. Nëpër një vrimë të dyshemesë, ku kishte pasë qenë një gdhë në dërrasë u dukën goja e shëmtuar dhe syri i vëngër i nënoles, që ishte gati të më hante e të më çante më dysh.

Por edhe përpara një trembjeje dhe një kërcë-nimi të tillë, unë kisha vendosur të mos tërhiqesha. Që lart u dëgjua edhe zëri i nënës sime, ajo edhe një herë u përfyt me nënolen, në sherr hynë edhe zëra të tjerë, por të gjithë ata zëra dhe e gjithë ajo rrëmujë, sa vinte e po largohej. Dukej se gjyqi do të bëhej në këndin më të largët të shtëpisë, atje ku rrinte babagjyshi plak dhe ku tani medoemos do të shkonin gratë e shtëpisë.

Kisha ngecur me litarin e kovës në duar, kurse gjunjët e mi të gërvishur po më digjnim, ngaqë i njoma keq kur më bërtiti aq papritur nënolja. Por në fund të fundit unë e mblojha veten dhe fillova t'i tërhiqja për lart litarin dhe kovën. Dhe, kur kovën e nxora në drithë, edhe u gëzova, edhe u dëshpërova. Lola kishte mbajtur thanat e kuqe e plot me lëng dhe m'i kishte kthyer prapë lajthitet. Këto lajthitet e parriira mirë, notonin mu përbimi ujin e kovës. Por nuk më mbushej mendja se çka ndodhi në të vërtetë, prandaj e hepova paksa mbi pus. Hodha vështrimin në fund të tij. Mbajta fryshtën dhe vërejta mirë. Fare papritur atje në fund të pusit diçka lëvizi. Ishte një sy. Dhe medoemos ai ishte syri i Lolës së bukur! Po... kurrë nuk ma priste mendja se ai ishte vetë syri im!

\*  
\*      \*

Ditët kalonin dhe unë ende isha fëmijë. Nënolja jonë ditë e për ditë bëhej më e zezë. Tashmë ajo vërtet mbante erë temjan dhe qirinj të djegur. Shërbente në kishë bashkë me Dabaken, qante rregullisht çdo të premte për vuajtjet e Jesu Krishtit në Kalvar dhe në Golgotha dhe doemos priste ditën kur do të vdiste murgesha Dabake, e cila do t'i lëshonte vendin, do t'i linte trashëgim shtëpinë me ftonjtë dhe livadhin e saj. Dhe, një kohë e tillë nuk vonoi të afrohej.

Ishte vjeshtë, kur Dabakja ra në shtrat për të mos u ngritur kurrë më. Dhe nënolja e shtëpisë si-me, nëpër derëzën e vogël të dhomës lart, shkonte orë e çast tek ajo. Bashkë me të shkonin atje edhe psallti Simeon, prifti i fshatit si edhe disa plaka të tjera, të cilat në çdo kohë e në çdo vend sikur presin me padurim raste të tilla. Dhe, meqenëse rasti ishte i jashtëzakonshëm dhe përfundimtar, një natë shkoi atje edhe nëna ime. Vetë bëra si bëra dhe fshehur-fshehur e struktur-struktur u futa edhe unë në atë këndin e largët të shtëpisë së Dabakes. Plaka murgeshë shtrihej në qoshe, e tretur dhe e verdhë, flokët i kishte krejt të thinjur, fytyrën të tharë gjer në kockë, hundën tepër të hequr. Mbi sofatin e dritares së vogël ishte vënë përmbyss sahati, të cilit i mungonin krejt vidat e kurdisjes, fare pranë ndodhej dara, me të cilën Simeoni shkulte dhëmbët, në qosh të tavani varej një kallëp misri nga ata të kuqtë, por i tharë trokë dhe i nxirë nga tymi. Nga ky kallëp misri s'po më ndaheshin sytë. Koçani apo karabushi i misrit nuk ishte shkëputur nga ceflat, por rrin-

te i varur pas tyre. Ceflat kishin ndërruar me kohë ngjyrën e tyre, tashmë ato nuk i takonin asnjë ngjyre, ishin të tharë, terur, trokuar e zvetënuar sa vijat e rrudhave të tyre ishin mbushur me pluhur.

Simeon psallti diçka mundohej t'i thosh së së-murës, por kuptohej se ajo nuk merrte vesh asgjë.

Por ajo nata e fundit e Dabakes kishte përbrenda saj disa të papritura krejt të çuditshme. E sëmura ndenji disa orë me sy të mbërthyer në tavan. **Dhe më dukej mua sikur nëpër atë tavanin e lyer** e të përlyer vite me radhë me baltë, me humbe, me gëlqere apo me hi, nëpër atë tavan të vjetër e të shtrembër, të epuar e vrima-vrima, në atë tavan ku kishte me mijëra fole marimangash e fole krimbash, në atë tavan gjithë blozë e tym temjani, në atë tavan që kishte dëgjuar gjithë ato qarje e ulërima, nëpër atë tavan plot me reska të ngatërruara, të shtrembëra e të përdala, Dabakja po lexonte tanë gjithë jetën e saj të gjatë dhe të egër, të qetë dhe të hidhur.

Pastaj fare papritur ajo kërkoi ujë. I dhanë. Atëhere u ngrit qëndroi ndenjur tmerrësisht e dobët, sytë i kishte shumë të mëdhenj dhe shumë të bukur. Kurrë s'ma merrte mendja se një njeri që ishte duke vdekur mund t'i kishte sytë aq të bukur. Ato i ndritnin dhe i shkëlqenin. Dukej sikur ai ishte shkëlqimi i fundit që do të xixëllonte një çast dhe pastaj do të zhdukej përgjithnjë.

Ajo u gatit të fliste dhe foli. Zëri i saj ishte i jetë dhe i prerë. Ishte zëri i asaj që jepte regëtimat e fundit:

«Po vdes e shkretë, pa njeri, pa fis, pa vëlla, pa motër, pa kushërinj, pa fëmijë dhe e penduar për jetën time. E kisha dëgjuar këtë hata që e plakos nje riun kur i vjen fundi, por s'e kisha besuar. S'paska

më keq se sa kur vdiske dhe nuk lënke pas teje asnë rrënë. Dua t'i rrëfëhem jo priftit, por të gjithëve. Mëkateve u jam larguar. Keq nuk kam bërë pér të tjerë, veçse pér veten time dhe pér një... që do ta them. Në ngasje nuk jam shtënë dhe në mëkat të rendë kam rënë vetëm me mendje. Duke hapur varret, kam zbuluar njëherë një vrasje të vjetër, por nuk e kam treguar nga frika se do të hapej hasmëri e gjakmarrje. Kam gjetur në varr Tasin e Joxhes të mbuluar përmbyt dhe me duar e këmbë të lidhura me zinxhirë. Ju kujtohet kur u zhduk dhe s'ju gjet nishani. Kush e vau, nuk e di. Por di se kam marrë më qafë një njeri. Ju thashë, të më dëgjojë edhe Sofia... e kam futur Sofien në një rrugë pa krye. Nuk e dija se kjo rrugë ishte pa krye. Që ta mësojë njeriu, u dashka që të dalë vetë gjer në krye të kësaj rruge. Ja kështu! Faj që e kam mbyllur jetën të zezë! Sofia të bëjë derman, sa s'është vonë akoma, të gjejë rrugë dhe të martohet një sahat e më parë! Murgë të mos bëhet! Trashëgim nuk i lë asgjë! Të shohë jetën, si gjithë bota. Shtëpia ime, bashta dhe livadhi le të lëshohen me qira. Me paratë që do të mblidhen, të blihet verë dhe mot pér mot, në kohën kur kositen barërat të mblidhen djemtë e fshatit të pinë verën dhe të hedhin valle mbi varrin tim! Kaq kisha».

Gjer këtu dhe mua më nxorën jashtë.

Të nesërmen e varrosën Dabaken dhe pér çudi në varrim nuk shkoi nënolja jonë. Po, kur u kthyen njerëzit nga varrezat, shpërtheu një hata tjetër. Nënolja jonë, Sofia, nuk gjendej gjëkundi. Dikush tha se e kishte parë duke çjerrë faqet me thonj dhe duke ikur si e çmendur përpjetë malit!

Medoemos i gjithë fshati u nis pér andej. Nëna

ime qante e logorisej, shkulte faqet me duar e përpëlitej:

— Qyqarja! Qyqarja! Çështë ky turp që na bëri

Porse fshati u nis malit përpjetë për të gjetur nënolen tonë... mua nuk më hante malli shumë. Unë kisha hallin tim dhe halli im ishte atje te pusi ynë ku ajo shtriga e keqe më kishte hedhur Lolën time. Mendova:

«Ata të fshatit le t'i bien malit majë më majë dhe përrua më përrua, mua aq më bën. Ujjërit le ta çajnë nënolen! Ajo është e ligë dhe mban erë temjan e qirinj të djegur, unë do të kërkoj Lolën!»

Isha tashmë fare i qetë dhe fare i ngeshëm. Askush s'mund të më binte më qafë. Hodha kovën në pus dhe pastaj e nxora. Ujë e asgjë tjetër. E hodha edhe një herë. Ujë gjithnjë. Por... herën e tretë m'u duk se kova u rëndua tepër. M'u bë sikur dikush e kishte kapur kovën atje poshtë dhe nuk e linte ta nxirrja këtej! U drodha nga gjëzimi dhe u dhashë me forcë krahëve të mi! M'u duk sikur diçka u shkëput atje poshtë dhe kova e nisi rrugën përpjetë si gjithnjë... Sa e afrova në buzë të grykës së gurtë, ia kapa me dorë veglën si gjithnjë dhe e nxora këtej... U tmerrova! Mu në buzët e gremçuara të kovës ishte një leckë e zezë! E njoha me të parë. Ajo leckë ishte prej fustanit të zi të nënoles sonë! Edhe nënolja jonë atje poshtë kishte mbaruar.

## **«PËR SHPIRT TË ATIJ QË MBETI MAJË HURIT»**

Mjeshtri Llambi Kapërdaku, ose Llambi i Niços, si i thërrisin në fshat, kishte hipur mbi kulmin e çatisë së shtëpisë sonë dhe po ndërronte tjegullat që kishin lëvizur e ishin prishur nga dimri dhe bënин të na pikonte ujë në tavan. Unë asaj dite kisha një dëshirë shumë të madhe që të hipja edhe vetë në majë të çatisë edhe sepse në kopshtin prapa dëgjo-hej një sherr e një shamatë me thirrje e me britma të padëgjuara ndonjëherë. Por më në fund falë përpjekjeve titanike që më kushtuan ngjirjen e zërit dhe dy grushta me lot, munda të kaloja nëpër atë labirintin e trarëve deri te baxha, ku merimangat që prej një shekulli e këtej kishin vendosur pëlhirurat e veta. Kështu që u ndodha pranë Llambit që ndërronte tjegullat.

Që lart nga pullazi munda ta shihja fshatin në pëllëmbë të dorës, lumin që gjarpëronte nën kurorët e shelgjeve, rrugët e ngushta, kopshtet e vogla, disa oborre të shtrembejëra ku gratë tundnin në mëtitë disa çardhakë me shumë dritë ku ishin shtrirë macet dhe ngroheshin të përgjumura nën rrezet e vakëta

të diellit, pastaj pashë varrezat e fshatit ku, si ma thoshte mendja mua asaj kohe, të vdekurit flinin gjithë ditën, kurse natën dilnin dhe na përgjonin ne të gjallëve, përveç atyre që ishin bërë lugetër dhe bënин hatara që nga përmbyjet e qypave e gjer në heqjen e llozeve të portave.

Në mes të varrezave dukej një varr krejt ndryshe nga të tjerët. Ai ishte i rrethuar me kangjella prej hekuri dhe kishte mbi kokë një kryq të bardhë prej mermeri.

Llambi Kapërdaku u tregua mirëdashës ndaj meje; më fali nja tri pare me vrimë që kishte gjetur mbi çati, më foli me miratim për flokët e mi kacurrel mbi ballë, të cilët, si tha ai, m'i kishte lëpirë viçi, më urdhëroi të mbyllja dyqanin dhe pastaj me shaka më kapi për veshi dhe më pyeti:

- I dhe gomarit ujë?
- I dhashë.
- Të ngrohtë, apo të ftohtë?
- Të ngrohtë.
- Ooo, ç'ma dogje gomarin!

Ishte kjo një sajdisje jo e paktë e mjeshtrit punëtor, sa më bëri të harroja lotët që derdha. Por mendjen e kisha gjithnjë tek ato zhurmat e sherrit prapa shtëpisë sonë, që tashmë dukej se ishin platinur.

Dhe, ndërsa unë po i kqyrja një për një tjegullat e vjetra të mbushura me pulla myshku, papritur sherri u ndez përsëri!

Katerina dhe fqinja e saj Argjiroja po përfyteshin dhe po ziheshin për kufirin e përbashkët të kopshtit. Të dyja ishin plaka gjer në mykët por, se kështu, fjalët që shkëmbenin ishin tepër të egra, me sharje e mallëkime, ku ngatërröheshin si të ishin

shokë e miq engjëjt e qiellit me djajtë e skëterrës!  
Në një çast plaka Katerinë desh të betohej dhe tha:

— Jo, moj, jooo! Asnjë pëllëmbë dheu s'të kam rrëmbyer, për shpirtin e atij që më ka mbetur në majë të malit!

Pas një betimi të tillë më shkoi mendja se burri i Katerinës do të kishte pasë qenë komit majë malit, ose ndoshta kaçak, apo ndoshta hajdut dhe në luftë a në përfytje me armiqtë apo egërsirat... na i pas-kësh mbetur Katerinës mu në majë të malit!

Por truri im nuk e pati të gjatë meditim e tij, sepse Llambi Kapërdaku nënqeshi hidhur dhe, sikur t'i drejtohej plakës atje poshtë, foli ngadalë:

— E pse nuk thua, moj, «për shpirtin e atij që më mbeti në majë të hurit?»

Unë u habita edhe më shumë nga këto fjalë dhe nuk dija fare se nga t'ja lëshoja frerin përfytyrimit tim.

Pas pak, mjeshtrit ia sollën drekën atje në majë të çatisë dhe besoj se e kishin kuptuar njerëzit e shtëpisë sime që çdo tentativë pér të më zbritur mua nga pullazi, mund të bënte që tjegullat e kuqe të luanin nga vendi e të kërcenin përpjetë! Kështu që unë mbeta atje lart, i nderuar sa më s'bëhet, që të haja drekë gju më gju me mjeshtrin plak, i cili i kishte gishtat plot me kallo dhe një gjuhë të hollë e zë të ëmbël.

«Zënka midis të dy plakave, djalo, i ka rrënjet që asaj kohe kur rronte i shoqi i Katerinës, papa Llazua, prifti i fshatit që zoti tanë do ta ketë dërguar në skëterrë, pasi e nisi që nga kjo botë me një xip huri mu nën grykë. Papa Llazua si e shoqja ishte hileqar, ndërronte dimrit sinoret e arave dhe të kopshteve, sepse ishte lakut dhe grykës pas mallit

të botës. Hiqte guri në këtu, e shpinte më tej, pastaj gjatë dimrit ujërat dhe dëbora bënë punën e tyre dhe shuanin shenjat e gurëve. Por aq lakmonjës ishte prifti Papa Llazo, sa e teproi tej çdo mase. Kështu që, xha Gjergua, i ndjeri burrë i Argjirosë, e hodhi çështjen në gjyq. Por, që të gjykotheshe, atëhere, nuk ishte punë e lehtë. Shtyj gjyqin sot e shtyj nesër, sepse domosdo duhej të kishin kohë të hanin, të pinin dhe të lëpinin që nga gjykatësit, sekretarët, avokatët e kështu me radhë. Prandaj na ka mbetur një fjalë e urtë: «Gjyqi e sherri duan kamje dhe nge».

Dhe, pasi u gjykuau një dy vjet me radhë, më në fund, një ditë dimri papa Llazua e fitoi gjyqin! Kjo ishte një shkelje e rëndë e së drejtës, por... hajde dhe gjeje të drejtën ti! Kështu që prifti, pasi hodhi disa kupa në pijetore dhe qerasi avokatin me gjyqtarët, u nis të kthehej në fshat. Kur doli nga qyteti, pa në rrugë përrpara tij ndërgjyqësin Gjergo, i cili edhe ai, i dëshpëruar, i lodhur dhe i dërmuar, kishte marrë rrugën për në fshat. Priftit nuk i erdhi mirë që ta takonte se, ku ta dish, njeriu prej gjaku është dhe kushedi ç'mund të ndodhë. Atëhere prifti hileqar bëri nga e djathta dhe, meqenëse dëbora ishte e trashë dhe kishte zënë kore nga të ftohtët, ja nisi rrugës përmbi dëborë dhe jo në rrugë, por në të shkretë, pllajave, kodrave.

Ishte tërë gaz e tërë qejf, fërkonte mjekrën dhe përkëdhelte kryqin e madh të argjendtë që i varej gjer mbi bark. Koha ishte e ftohtë vërtet, por papa Llazua ishte i veshur e ishte i ngjeshur, ishte i ngrënë dhe ishte i pirë, ishte tërë qejf dhe e hidhët një çap këtu e një atje tej. Por dimri është dimër, s'të pyet ai cili je ti. Sa hyri prifti thellë grykës së ma-

leve, nisi një veri e një furtunë, ulériu era e bashkë me të edhe ujqërit, sa papa Llazua e humbi toruan dhe drejtimin. Xha Gjergua, duke ja mbajtur drejt rrugës, gjeti edhe shokët e tjerë udhëtarë, e bashkë me ta gjithnjë nëpër monopatin e zi dhe të çelur, u kthyte gjallë e shëndoshë në shtëpi. Thonë se atje lart te Guri i capit, priftit hileqar ju çakërdis mendja dhe më s'dinte nga të shkonte. Atje ju prenë edhe fuqitë, zu të bënte kollotumba këtu e të përgjunjej atje, koka sikur i lëshonte tym. E preu e zeza dhe zuri të falej e të lutej te zoti: «Shpëtomë, o perëndi, se vërtet jam mëkatar! Shpëtomë, o Jezu Krisht, se, me t'u kthyer në fshat, do t'ja kthej xha Gjergos tokën e zaptuar, do t'ua kthej edhe të gjithëve që ua kam rrëmbyer. Dhe gjithë gurët e sinoreve që kam lojtur do t'i shpie në vend. Shpëtomë, o fuqimadh, se u pendova!»

Kështu falej e mërmëriste prifti, po ku të pyeste veriu dhe shqota! Buçisnin këto male nga era dhe sikur tundeshin që nga themelitë. Me shumë mundim dhe me të keq, prifti doli gjer te maja mbi kokojkë dhe, kur bëri tatëpjetë, meqë kësaj ane vendi vjen i rrethuar nga majat e pyjeve, era u pre përnjëherësh. «Hë, tha prifti, tashti shpëtova. Meqë s'ka erë, brenda një sahati jam gjallë e shëndoshë në shtëpi, te priftëresha! Po si i premtova zotit xhanëm, si i premtova se do t'ua ktheja atyre kokëtrashëve ato ngastra toke! Jo, more, se s'u bëra i marrë. Ja, rrugën e gjeta tanë. Vetë zoti më nxori në rrugën e saktë!»

Ikë e ikë prifti drejt e tatëpjetë, herë hidhej e herë shkiste nganjëherë edhe këmbët i ngatërroheshin nëpër rason e tij të madhe dhe të zezë, por sidokudo ai i afrohej shtëpisë. Po do ti edhe atje

lart te Guri i prerë, më t'ja preu rrugën një kope me ujqër! Urata ngriu në vend dhe u hodh pas një ahu dhe më duar e këmbë, duke grisur e duke shqyer rason, kapi degën e lartme të pemës. Duke u zvarrisur ahut përpjetë, ju këput edhe zinxhiri i argjendtë i kryqit dhe kryqi i ra poshtë. Ujqërit që ju vërsulën në çast, e kapën me dhëmbë kryqin e argjendtë dhe zunë të ulërinin me të madhe. Ata nuk donin kryq prej argjendi, ata donin mish të dhjamur prej prifti!

«Obobo, do të më shqyejnë ujqërit, zu përpëlitez prifti, i ziu unë, sapo u ndava mirë e bukur nga gjyqi i qytetit, sonte më pret gjyqi i madh i qiellit, obobo, kazanet me zift, o zot mëshiromë, o Shënkoll i udhëtarëve dhe i detarëve, vëre dorën dhe shpëtomë!»

Egërsirat i erdhën rreth një copë herë papa Llazos, por nuk e arrinin dot gjer atje lart! Këto ndodhnik asaj dite dimri atje në mal, kurse në fshat priftëresha priste burrin t'i kthehej e ky s'po dukej. Doli nëpër mëhallë dhe kërkoi ndihmë. U ngrit, atëhere, fshati i tërë dhe doli përpjetë malit që të kërkonte papa Llazon. U vërtitëm e erdhëm rrotull, por rasua e zezë s'dukej gjékundi. Pastaj ra nata. Edhe nëpër natë ne rendëm nga një qoshe e malit në tjetrën, lëshuam edhe qentë, por bosh. Thirr këtej e bërtit andej, kérko nëpër greminat me fenerë duarve, por kot se kot. Prifti nuk dukej gjékundi. Njëri nga ne thosh se do ta kishin çarë ujqërit, tjetri thosh se do ta kish mbuluar dëbora, kurse një tjetër u hodh e tha se prifti do t'ja kishte mbathur vraptit për në quell!

Shkuan edhe nja tri ditë dhe çdo shpresë përtat gjetur gjallë papa Llazon u pre. Atëhere rrahën telegramet gjer në Tiranë e Gjirokastër, gjer në

Manastir e gjer në Janinë, nëpër miq e nëpër të njo-hur po, hë, hë... prifti më s'u duk.

Vetëm vonë, aty nga fundi i prillit, kur nis e shkrin dëbora e rëndë e maleve, u tha një fjalë që e tundi fshatin e tërë. U nis i madh e i vogël dhe u ngjitën lart. Dhe, kur sosëm atje ku na thanë, pamë me sy diçka të çuditshme dhe të pabesueshme.

Një arë mali ishte e rrrethuar me hunj druri. Te lesa e hyrjes në arë, kishte të ngulur në tokë dy hunj edhe më të mëdhenj se të tjerët. Edhe këta dy hunjtë që mbanin lesën na kishin nga një xip si shtizë të mprehtë mu në majat. Prifti hileqar, që kishte ikur nga rruga e zotit dhe nga rruga e njerezve të drejtë, duke rendur e duke u vërtitur plajave me tufan e me dëborë, shkoi përmbi këtë arë të mbuluar dëngë me dëborë, se kú bie e se ku shket dhe fap... na i hyn xipi i hurit të madh mu mbi grykë midis nofullave të poshtme. Ishte munduar të shpëtonte, ishte munduar të çlirohej, por më kot... Huri i qe ngulur paq, dhe prifti ja kishte dhënë shpirtin djallit, satanait! Ja, prandaj tani Katerina betohet: «Për shpirtin e atij që më ka mbetur në majë të malit!»... Në majë të hurit mbeti maskarai, se i atillë ishte!»

Unë mbeta i hutuar në majë të çatisë. Shihja kopshtet e vogla të fshatit, të vogla dhe të ngushta si copëra rrugozash e të rrrethuar çap e pëllëmbë nga gjerdhe e hunj. Pastaj më tej ishin arat dhe hende-qet e aty-këtu edhe gurët e sinoreve, të cilët papa Llazua kishte pasur shumë dëshirë që t'i lëvizte. Këto i shihja me sy, kurse përfytyrimi im rendte në majë të malit, atje ku papa Llazua kishte ngecur i varur si dordolec në majë të hurit. Por përsëri Llambi Kapërdaku më foli:

— E sheh atë varrin me kangjella të hekurta?  
— E shoh, xhaxha Llambi!  
— E ashtu, ja atje e kanë varrosur atë priftin hileqar.

— Po mirë, xhaxha Llambi, po, kur ai ishte i lig, pse i kanë ngritur një varr aq të bukur?

— Eh, ti je i vogël dhe s'i gjykon dot këto punë, kur të rritesh!

Habitesha dhe nuk i bija dot në të. Përse vallë atë mjekëroshin hileqar, që kjo botë e kishte nisur me një hu nën nofullat, e kishin nderuar me një varr aq të bukur! Vrava mendjen dhe më në fund e gjetë: Kangjellat ishin nga dy metra secila dhe në majat e tyre të mprehta kishte disa si shtiza e shigjeta të mprehta. Papa Llazua i kishte armiq të gjithë të vdekurit atje rrrotull. Ata ngriheshin natën dhe e sulmonin! E sulmonin, kurse ai rrinte qetë-qetë në varr e pinte duhan, sepse e mbronin ato shtizat e hekurta të varrit!

## KUR PUNOJA ME QERREN NDËRKOMBËTARE

Kur isha nja gjashtë vjeç, njerëzit e shtëpisë sime shkonin e punonin gjithë ditën në ara e në mal, kurse në shtëpi mbetesha unë dhe...

Gjyshi me gjyshen aty te zjarri, njëri në njérën anë, tjetri në anën e tejme, kurse vetë, si më i vogël, rrija gjunjaz aty në mes, përballë zjarrit dhe shihja flakët e kuqe tek i vërsuleshin vorbës prej balte që e lëpinin, e ngacmonin dhe e nxehnin sa ajo, duke mos ditur nga t'ja mbante, shfrynte e llokoçiste avull e stërkala uji. E bashkë me këto, ajo vorba e dashur nxirrte një aromë ca më të dashur prej fasulesh të ngrohta që, kur shtrohesha të haja, s'ngjinjesha dot e s'kisha të mbaruar.

Jashtë binte shiu i vjeshtës, i ngeshëm dhe i ngadalshëm, lagte tjegullat me myshk të çatisë, lagte gurët e rrugës dhe pluhurin e trashë të udhës e qullte dhe e gatuante derisa e kthente në baltë. Nganjëherë mjegulla i binte rëshjes mes për mes; që nga majat e kodrave vinin gjer këtu thirrjet e çobenjve dhe lehjet e qenve dhe, kur shtypja hundën mbi xhamin e dritares, mundja të shihja ndonjë zjarr të largët që uturonte e lëshonte flakë e tym nëpër majat e ko-

drave. Ndër ato zjarre barinjtë piqnin patate të buta ose këpurdha të shijshme.

Gjyshi im hiqte duarve një palë tespije prej bërthamash ulliri, mustaqet e bardha i kishte të paq-me dhe pa shenjat e zverdhjes nga duhani, ballin e kishte plot me rrudha dhe, po t'ja numëroje ato vijat paralele që i shkonin gjer tutje tëmthave, i bëheshin nja tetë a nëntë. Unë e pyesja:

— Po ti, gjysh, sa vjeç je, o?

Ai më tregonte ballin e vet dhe më thoshte:

— Numëroi këto... një rrudhë është barazi me dhjetë vjet...

Unë ja numëroja dhe ja ktheja:

— Nëntë janë, o babagjysh!

— Bukuri! Nëntë për dhjetë sa bëjnë?

— S'e di!

— Mirë. Atëhere, që ta dish, mblidh ca fiçorë, bëj nëntë kupa me nga dhjetë prej tyre...

Unë nuk kisha se ku të gjeja fiçorë e prandaj dola në oborr. Aty gjeta luleshqerra vjeshtake, i mbusha xhepet me to dhe u ktheva afër zjarrit. Aty prapa shpinës së gjyshit nisa t'i vendosja me radhë në nëntë kupale. Kur më pa plaku, nënqeshi hidhur e më tha:

— Jo luleshqerra, birooo! Se vjetët e mia nuk kanë shkuar me luleshqerra! Më mirë dil e mblidh kokrra pelini, me ato i bëj kupalet!

Unë këtyre fjalëve nuk u hyja dot, po e shtyja bisedën më tej:

— Po mirë, o gjysh, po edhe sa rrudha do të të dalin ty?

Ai nuk m'u përgjegj, por qeshi dhe ma shkoi dorën e tij të ashpër përmbi fytyrën time të butë. Po unë nuk i ndahesha dhe ai më foli:

— Do tē më dalin rrudha aq sa tē nxerë balli, pastaj, o bir, pastaj do tē vdes!

— Jo, jo, gjysh, unë nuk dua tē vdesësh, jo, jo, nuk dua, nuk dua!

Dhe pér hatrin tim ky gjyshi im (më dukej mua) natë pér natë, e ditë pér ditë, muaj e vite me radhë nuk bënte asgjë tjetër, por hiqte flokët nga tullgë e kokës pér t'u hapur vend rrudhave e pér tē mos vdekur kurrë.

Por midis këtyre bisedimeve foshnjarake, kur herë gjyshi zbriste te mosha ime, e herë unë bëja tē ngrihesha në moshë tē tij, ai gjente kohë e niste kuvendonte me gjyshen. Në këto fjalë unë isha i ndaluar tē hyja, por, pér tē dëgjuar, këtë e bëja pa pyetur njeri. Dhe nga bisedat e tyre unë e kuptoja se jeta ishte e vështirë, buka mbarohej shpejt dhe fasule nuk kishte fare.

Kështu që, kur hapej moti sadopak, gjyshi e linte zjarrin e, megjithëse i dhembnin këmbët, niste e meremetonte parmendat e drunjta, shkonte në ahur dhe, pasi grazhdonte lopën me bar tē trashë vjeshte, niste dhe i krihte shpinën dhe barkun me një krehër tē madh prej druri. Kafshës i vinte mirë dhe ulte kryet, i dridhej lafsha e butë e gushës nga kënaqësia dhe, kur gjyshi e linte lopën e shkontakte te kau, Ballashja pëlliste lehtë e desh që përsëri t'i shkontakte në shpinë krehri i gjyshit tim.

Ishte kjo kohë kur nuk e di se si më erdhi dhe e ndjeja veten tē shtrënguar tē bëja diçka që t'i ndihja shtëpisë dhe që medoemos do tē më jepte edhe mua atë gjëzimin që i jep puna njeriut.

Si e thashë, ishte vjeshtë. Ato ditë retë u shpërndanë, mjegulla iku në majë tē malit, gjyshit ju çmpinë këmbët nga përdhesi dhe, pasi mbërëhu qetë

në zgjedhë, futi shtizën e qerres në kular dhe nisi të mbante plehun që nga grumbulli i madh prapa shtëpisë e gjer tek ara jonë përmbi lumë. Unë i shkoja pas me shpresën që, kur të ktheheshim nga ara, të hipja në qerre. Kështu ditë e përditë e shihja botën më shumë që nga ato rrëzënishtat e anshme që mbanin erë myk. I hipur mbi qerren u mburresha dhe u lëvdohesha moshatarëve të mi edhe për një arësyet tjetër. Rrotat e qerres sonë ishin franceze! Kjo në atë kohë ishte një mrekulli e madhe. Gjyshi im jo vetëm një herë ma kishte treguar historinë se si në kohën e Luftës së parë, kishte hyrë tinëz, natën, në livadhin tonë ku francezët kishin vendosur topat e tyre dhe... u kishte zhvatur një palë rrota topi!

- Po nuk të panë, o gjysh?
  - S'më panë, o bir, po, në fund të fundit, ç'deshën ata në livadhin tonë?
  - Po mirë, o gjysh, këta francezët ç'u bënë pastaj?
  - Francezët? U vranë, u prenë mirë e mirë me austriakët dhe me gjermanët, e pastaj krisën e ikën në vend të tyre.
  - Po topin pa rrota si e morën?
  - E morën zvarrë-zvarrë, e mos më keq.
- Unë përfytyroja francezët «të vrarë e të prerë» aë e zvarrisnin topin pa rrota gjer në shtëpi të tyre, në Francë, dhe më bëhej qejfi që ata vuanin duke e tërhëqur. Ndërsa oficeri i tyre inatçi i qëllonte me këmshik! Hë, ç'ua bënte mirë! Se ç'deshën ata në livadhin tonë?! Sepse aq shumë na e kishin shkelur livadhin (thoshte gjyshi) dhe aq shumë na e kishin helmuar me atë barutin e farmakosur, sa tri pranvera

e tri vjeshta me radhë livadhi s'lëshoi asnje fije bari!

Këto ishin njoftime të karakterit ekonomik, të cilave gjyshi u jepte rëndësinë kryesore dhe vetëm pasi mbaronte këto, ai shtonë njoftime të tjera që kishin të bënин me politikën:

— Por ata francezët e mallëkuar, o bir, ishin disa peshkaqenë prej atyre që duhej t'u vërviteshe me sëpatë prapa veshit. Kështu që një ditë prej ditësh na e zunë atë patriotin tonë të madh, e ke dëgjuar atë Themistokli Gërmjenjin?

— E kam dëgjuar po...

— E... na e zunë dhe na e vranë me të pabesë!

Këto bisedime me gjyshin unë i bëja hipur në qerre, ndërsa shokët e mi shihnin me zili qerren tonë me rrrota të bukura franceze.

Por, si e thamë më lart, unë desha të punoja. Këtë e thashë me të madhe nëpër shtëpi dhe prej kësaj përfitoi një nusja e xhaxhait tim. Kjo nusja jonë ato javë na gëzoi, sepse na lindi një djalë dhe më vuri mua të tundja djepin e kushërit tim të vogël. Por... shpejt u kuptua se një punë e tillë ishte për mua shumë e mërzitshme. Aq shumë térbohesha kur foshnja në djep qante me të madhe, sa unë i jepja disa lëkundje që i kalonin të dymbëdhjetë ballët e shkallës Merkali! Atëhere djepi përmbysej, e fëmijës së lidhur si kriminel në djep, i varej koka poshtë si kokë topuzi!

Më mirë punë nëpër ara, se sa dado në shtëpi!

Ishte ajo kohë, kur gjyshi im bëri emër se do të më sajonte një qerre. Por unë nuk kënaqesha me ndonjë qerre dosido. Unë doja që, si qerren time, të mos e kishte shok tjetër në fshat. Prandaj plaku rrahu

mendjen dhe më në fund e gjeti. U ngrit një mëngjez  
dhe më tha:

— Eja pas meje!

Unë i rashë pas. Dolëm nga fshati.

— Ku po shkojmë, o gjysh?

— Do të vemi te kovaçi, në Sul.

— Pse, kovaçi do ta sajojë qerren time?

— Jo, jo, ai do t'i presë bririn gjermanit.

Unë s'dija fare se si t'i merrja këto fjalë. Si do t'ja priste brirët gjermanit? Ç'ishte ky gjerman që kishte brirë?

Hymë në Sul. Ky ishte një fshat i madh me shtëpi të ulëta, me kafazë në vend të dritareve, me baltë shumë. Shtëpitë ishin prej plitharësh dhe këta plitharët ishin të brimosur e të brejtur nga foletë e grerave.

Kur hymë në kovaçhanë, unë mbeta gojëhapur, sepse gjer atëhere s'kisha parë ndonjë farkë ku punohej hekuri. Kovaçi quhej Çoban, ai ishte i gjatë dhe i zi, damarët e duarve i kishin kërcyer fort përmbi llërët dhe djersët i vinin çurg. Dy gra punonin bashkë me të: njëra luante krahun prej druri të kacekut, kurse tjetra qëllonte me vare një copë hekuri të skuqur, pikërisht në atë vend ku Çobani qëllonte me një çekiç të vogël. Pra kovaçi, sa-i bënte me shenjë, e gruaja me vare qëllonte ku duhej. Me të hyrë brenda, babagjyshi im nënqeshi dhe i tha kovaçit:

— Hajde, u trashëgofsh për së dyti, o Çoban!

— Më rrofsh, e të paça sa malet — ja ktheu Çobani.

Atëhere mësova se kovaçi kishte dy gra dhe sapo ishte martuar me të dytën. E dyta ishte ajo që punonte shtizën dhe kishte një lëkurë shumë të bar-

dhë. E para ishte ajo që punonte varenë dhe ishte aq e zezë, sa m'u duk sikur kishte dalë nga kupi me kaçavel aty në qoshe. Babagjyshi im nxori nga trasta një helmetë. Kjo helmetë duhej të kishte qenë pronë e ushtarëve gjermanë të Kaizerit, sepse e mbaj mend fare mirë se lart në tullgë kishte një si kunjë me xip. Helmetën gjyshi ja dha Çobanit dhe diçka i tha. Kovaçi menjëherë e futi në zjarr dhe i bëri shenjë nuses bardhoshe. Paik më vonë kovaçi e vendosi helmetën mbi farkë dhe filloi t'ja shkulte bririn. Duke punuar, i tha plakut:

— E gatuajnë mirë hekurin, ata qena gjermanë!  
— Ashtu, po... — plotësoi gjyshi — i lanë kokët, i lanë edhe helmetat.

— Helmetat franceze janë më të buta.

— Kurse rrotat franceze janë më të forta.

Më në fund briri i gjermanit u këput dhe ra përdhe. Zeshkanja e kovaçit i ra me shqelm dhe e hodhi tutje në qoshe. Çobani mendoi se mbaroi punë me ne dhe kapi një sëpatë.

— Dale, dale, — i foli plaku — kësaj helmetës hapi edhe katër vrima!

— Vrima? — u habit kovaçi. — Po ti a nuk e do për hallet e pleqërisë?

— Jo, jo, do t'ja bëj qerre nipit, nëpër vrimat do të mbérthej boshtin e qerres.

Kur kovaçi filloi të hapte vrimat, gjyshi im më tha se do të shkonte gjer te një mik dhe duhej ta prisja atje. Unë u struka në një qoshe. Vetëm atëhere ja dëgjova zërin nuses bardhoshe. Ajo i tha kovaçit:

— Çoban!

— Xhan i Çobanit — ja ktheu ai.

— Ünë dua të më blesh një kapello me pendë pallo! —

— Ta ble Çobani ty, po hajde... bjeri shtizës!

\* \* \*

Kur u kthyem në fshat, babagjyshi sajoi rrrotat duke përdorur atë farë kallami që na jep bima e fshesës, kurse spicat e rrrotave i qarkoi me rakita të holla. Për të mos e lënë fare përtokë dashurinë time për mallin e jashtëm, në vendin e rrëzniشتave vuri disa bishta lugësh të thyera, për të cilat më tha se ishin austriake, për bosht përdori një tytë pushke franceze. Më gatiti dhe një zgjedhë me tevlig e kular dhe... Këtu lindi një problem me rëndësi! Kush do të mbrehej në qerren time? Atëhere unë kapa dy maçokët e mëhallës dhe deshën, s'deshën, ua futa zverqet ndën tevligjet. Por unë nuk e dija se, sa mund të futeshin të dyja këmbët në një këpucë, aq mund të rrinin edhe dy maçokët në një zgjedhë! Hëngra dy të çjerra në faqe, po aq të thella, sa ma plakosën faqen me duhan, se s'po më pushonte gjaku. Ndërkohë doli teto Locua në mëhallë dhe tha:

— Dy maçokë nu k mbrehen kurrë në një zgjedhë, por vërë një mace me një maçok!

— Por unë e përqesha teto Locon:

— Hë, moj ti shtrigë, kur s'rrinë dy që janë shokë, si do të qëndrojnë një mace e një maçok! Nga inati i teto Locos, që më përqeshi me atë gojën pa dhëmbë, unë provën e dytë nuk e kreva fare. Atëhere dikush më tha se në Rusi mbrehin tre qen në një zgjedhë. Na thanë se në Hindi mbrehet njeriu vetë,

e desha, s'desha, ju shtrova pérvojës hindiane. Hodha tutje zgjedhën, gjyshi e zgjati më fort shtizën e qerres, e kështu e shtyja, apo e térhiqja vetë.

— Po tani ç'punë do të bësh me qerren, o bir?

— Do të mbart edhe unë pleh, babagjysh!

— Po që nga do ta marrësh, o kapetan?

— Pleh nga pylli, babagjysh, prej të fletëve!

— Ashtu më të lumtë! Ai është pleh i mirë, nuk të ndot fare dhe ka një kundërmim që t'i mbush mushkëritë me erë të mirë. Të lumtë, o trim! Po ku do ta shkarkosh plehun?

— Do ta shkarkoj tek ajo ngastra që kemi andej lart nga kodrat.

— Po me se do ta mbjellësh atë skërkë, o bir?

— Do ta mbjell me bostan, babagjysh!

Këtu plaku bëri sikur rënkoj dhe i iku gazi prej fytyre.

— Pse rënkoj, babagjysh?

— Po si ç'pata, o bir? Do të na mbytet shtëpia!

Unë rrasha ta gjeja me mend se përse mund të na mbytej shtëpia kur të mbillja skërkën me shalqinj, por s'e gjeja dot. Dhe e kam vrarë mendjen për këtë vite me radhë. Vetëm pasi u rrita dhe gjyshi s'rronte më, unë munda t'i bija më të.

(Kaq shumë do rriteshin shalqintë në atë skërkën e malit, sa do të rrëkölleheshin tatëpjetë si orteqe dëbore, do të binin në lumin që shkon përpëra shtëpisë sonë, do ta blokonin krejt dhe atje do të ngrihej një pellg a një liqen i madh, sa do të na mbytej shtëpia! Këtu e kishte pasur fjalën gjyshi, por, sa ishte gjallë ai, kurrë nuk desh që unë ta mësoja, se nganjëherë ai tallej pa të keq me mua.)

Babagjyshi im që nga plehu i shtëpisë e gjer

në arë, brenda një dite mbartte njëzet qerre me pleh, kurse unë... që nga pylli e gjer në skërkë, ku do të rriteshin karpuzët, shpija dyzet!

— Ma kaloi ky deli djalë, që tani ma kaloi, po kur të rritet... hej, ç'kanë për të na parë sytë!

Por një ditë na u kryqëzuan rrugët me gjyshin mu atje te porta jonë. Plaku kishte ndaluar qerren dhe po ja lyente boshtin dhe rrotat me katran të zi.

Mua më kujtohej ajo vorbja e dikurshme e fasuleve, së cilës i qe thyer buza e sipërme. Në atë vorbe tanimë mbahej katrani. Ishte edhe ajo luga e madhe prej druri, e zezë, e uruar dhe e bekuar, me të cilën dikur më mbushnin misurin me supë fasulesh. Asaj i qe çarë luga dhe tani e përdornin për katranin... Dhe sa t'i thosha gjyshit unë ndonjë fjalë si «puna mbarë» apo «rruga e mbarë» e sa ta pyesja «sa rrugë bëre, o gjysh, a u lodh Sivaku», babagjyshi im i mirë kërceu përpjetë dhe më thirri:

— O bobo, o Tili! O bobo, o bir i gjyshit!

Unë u zverdha në fytyrë! Plaku m'u afrua dhe më urdhëroi:

— Ktheje qerren përbys!

Unë nisa të bindesha, por u shtiva se e ktheja me zor të madh, sepse kalamajtë moshatarë që ishin atje, fare lehtë mund të më thoshin: «Qerrja jote është një lodër kalamajsh që kthehet përbys me majën e gishtit të vogël».

Gjyshi ma llangosi bishtin e qerres me katran, pastaj e futi gishtin e tij tregues në vorbe, e ngjeu mirë e mirë dhe u-futi katran edhe rrotave në foletë e tyre të brendshme! Nga një sajdisje e tillë, mua hajt e më mbaje.

— Po sa rrugë bëre, o bir i babagjyshit?

— Njëzet e shtatë!

— Hë më të lumtë krahu, o kapedan me fletë!  
Radhën që vjen, lëre qerren të çlodhet e kthehu t'ja  
themi drekës!

C'është e drejta, mua më hahej bukë, por  
doja të tregoja zellin për punë dhe me kokën e turbu-  
lluar nga kanosja e mbytjes së shtëpisë, nxitova aq  
shumë, saqë, për të ngrënë bukën, u ktheva vetëm  
pasi kreva tridhjetë e një rrugë!

Kur hyra në shtëpi për drekë, i skuqur dhe i  
djersitur, të gjithë njerëzit e shtëpisë i gjeta rrötull  
sofrës, por... askush s'kish vënë kafshatë në gojë! (Të  
paktën kështu m'u mbush mendja mua.) Të gjithë  
prisnin! Dëgjova gjyshin që e ngriti zërin pak më  
shumë se zakonisht:

— Do ta presim domosdo, edhe ai punon, edhe  
ai lodhet. — E, duke m'u kthyer mua, tha: — A u  
lodhe, o trimi i babait?

Unë ja ktheva ashtu si kisha dëgjuar se thuhej  
në këto raste:

— Epo... po të punosh, edhe lodhesh!

— E ashtu de! Ulu tanë dhe shiko... lugën vesh  
më vesh ta mbushësh, se ashtu të takon, pa kur të  
hamë karpuzë të kuq, pa kur të na dërdhet lëngu  
i ëmbël faqeve dhe gushës, hajde, ore, hajde, ç'ke-  
mi për t'u gëzuar!

Tri nuse të shtëpisë, si i kishin gojët të mbu-  
shura plot me fasule, deshën ta mbanin të qeshurën,  
e s'e mbajtën dot, po atëhere ai gjyshi im vjen dhe  
u fut nga një shpullë turinjve, sa mua m'u duk se  
më arriti koka tek trari i tavanit!

— Shporruni, moj shtriga! Me kë qeshni ju?

Dhe plaku bëri kryq një herë, dy herë, tri  
herë dhe pastaj filloi të hante. Por, edhe kur mbaroi  
së ngrëni, ai përsëri desh të ma bënte qejfin dhe

nisi tē këndonte e tē tallej me ato nuset e reja që  
deshën tē më binin më qafë mua:

«Si nuset e Ndonit nuk ka njeri,  
mbledhur që tē trija lajnë një shami.  
Si nuset e Ndonit nuk ka njeri,  
mbledhur që tē trija lajnë një tepsi!»

Ndoni ishte vetë gjyshi, kurse nuset e tij ishin  
ato tē trija që s'kishin mbaruar bukë edhe se hëngrën  
shpulla turinje, edhe se kishin fëmijët në gji, që  
deshin sisë gjithë natës.

— Po a e mbushe skërkën me pleh, o bir?  
— E mbusha, o babagjysh!

Mirë fort. Tani po deshe mbaj ca pleh këtej  
poshtë, se ata gurët e skërkës do tē t'i brejnë fare  
opingat prej lëkure kau, sill pleh këtej poshtë, shkar-  
koje anës selishtes, atje ku mbjellin fshesa këto nuset  
tona faqezesa, që m'i bien në qafë më tē mirit tē  
djemve! Ato tallen me ty; ti shpërbleua me tē mi-  
rë... e mira ua zëntë sytë!

Dhe unë nisa tē mbaja pleh pér bisqet e fshe-  
save dhe e dija fare mirë se, me tē ardhur vera e  
thatësira, nëpér mbrëmjet e thata tē beharit, atëhere  
kur tē deh aroma e kumbullave tē kuqe, atëhere kur  
dardhat e ëmbla dhe verdhashe pikojnë lëng, atëhere  
kur thahen mustakët e misrit dhe pëlcasin bishtajat  
e rilave... atëhere do tē zhridhej ai vargani i linja-  
ve tē bardha ndër ara!

Do tē shkonin çupat dhe nuset pér në lumë,  
do tē mbushnin kovat me ujë që t'i vadisnin një pér  
një tē gjitha rrënjët e fshesave.

Dhe unë e dija se me ato fshesa do tē fshihej  
tërë vitin i gjithë fshati, shtëpitë, shkallët, oborret  
dhe dhomat e dasmave!

## PAPA JANI

Kur i mbusha tetë vjetët, munda t'i hyja një të drejte dhe një dëshire, të cilën kisha shumë kohë që e lakmoja.

Mbaj mend se në prak të asaj së diele, gjumë nuk vura në sy. U ngrita shumë herët, u lava shpejt e shpejt dhe shkova në kishë. Këtu prifti i fshatit, papa Jani, që s'ishte vendës, por i ardhur nga larg, po hapte librat e shenjtë. Ai ende s'i kishte veshur rrobat kishëtarë dhe po numéronte disa kokrra temiani. Afër kishte një copë letër mjaft të gjatë dhe plot me pikë dylli, ku ishin shkruar trisahitë që do të këndoheshin asaj së diele. Aty afër kishte edhe thasët e meshëve dhe më tej atë poçin e argjendtë të kungatës. Papa Jani ishte një burrë qimezi, nja dyzet e pesë vjeç, i shëndoshë dhe i pashëm, faqet e kuqe i ndritnin nën qimet e zeza. Prapa kishës murgesha Argjiro po i frynte mangallit, kurse murgu Spiridon se ç'po ngatërronte në hajatin e madh të kishës atje ku ishin të radhitura ato arkat misterioze të mbushura me kockat e priftërinjve të vdekur që këtu e kushedi sa shekuj me radhë. Të them të drejtën, ato arkat me

kockat i kisha parë ëndërr jo vetëm një herë, sepse ato arka tashmë ishin të çara, të sakatosura dhe lejonin të dukeshin disa zgavra kafkash dhe disa alipsane të zverdhura që më kallnin datën ditë e natë.

Prifti më pa një herë vëngër që përmbi syzet e tij me rathë prej teli dhe unë e kuptova se ai u kishte hyrë disa punëve shumë të rëndësishme dhe shumë të shenja, të cilat duheshin kryer me dinjitet dhe në heshtje të plotë pér të mos rënë keq në sy përparrë zotit, i cili ishte atje në tavan të kishës dhe na shihte ne, të gjithë besnikët, që do të mbli-dheshim asaj dite atje, do të faleshim e do të nuno-seshim dhe do të bënim kushedi se sa metanira e psallme e lutje pér shpëtimin e shpirtërave tanë që kanoseshin nga kazanët me zift.

Vetëm pasi erdhën nga njëzet besnikë, pasi erdhën edhe «shokët» e tjerë, papa Jani çeli derën e altarit dhe na e bëri me shenjë. Në çast unë hyra në altar vetë i pestë, me katër shokë më të mëdhenj se unë, të cilët filluan të më shisnin mend dhe të silleshin në mënyrë të tillë sikur ata ishin djem të stërvitur në atë shërbimin e hatashëm kishëtar, që do të kryenim asaj dite.

Pra, asaj dite, unë pér herë të parë do të vi-shesha me manale.

Nuk ja di kuptimin saktë kësaj fjale, por nën këtë emër fshihej ai shërbimi që bënin në kishë çunakët e vegjël, të cilët në çdo ditë meshe, vishe-shin me disa rroba si fustanë që ishin prej një farë cohe të gjelbër dhe me qëndizma kllapodani. Këto fustanë ishin të vjetër shumë, mbanin erë temjan prej disa shekujsh dhe kishin të qëndisur në shpinë; në kraharor edhe në krahet, disa kryqe. I ve-shur më manale, mbante në duar edhe një farë

shëndani prej tunxhi të verdhë e të përdredhur, në krye të të cilit ishte një kryq argjendi dhe më sipër një qiri i ndezur. Këta manalët, kishin disa detyra të përcaktuara në ritin fetar, sepse, sa herë dilte prifti nëpër kishë me ungjillin apo me kungatën në duar, do t'i shkonin çap pas çapi, të heshtur dhe të mallëngjer duke qenë një farë korti apo suite e prifitit, për t'u dhënë më shumë rëndësi psallmeve të tij, kur ai i drejtohej zotit për t'u falur mëkatet mëkatarëve.

Mesha e asaj dite kaloi si zakonisht, si e çdo të diele tjetër. Papa Jani këndonte në altar, psalltërit ja kthenin që nga fronat e tyre, qirinjtë digjeshin, temianica tundej e shkundej duke lëshuar drejt qieillit shtëllunga me tym temiani, besnikët bënин kryq, duke shpresuar se kështu do t'u mbusheshin hambarrët me misër dhe magjet me bulkë.

Ndërkhë, të katër shokët e mi haheshin me njëri-tjetrin se cili do të kishte fatin të përcaktohej nga papa Jani për shërbesën e pas meshës kur do të merrte uratën e zotit lehonë Aleksandra, që ishte një vllahinë e ardhur në fshat. Natyrisht, as që e shkoja ndër mend që të caktohesha për një detyrë të tillë, sepse unë sapo kisha hyrë në atë valle dhe natyrisht s'kisha as përvojën më elementare. Por, pasi mbaroi mesha, fare papritur e pakujtuar, papa Jani ma bëri me shenjë që t'i afrohesha. Renda tek ai i trembur dhe gjithë frikë; ai më tha:

— Ti mos i zhvish rrrobat e manalit, do të qëndrosh me mua pas meshe, se do të marrë uratën një e krishterë e zotit!

Papa Jani, duke më folur kështu, ma shkrepit syrin dhe unë e kuptoja se ajo e shkrepur e syrit para-

lajmëronte për atë paren që do të merrja unë nga Aleksandra për shërbimin tim...

Prej një grishjeje të tillë mua më erdhi kisha vërdallë, shihja si i topitur nën sytë lakmitarë të shokëve të mi, kur prifti shkoi edhe më tutje dhe ma bëri qejfin mal, më tha:

— Tashti ngjitu lart në kambanare dhe shiko se mos është këputur ndonjë fill nga litarët që mbajnë gjuhët, sepse sot...

U mrekullova! Unë s'kisha hipur kurrë në kambanare, edhe shokët e mi zor se e kishin pasur një fat të tillë, kurse unë... sa pa e veshur mirë manalen, do të kisha fatin... Turravrap u lëshova nëpër kishën e zbruzur nga besnikët, ndërsa shokët e mi kapën veshjet e tyre përfundi dhe po i nxirrin nëpër kokët duke nuhatur gjithnjë ato erërat e temianit! Ngjita shkallët, kalova të ndarën ku faleshin nuset dhe vajzat, gjithnjë duke u penguar pas fustanit të gjatë dhe u kapa pas parmakëve të asaj vrimës misterioze që të conte në tavanet e shenjta ku ditë e natë qëndronin shenjtërit dhe jepnin e merrnin atje përfundët e ne të gjallëve që mëkatonim gjithë javës dhe pastaj çdo të dielë vinim dhe u luteshim që të bëheshin interpretë te zoti e te Krishti që të na faleshin ato gjy-nahe që do t'i kryenim gjithnjë javë pas jave, gjersa murgu Spiridon të na hapte varret.

Kur u gjenda në tavanin e errët, u futa në atë labirintin e ngushtë sa s'tregohet, u lëshova si gjarpër drejt një pike të caktuar, tek e cila dukej një shtizë drite. Këto drejtime i kisha dëgjuar teorikisht, por, si e thashë, asnijëherë s'kisha mundur t'i shihja dhe t'i përkitja.

Kalimi nëpër atë labirint ishte jashtëzakonisht i zorshëm. Aq i zorshëm, sa edhe sot e kësaj dite, sa

herë fle keq dhe sa herë kam ndonjë dhembje në kraharor apo kam zjarmi, patjetër që do ta shoh veten në èndërr duke kaluar nèpér atë vrimë të ngushtë dhe duke u zvarrisur si gjarpér.

Zemra më rrihte me nxitim, isha i trembur, por kisha edhe atë ndjenjën e krenarisë që ka njeriu kur mundohet dhe arrin një èndërr dhe dëshirë të pàcanësuar.

Pasi dola në kambanare, e pashë fshatin që atje lart ashtu si nuk e kisha parë ndonjëherë tjetër: Pullaze të kuqe të vulosur me pulla myshku ngjyrë vaji, oxhakë të zinj, rrugë të ngushta, lumi si gjarpér dhe kopshtet e vogla sa një rogoz njëri, të ndarë dhe të rrethuar me gjerdhe e tela gjembash. Por... mu në oborr të kishës, tej në një qoshe nga ishin kosheret e bletëve, unë pashë qenin e stanit, Murron, me ato leshrat e tij të gjata që e bënin të dukej si ndonjë luan. Ai rrinte i shkujdesur aty në një qoshe, edhe sepse falë dhëmbëve të tij dhe forcës që kishte, nuk e ngiste kurrikush. Tashmë fshati i tërë ishte mësuar me Murron. Ky qen nuk ngiste kurrë, po të mos e ngisje. Murroja ishte i vllahinës Aleksandra, që asaj dite do të merrte uratën e zotit pér dialin që kishte lindur dhe medoemos rrinte atje në oborr duke pritur të zonjën e tij pér ta shoqëruar gjer në shtëpi. Burri i vllahinës, kishte shkuar me kopenë e dhenëve të fshatit tutje në Myzeqe, pér t'i kullotur delet gjatë vjeshtës dhe dimrit.

Prandaj unë u mora me detyrën e ngarkuar dhe kontrollova litarët. I preka, i tèrroqa, i provova! Litarët ishin aq të rregullt, aq të fortë dhe aq të shtrënguar pas gjuhëve të kambanave, sa këto gjuhë prej argjendi të lidhura me tèrkuza, kurrë s'mund

të kishin shpresë se do të zgjidheshin e do të liheshin të lira ndonjëherë!

Kur zbrita në kishë, shokët e mi i kishte përzënë prifti, kurse te dera e altarit, atje ku ishte ikona e madhe e shën Vasilit dhe shën Anës, po rrinte në fron vllahina Aleksandra duke pasur në prehër një fëmijë vocrak.

Aleksandra ishte një nuse trupngjeshur, e gjatë dhe e plotë, veshur me një farë xibuni prej shajaku të zi, në këmbë kishte këpucë të rënda me proqe hekuri dhe me një xhufkë të kuqe në majë, kurse në ballin e saj dallohej qartë një kryq mavi i vizatuar atje me ndonjë tatuazhë që në vegjeli. Nga lëkura, vllahina ishte aq ezmere, sa fare lehtë mund ta merrje pér kurbate. Aleksandra më ftoi t'i afrohesha dhe më vuri në duar një petull, që unë, i uritur si isha, e kapërdiva shpejt e shpejt. Ajo më përkëdheli kryet, më rrahu supin miqësish dhe më tha disa fjalë, të cilat unë nuk i kuptova fare.

Papa Jani i vuri lehonës një petafio mbi kokë dhe filloi nga të kënduarat. Unë mbaja shandanin prej tunxhi, në majën e të cilit qiriri digjej dhe ndrinte duke çuar në qiell fjalët e zotit pér vllahinën, që kishte sjellë në jetë një çoban të ri. Gjersa mbaruan të kënduarat, unë rrija sus duke duruar rëndësirën e tunxhit të verdhë e duke menduar pér atë çerek leku që do të merrja si shpërblim nga vllahina, sipas kodit dhe sipas rregullit dhe ligjit të pashkruar të manalëve.

Urata bëri që vllahina kaq herë të puthte kryqin dhe dorën e majme të priftit, kaq herë ja vajosi ballin me një bisht qiriri të ngjyer në ujë e në vaj të shenjtë nga vetë patriku i Kostandinopolit (ish e ndaluar të thuhej « i Stambollit »). Çdo gjë shkoi

në rregull gjer këtu, kur papritur prifti ndërroi zérin e vet, Nga melodi e ktheu në monolog:

— Tashti, ti e bukura e zotit, ke nevojë edhe për ninosje, lërja fëmijën manalit dhe hyrë në altarin e shenjtë!

Ajo u bind e përulur dhe e mallëngjyer, prapa saj u mbyll dera, kurse unë e mbajta ndër duar atë vocrrak me fytyrë të kuqe, që menjëherë dallohej se, kur të rritej, do të bëhej shumë zeshkan.

Por, nuk kaluan veçse disa minuta, kur fare papritur dhe pakujtuar, u ndje një britmë brenda në altarin e shenjtë dhe pastaj vllahina Aleksandra, hapi derën me térsëllëm duke bërtitur:

— Berihaj, o fshat!!!

Ashtu ajo u lëshua drejt meje dhe më rëmbeu foshnjën nga duart.

Dhe ja, pikërisht në këtë çast ngjau e papritura! Qeni bulldog, qeni i stanit, që vigjélonte atje në oborr, u lëshua turrap në kishë! Unë s'po gjeja vrimë ku të futesha dhe sa të kishte kohë vllahina të më mbronte, Murroja inatçi mu lëshua sipër dhe më kapi përfustani. Unë bërtita dhe u sprapsa, shandani më shkau nga duart dhe i ra qenit mbi kokë, qeni e mori këtë si tentativë dhune, ulériu duke më zvarrisur sa balli im u përplas mu në pllakaqen nën froni peshkopali!

Kurrë s'kam për t'i harruar ata dhëmbët e egër-suar dhe atë mishin e kuq të nofullave të tij!

Bëra të férkoja kokën që më gjëmoi pas shtrojës dhe menjëherë m'u llangosën duart me gjak, hundët më shkorin pizgë; hodha sytë nga zoti atje në ballë të ikonostasit dhe pashë Murron që pas thirrjeve të vllahinës ju vërsul altarit! Por Murroja

nuk e kapërceu dot barrierën e shenjtë sepse ikonat ishin prej pishe të fortë.

Nuk e di se si u gjenda në rrugë. Vllahina, në njëren dorë mbante foshnjën, me tjetrën më tërhiqte pas mua duke sharë dhe duke mallëkuar në gjuhën e vet me disa fjalë të pa kuptuara ku gërma «rr» shqiptohej keq; gjuha e Aleksandrës e fërkonte «rr»-ënë si të kishte haliç nën gjuhë.

Edhe sot e kam shenjë të çarën e kokës mu nën rrudhën e dytë të ballit.

Unë nuk e kuptoja atëhere se ç'pati vllahina që bërtiti «berihaj, o fshat», sepse çdo gjë ndodhi brenda në altar duke pasur për dëshmitar vetëm zotin.

Mbaj mend se në shtëpi ma mbështollën kokën me shami të bardhë, pasi ma plakosën plagën me duhan dhe me piper të kuq. Kisha të nxeh të e dhembje dhe asaj natës së parë fjeta keq duke mos qenë aspak në gjëndje për t'u marrë në pyetje...

Megjithatë, babai im, duke më ndenjur pranë, më pyeti ngadalë se çfarë pashë e si ndodhi dhe unë ju përgjegja sa më shkurt. Asgjë nuk dija seç bëhej jashtë. Nuk e dija se ishte ngritur në këmbë fshati i tërë dhe desh ta çante më dysh papa Janin!

Por, ja, në kohën që në sofrën tonë ishte shtruar lakuori dhe ne të gjithë po hanim drekën, dikush troket në derë, dera hapet dhe... na hyn aty brenda vetë papa Jani! Ngriti dorën lart, bashkoi tre gishtat dhe bekoi: «Zoti qoftë me ju!»

Babai uli kryet dhe s'ju përgjegj, kurse gratë e shtëpisë deshën, s'deshën, u ngritën më këmbë.

— Urdhëro, të paçim uratën!

Tani babai hungroi me inat dhe s'e ngriti kryet fare. Prifti u shti sikur nuk po vinte re ftohtësinë e pritjes. Foli:

— Kaq herë më ka porositur mëmëgjyshja juaj që të vij dhe t'i këndoja shtëpisë, meqë keni shumë minj... Shty sot e shty nesër dhe gjer tanë m'u bë mbarë të vij... pastaj dua të shoh pak edhe këtë bandillin e vogël... Çudi e madhe xhanëm! Se si na ndodhi dje me atë djall qen aty në kishë!

Heshtje e plotë. Vetëm gjyshja u gëzua për ardhjen e priftit. Ajo ishte shurdhe dhe, që të mund të dëgjonte sado pak, duhej ta mbaje për dore dhe t'i bërtisje fort.

I shoqëruar nga mëmëgjyshja, papa Jani i ra shtëpisë poshtë e lart, me kryq në duar duke kënduar dhe duke bekuar, spërkati me ujë të shenjtë dollapët e thellë dhe vrimat e mureve, ndërkokë që mua sa edhe mëmëgjyshes m'u mbush mendja top, se paskëtaj minj s'kishte për të pasur më në shtëpi. Por, kur zbriti prifti nga shkallët, e dëgjova që i thirri mu në vesh gjyshes:

— Tashti nuk do të kesh më minj...

Ajo e vështroi edhe një herë e hutuar dhe ngriti duart nga qielli. Papa Jani, për t'u siguruar, ja kapi dorën dhe i foli edhe një herë:

— Minj s'ke për të pasur, por është e mira të merrni edhe ndonjë mace...

Babai hundë e buzë mërmëriti:

— Ja, na e mbushe mendjen tashti!

Prifti na u ul në sofër, gratë i thanë:

— Urdhëro e merr pakëz lakror, uratë.

Urata zgjati dorën mu në mes të tepsisë, pikërisht tek ajo thelëza e përskuqur, së cilës ja kisha vënë syrin unë... Dhe, me të zgjatur dorën ai, i vura re se gishtin tregues të dorës së majtë e kish çollak dhe të cunguar, të prerë.

— Thoma, o i krishterë i zotit, — ju drejtua ai

babait — ti je tamam si shën Thomai, nuk beson kollaj. Por ta shpjegova edhe dje, o besniku im, unë s'kam ndonjë faj. Kot u rrëmbye dhe thirri: «Berihaj» ajo e mallëkuar vllahinë... A e sheh këtë gishtin tim të prerë, o zoti Thoma? E pra, mëso se këtë gisht unë e kam prerë me sëpatë dhe me dëshirën time të plotë. Pse e preva? E preva që të lë duhanin. «Çak' me teħun e sëpatës dhe... s'kam pér të pirë kurrë duhan! Jam njeri me vullnet të fortë unë, zoti Thoma... unë...

Gjer këtu dhe «zoti Thoma» ja ktheu:

— Ujku qimen ndërron, unë s'i ha ato dëngla... hidhua qenve...

Papa Jani u tērbua. U ngrit rrëmbyer si njeri i fyer rëndë, përmblodhi mëngët e gjata të rasos dhe u bë gati të dilte:

— Do të iki, zoti Thoma! U pa puna! Ju nuk i besoni as priftit, që është njeri i zotit. Do të mbledh plaçkat që sot dhe do të iki! Po ju lutem shumë të paktën më jepni nga dy-tri pashë litar, sa të lidh den-gjet e plaçkave!

Babai s'e ngriti kryet, nuk desh ta shihte në sy dhe më bërtiti mua:

— Shko nxirri tri pashë litar nga samari i gomarit dhe jepja të qërrrohet!

U mundova të rendja shpejt e shpejt dhe u ktheva me litarin në duar. Vetëm tani babai e ngriti kryet dhe, duke e vështruar vëngër, i tha:

— Merre litarin, po deshe, të japim edhe një kallëp sapun!

Papa Jani u xhindos, u lëshua nëpër derë dhe u zhduk.

## **NE DHE GAQO MORRAMANI**

Edhe sot e kësaj dite, kur e shoh Gaqo Morramanin, më vjen ta çaj më dysh dhe e vërej shtrembër. As e përshëndes e as i them mirë mëngjez. Gaqoja tani është plak nja shtatëdhjetë e ca vjet, kurse mëria ime është që këtu e dyzet vjet më parë. Gaqo Morramani në jetën e tij ka ndërruar (ose më sakt, i kanë ndërruar) tre mbiemra. E ka pasur Gaqo Ndrio, pastaj ja ngjitën Gaqo Bixhozi dhe më në fund, Gaqo Morramani. Tani merret me punët që nga matrapaz e tatëpjetë, por më s'ja var njeri. Sir doqoftë, secili mbiemër ka historinë e vet.

Gaqoja ka qenë pasanik në fshat dhe në shtëpi kishte vëtëm të atin. Po, kur plaku ra e vdiq, Gaqoja filloi të shiste një nga një të gjitha ngastrat e tokës. Me paret e tyre luante kumar në qytet dhe pinte raki në fshat. Ishte koha kur mbiemri, nga Bixhozi ju kthye në Morramani, sepse mbeti teneqe nga xhepi dhe, që të mbushte barkun me bukë, vidhëtë ku të mundte. Dalëngadalë edhe ato rrrobe që kishte ju grisën e ju tretën, çizmet i bëri këpucë, pastaj këpucët i ktheu në opinga, mbante një kosor çeliku në brez, gjithë ditën gjuante zogj, natën u

shkulte bishtat kuajve që të sajonte leqe, pastaj gjuante peshq nëpër pellgjet e mëdha të lumit, duke hedhur në to shishe me gëlqere të pashuar që pëlçisnin në fshat, tamam si bomba dore. Dilte pyllit dhe gjente zgjoje bletësh... S'u vinte tym që t'i mblidhte, por u kallte zjarr që t'i digje. Pastaj u merrte mjaltin dhe s'pyeste në ishte koha e roitjes, apo ishte koha e shtimit të gjësë së gjallë ndër pyje. Ai bjer e vra, bjer e shkatërrro. Mbi të gjitha, e keqja më e madhe ishte se na binte më qafë neve të vegjelvë...

Gaqo Morramanit i vareshin leckat, kur shkon-te rrugës dhe i téri mbante erë mish pastërmaje dhe raki. Duart i kishte të çjerra prej grifshave dhe prej ferrave, këmbët i kishte copë-copë, kurse kokën e kishte gjithnjë me gunga, sepse, pasi pihej, s'dinte ç'bënte dhe përmbysjej herë këtu e herë atje.

Gaqoja, kur i thoshin Gaqo Bixhozi, erdhi një ditë në fshat dlhe na la të gjithë gojëhapur me marrrëzitë dhe çapkënllékun e tij. Kishte marrë me qira një «Shevrolet» e në të kishte futur një palë saze. Por jo çfarëdo sazesh! Midis grupit të muzikantëve ishin edhe dy vajza jevga. Njëra këndonte, tjetra i binte dajres. Kur këndonte jevga, Gaqo Bixhozi rrëkëllente gurmazit krejt rakinë e njërsë shishe, kur i binte dajres ajo e dyta... Gaqoja i hidhej përqafe, sa gratë e fshatit mbulonin sytë me duar. «Shevroleti» rrötullohej nëpër fshat, Gaqoja kapardisej e fryhej, e as begeniste t'i fliste njeriu, as përshëndeste e as shihte njeri në sy. Vështrimi i tij kërkonte të thoshte:

«Unë jam! Më shihni mua? Jam Gaqo çapkëni, që i vura zjarrin pasurisë, se e kam zemrën të bardhë, prej piganiku!»

Ndeshja jonë e parë me Gaqo Morramanin, me sa më kujtohet, ndodhi një ditë, kur ne të vegjelit ktheheshim nga pylli me qese të mbushura me lajthi. Gaqoja na preu rrugën dhe na detyroi të dyrmbëdhjetë shokët të uleshim shesh dhe t'i zbraznim qeset tona në thesin e tij. Ne nisëm të qanim e të bërtisnim, filluam të kujtonim baballarët dhe vellezërit e mëdhenj, nisëm të kujtonim qentë tanë dhe gurët me xipa, por... ishim thellë pyjeve dhe Gaqo Morramani s'tundej nga kërcënimet dhe përgjërimet tona. Atëhere bëmë tërheqjen e parë dhe i propozuam që t'i jepnim «një të dhjetën», ashtu si u pa-guanin prindërit tanë dhjetarëve e spahinjve përbereqetin dhe bukën e gojës, por Gaqo Morramani ishte i patundur!

— Zbrazni qeset me kohë, se përndryshe kam për t'ju lidhur të gjithë pas ferrave, sa të vijnë uj-qerit dhe t'ju hanë!

Dhe, pasi na i mori lajthitë, Gaqo Morramani filloj të ligjéronte e të përligjte veprimin e tij:

— Nuk është e drejtë që unë të vuaj dhe ju t'i keni qeset plot me lajthi, ju të keni bukë, unë të mos kem!

— Po mirë, o Gaqo, — guxova dhe i fola unë — puno si gjithë bota dhe të kesh!

Ai u shëmtua në fytyrë dhe bëri sikur s'dëgjoi, kapi për flokësh njërin nga ne dhe filloj të na i merrte me forcë lajthitë. Kështu, pasi na i mori lajthitë, Gaqoja filloj edhe të tallej me ne dhe të na pyeste për punët tona më të brendshme. M'u drejtua mua:

— Pa më thuaj ti, mistrec, a ke nuse ti?

Ç'është e drejta, unë herë kisha e herë s'kisha, si të frynte era dhe si të ishte dita, por e kuptova se,

po t'ja lëshoje fillin Gaqos, ai ishte gati të të rrëmbente edhe kokën. Kështu që ja ktheva:

— Unë nuse nuk kam, se s'jam rritur për nuse, por ti shih veten tënde, që je goxha burrë dhe mbe-te beqar, të vdiq yt atë dhe i re mallit e gjësë së gjallë dhe i bëre rrush e kumbulla, turp të kesh!

Nga një shpërthim i tillë Gaqoja u xhindos dhe m'u vërvit:

— Ta dish, ti je i dënuar me vdekje, kur të më mbushet mendja mua, koka jote do fluturojë si la-kër e arrirë!

— Prite... — ia ktheva unë — prandaj më ka rritur babai mua, kur të kthehet ai nga kurbeti me atë shpatén e madhe, pa e shohim pastaj edhe atë kokën tënde!

Gaqoja vuri buzën në gaz dhe qeshi hidhur. Desh të më përqmonte:

— Ikë tutje, ti je kokëmizë e gjizanik!

Këto fjalë në fjalorin e Morramanit duhet t'i kishin rrënjet te miza e të gjiza. Por ai për të na trembur na u vërsul të gjithëve:

— Po ti atje, pse i trazon hundët? Po ti tjetri, pse qesh? Po ju të gjithë, pse nuk më pranoni mua për kryetar? Pse nuk blini mend nga unë, ju gjizanikët e djallit?! Unë jam më i madh dhe unë duhet të mbretëroj mbi ju të gjithë!

Përséri u trimërova e ja ktheva:

— Ti, Gaqo, na lërë rehat, se, e di? Unë të them ashtu...

Ishte fjala për t'i thënë mu në sy «Morraman».

— Thua, po unë me dhëmbë të ha kërcen e veshit! Le që ti je i dënuar me vdekje!

Ja, kështu shkonitejeta jonë asaj kohe, nën hundët e Gaqo Morramanit dembel, që priste të

rronte mbi kurrizin tonë. Ne ishim çunakë këmbë-zbathur, që na lëshonin nënët që në mëngjez çaireve, ashtu si lëshonin viçat dhe na prisnin në mbrëmje, kur ktheheshim, si gjëja e gjallë nga kullota. Sepse edhe drekën e kullosnim koriyeve me lajthi, pyjeve me thana dhe, kur s'ishte kohë e këtyre, kullosnim sipas stinëve: herë hanim kokrra dëllinjash, herë pestil ahu e pishe, më tutje hanim manaferra e kë-purdha, pastaj futeshim kopshteve e hanim bizele të njoma nëpër kopshtet e botës, kurse në kohën e kumbullave mund të haje sa të të desh xhani e njeri as të shante e as të përzinte, sepse asaj kohe kumbullat e egra ishin zoti i kodrave dhe bukuria e pllajave!

Kështu që Gaqo Morramani (atëhere duhet të ishte nja tridhjet vjet djalë) nuk na ndahej dhe nuk na linte rast pa na shkundur qeset, pa na vjedhur dhe pa na munduar.

Por një ditë... Gaqo Morramani u martua!

Ne e brohoritëm këtë ngjarje të madhe, jo përllogari të Gaqos, se sa përheshapin tonë. Mendoam se tashmë Gaqo Morramani do të shtrohej pas nuses e më s'do të na binte më qafë. Atëhere, si thashë, Gaqoja ishte tridhjetë vjeç, nusja njëzet e pesë, kurse ne nga shtatë a tetë.

Por... një ditë, sapo kishim dalë nga pellgu i madh ku ishim larë përbukuri në atë tinën e turbulluar, që mbante erë peshk e baltë. Ishim larë e ishim lodhur dhe po gatiteshim t'u vërsuleshim kumbullave me lëng, kur na afrohet Gaqo Morramani. Krahun e djathtë e kishte plot me leqe. Ne s'i folëm fare. Ai po mendohej.

«Epo, mendohet, se nusja në shtëpi i kërkon bukë.»

Gaqoja u shtrua në mes tonë si ngaherë dhe na bërtiti:

— Pse s'flisni, o gjizanikë?

Askush s'u përgjegj përvëç Llaqit, i cili me sytë përdhe ja ktheu:

— Prapë na erdhe, o Gaqo? Po pse s'e more edhe nusen, o?

Në çast ne ja plasëm një të qeshure, një gazi e një brohorie, sa Gaqoja u ngrit si i tërbuar dhe ju vërsul sipër Llaqit. Ne mundoheshim ta shpëtonim Liaqin me të lutura e me të qara e me të bërtitura, në kohën kur shpina e njomë e shokut tonë po gjëmonte si të ishte daulle. Gaqoja e rrihte, kurse ai s'përulej dhe i cirrej:

— I poshtë! Maskara! Pse më rreh, o dembeli i fshatit? Më ke dhënë ti ndonjë copë bukë mua?

Gaqos i kishte hipur tërbimi dhe inati e shkulli nga brezi rripin.

Ripi prej lëkure i Gaqos!

Ishte i jashtëzakonshëm! Ndoshta ishte e vetmja gjë e saktë që i kishte mbetur nga pasuria e të atit. Rrip lëkure me një tokëz fildishi, ku dukej koka e shëmtuar e një hipopotami. Por sidoqoftë, koka e hipopotamit s'ishte më e shëmtuar se sa koka e Gaqo Morramanit!

Gaqoja e zvarrisi Llaqin e lidhur, e çoi gjer tutje te rrënjet e një shelgu dhe i tha:

— Ti je lugat, je i arrestuar, je kriminel si Cutja e Peçi Dosti!

Por Llaqi mbahej trim dhe ja ktheu:

— Dale, pa ke për ta parë ti!

Si përgjegje Llaqi hëngri edhe një shpullë fytyrës, e pastaj Gaqoja na u kthyte neve:

— Të gjithë kam për t'ju rrahu dhe për t'ju lidhur, të gjithë kam për t'ju...

Dhe, ndërsa Gaoja po merrej me ne dhe i kish-te kthyer shpinën «të arrestuarit», Llaqi, shoku ynë, se si u vërtit dhe se si bëri, u çlirua vetë nga rripi dhe erdhi e i thirri vrapi me... ikë të ikim! Unë e pashë Llaqin kur i thirri vrapi, por si unë, edhe shokët u shtimë sikur nuk po ndodhë gjë. Dhe Llaqi, duke ikur, mori si plaçkë lufte edhe rripin e bukur!

Pas pak Gao Morramani se si e ktheu kokën andej dhe u lemeris. Por nuk ja mori vrapi. U mëndua një çast dhe pastaj na u kthye neve:

— Shkoni gjejeni, e të vijë këtu të dorëzohet dhe të më sjellë rripin! Dhe ta dini, unë ja ku po e dënoj me vdekje atë maskara që guxoi dhe iku nga burgu ku e lëshova të qëndronte. Ai éshtë i dënuar me varje!

Ne vështruam nga degët e shelgjeve, ku do t'i koloviteshin këmbët shokut tonë që u dënuar me varje.

Tani Gaoja mbeti me duart në pantallonat dhe nga një gjendje e tillë e qesharake ne gjetëm rastin që t'i thernim vrapi. U lëshuam ku sytë këmbët në rendje e në fluturim, por ai u vërsul të na përbante, dha disa shqelma andej-këtej gjersa te një kapërcim i hendekut se si i ndeu duart përpara të më kapte mua, kur pantallonat i ranë... Megjithëse isha në hundët e armikut dhe gati të bija nën thonjtë e tij, ja krisa të qeshurit nga pamja që kisha përballe, kërceva edhe një herë përpjetë, por Gao Morramani nuk mundi të më kapte! Ju ngatërruan pantalonat dhe u përmbyss:

Ne u përhapëm nga të gjitha anët si një çetë e

tërë duke qeshur dhe duke brohoritur, Gaqos i shkrepëtinë sytë nga inati, kur ne vumë re se ai mori rrugën drejt lagjes së lartme. Andej ishte shtëpia e shokut tonë Llaqit, që tashmë ishte heroi i ditës. Ne parandjemë një ndeshjë, sepse Gaqoja do të kërkonte rripin e vet, ndërsa tani Llaqi duhet t'i kishte treguar të atit çka i kishte ndodhur e si kishin shkuar punët! Dhe babai i Llaqit, Pando Koxhari kishte dy grushte si panxha dhe ishte prej atyre që i thoshin sherrit. «Lepe»!

Larg e larg ndiqnim Gaqo Morramanin dhe bërtisnim:

— Gaqoja do ta varë Llaqin! Gaqoja do ta varë Llaqin!

Çeta jonë ndërronte formë orë e çast, gjersa u ndodhëm përpara portës së Llaqit. Gaqoja trokiti fort në kanatin e jashtëm. Një kone lehu në oborr, pastaj doli gjyshja plakë e po tirrte lesh me furkën ndër duar.

— Ç'kérkon! — ja pat plaka dhe fytyra e saj u ngrys.

— Dua atë mistrec Llaqi, më rrëmbeu rripin.

— S'ka ndonjë Llaqi këtu — ja ktheu plaka dhe lëpiu me gjuhë gishtat dhe me ata gishta të njomur zu të dridhët fillin e shtëllungës.

Ne e dinim fare mirë se tani Llaqi ishte struktur në kashtoren atje afër dhe i dëgjonte të gjitha. Gaqoja foli përsëri:

— Do të hyj në shtëpi të bëj kontroll!

— Ti do të hysh për kontroll në shtëpi?! Në mall të sat ëme, apo tyt eti je? — dhe plaka ja preu rrugën. Gaqoja bëri ta shtynte, kur teto Pola ngriti lart furkën. Ajo furka kishte tri majë me cipa të

mprehtë. Sikur gjyshja t'ia fuste Gaqos me bigat në sy!

— Ku do kontrollosh ti, mor rezil, në mall të tyt eti, që e ke bërë shesh e lëndinë!?

Gjuhë kishte tetu Pola! Gjuhë për armik!  
Plaka thërriste, konja lehte, Gaqoja ngulte këmbë:

— Të dalë ai e të më japë rripin, se ndryshe do ta kalb në dru!

Ne menduam se Gaqoja e hoqi dënimin me vdekje.

— Dhe ti, plakë, mos i dil krah, se e merr më qafë dhe bëhet sherret!

— Posi, posi, do të të ngjasë ty!

— Pse, hajdut jam unë?

— Burri i mirë je!.. Maskara je, hajdut je, turp të kesh, shkon dhe u bie më qafë fëmijëve! Po ç'të bëjnë fëmijët, more, mos paç kokë!

— S'u bie më qafë unë...

Gjer këtu dhe s'durova dot. Zura pozicion luftarak kundër Gaqo Morramanit e prapa gjyshes Polë, nxora prazhdën nga xhepi e ja ktheva armikut:

— Ti, ti na bie më qafë, ti na nget, ti na rreh, ti na i zbras qeset e bukës kur kullosim lopët, ti na i zbras qeset me lajthi, kur ne mezi i mbledhim, ti na pyet për nuset, s'ke as turp...

Mos vallë i bëra të gjitha këto duke pasur për udhëheqës Luftarak veç gjyshen Polë me furkën e saj? Jo! Jo! Mu në qoshe të rrugës pashë tek doli Pando Koxhari, i ati i Llaqit. Po vinte nga malë me sëpatë dhe me tre kuaj ngarkuar me kopaçe. Mbi supe sot xha Pandoja po sillte edhe një tra prej ahu. Trari ishte i rëndë, sa Pandoja përkulej nga pesha e tij. Ai traushi i njomë sapo ishte prerë e mbante erë pyll e fletë ahu.

Por ja se edhe luftëtari i ditës, heroi ynë, Llaqi, i dënuari më varje se nga dolli e zuri vend në istikam me rrobat plot me kashtë e kokën plot me byk. Tani në mes ishte Gaqo Morramani, në këtë anë ne, e prapa Gaqos ishte Pando Koxhari me tri barrë korpaçë. Armikun e kishim në mes, sipas çdo rregulli të strategjisë e të taktilës luftarake.

Gaqo Bixhozi u shti si njeri pa faj:

— Zoti Pando, të lutem shumë, ky djali yt më rrëmbeu rripin dhe s'do të ma kthejë!

— Rripin? Djali im? Unë e shqep në dru!

Dhe Pandoja e kërkoi të birin me sy. Morramani fërkoi duart dhe nënqeshi. Po atëhere e gjithë çeta jonë u lëshua në sulm:

— Jo, jo, xhaxha Pando, ky gënjen, Gaqoja e rrahu Llaqin, veç ta shohësh se si já ka bërë kurrizin!

— ... Pastaj, o xhaxha Pando, ky Gaqoja e dënoi me varje Llaqin, e lidhi me rrip dhe, që t'i shpëtonte litarit, Llaqi iku tinazi. Gaqoja desh ta varte në shelgjet, o xhaxha Pando!

Në ndihmë të çështjes u derdhën edhe lotët e Llaqit, edhe dënesat e tij, edhe shenjat e drurit që kishte ngrënë. Llaqit i hipi të qarët.

Sytë tanë po prisnin gapërr. Pandoja shkoi te barrët e kuajve e hoqi një vastarkë të gjatë.

— Krisi tani! Bjeri, xhaxha Pando!

Por babai i Llaqit e mori punën shtruar, i hoqi të gjitha ngarkaçet e barrëve dhe i hodhi poshtë, ashtu si bëhet para shkarkimit. Kapi litarët. Ne nxirtuan ta ndihnim për t'i mbajtur anët, se gjer në koçacet e samarëve s'na arrinin dot duart. Unë vura dy drurë kryq në këmbët e kuajve, që mos u goditeshin noçkat kur të binin drutë. Pandoja shkarkonte

dhe mendohej, por e vura re fare mirë se fytyra ju zverdh dhe mjekra zu t'i dridhej... kur Gaqo Morramani u hodh në sulm:

— Të lutem shumë, zoti Pando, ta mbledhësh djalin, se shumë po më bie më qafë!

Atëhere Pandoja ju përgjegj Gaqos!

— Po si të bie më qafë ky fëmijë, mor i hurit dhe i litarit?! Ti je maskara dhe i pacipë, horr i horrave, ti vec me hu merr vesh!

— Bjeri, xhaxha Pando!

Kopaçja e njomë e sapozbritur nga pylli u ngrit lart nga ato duart e mëdha si panxha të xhaxha Pando Koxharit. Ajo krisi aq fort, sa m'u duk sikur u ngrit pluhur mbi kurrizin e Gaqo Morramanit!

— Bjeri, ore, bjeri! — bërtisnim ne, ndërsa gjyshja Polë i jepte porosi:

— Shiko se mos e bësh me gjak dhe gjejmë belanë, po bjeri tuleve maskarait! Bjeri!

Atë gaz e atë brohori e atë lehtësi s'e kishim ndjerë kurrë ndonjëherë. Që ta çonte deri në fund inatin e vet, xhaxha Pandoja, ja rrëmbeu rripin nga duart Llaqit. Ne menduam se do t'ja kthente Gaqos, kur Pandoja u kërrus, e vuri rripin mbi një dru dhe... krap, krup; krap... e bëri copa-copa me te-hun e sépatës. I mbeti në dorë veç një llapëzë lëkure me atë tokëzën prej fildishi ku dukej koka e hipopotamit. E pa një herë tokëzën e pastaj e lëshoi mbi gur e ja këputi me mykën e sépatës. Ajo u bë copë-copë!

— Shporru tani, qen, bir qeni, dhe, po deshe, bjeru më qafë fëmijëve! E kishe mbushur kupën, po prisja ditën, qen! — dhe, duke ju kthyer Llaqit. — Dhe ti, shejtan, të rrish urtë!

Gaqo Morramani, i rrahuur dhe si i ngordhur,

çalë-çalë u zhduk në qoshe të rrugës. Pandoja mblo-dhi litarët e samarëve, kurse mua (të themi të drejtën) më shkanë sytë pas bishtave të kuajve. Kishte ca kom... sidomos ai Gjoku! E të bëje leqe! E të kapje jo grifsha, as gushëkuqë, as mëllenja por... të Bukturën e Dheut!

Kjo ishte ndeshja jonë e parë, me të vërtetë luftarake, me Gaqo Morramanin...

\* \* \*

Në èndrrat e mia të fëmijërisë të papritura ndonjëherë, ka mbetur edhe èndrra për të gjetur një fole thëllëze në mal! Dëgjoja të thoshin se thëllëzës së malit (që është aq e bukur dhe aq krenare) s'mund t'ja gjesh dot folenë, thoshin se ajo pjell njëzet vezë dhe i kloçit që të gjitha, thoshin se vezët e thëllëzës së malit janë të bardha si shkumë e mbajnë erë dë-llinje, thoshin...

Pra, një mëngjez, unë një, Llaqi trim dy dhe Cile Bukuroshi tre, do të niseshim që të gjenim një fole thëllëze mali. E vendosëm që në mbrëmje kur ishim mbledhur hundë më hundë me hënën mbi kokë dhe me kupin e një plehu nën këmbë:

«Me ta gjetur, nuk do ta prishim; as do ta prekim, veç do t'u lëvdohemi të gjithëve... sepse vezët e thëllëzës, po i preke me dorë, ajo i braktis dhe nuk kthehet më tek ato.»

Me treshen tonë duhet të vinte edhe një i katërt.

Ky njeri ishte ai, për të cilin më mori në pyetje Gaqo Morramani asaj dite kur e dënoi Llaqin me

varje dhe kur vetë atij ju bë më i butë kurrizi se barku.

Pra shkuam të thërrisnim edhe shokun e katërt.

Ishte herët në agim. Freski pranverore. Bujqit po shkonin ndër ara me pendët e qeve përpara. Në-për puset ishin mbledhur vajzat e po mbushnin ujë, dëgjohej kërkëllima e zinxhirit dhe e kovës.

Pra, si ju thashë, me ne do të vinte edhe shoqja ime, Maria! I shkuam asaj nën dritare dhe Llaqi më tha:

— Tashti, si na u lëvdove, foli të dalë!

Mua s'ma mbante ta thërrisja, dhe përse nuk ma mbante, as unë nuk e dija. Atëhere Llaqi më tha:

— Ti u tregove kaq trim me Gaqo Morramanin, këtu pse s'ta mban?

Në vend të aksionit, unë propozova një pritje të vogël:

— Pa të shohim, ndoshta është ngritur!

Përgjova dhe në çast vura gishtin tregues mbi hundë:

— Shëët! Është zgjuar!

Mbajtëm vesh. U dëgjua fëshfërima e një fustani dhe një mërmërimë. Zhurmën dhe zërin ua shpjegova shokëve, kurse me sytë e mendjes pashë Marien me ata krahët e bardhë e të hajthëm duke futur në kokë fustanin e duke u veshur!

U dëgjua gurgullimë uji.

— Po lan faqet dhe gushën!

Tringëlliu një qelq.

— Po fut krehrin në poç dhe po kreh leshrat.

U hap një kapak dërrase:

— Po kjo zhurmë ç'është? — pyeti Cile Bukuroshi. — Hë?

Unë ja ktheva gjithë inat;

— Hë, mo, ti s'e kuption dot gjuhën e magjes, se ty ta jep bukën në dorë mamaja, ti je djali i makës, Maria e merr bukën vetë!

Pastaj për djall u dëgjua një si gérhitje e fortë, e pas gérhitjes zëri i ashpër i të atit të Maries që ju shkreh së bijës:

— Po ti, ku shkon kështu natën?

Ja, këtë britmë të ashpër as dija fare se si ta spjegoja.

Duke pshëretirë (më shumë se ata) u nisëm të tre për të gjetur fole thëllëzë mali.

Dolëm kodrave dhe nisëm të shëtisnim nëpër pllajat e mëdha të mbushura plot e përplot me dëllinja gjelbëroshe. Lëndinat ishin më bar të shkurtër dhe trualli kishte shumë këpurdha dhe gollunguna. Por... brodhëm kot së kati që nga agimi gjer në mesditë dhe nuk gjetëm dot asgjë. Si u lodhëm dhe po gatiteshim të niseshim pyjeve për të kulturotur drekën, kaluam nga Përrenjtë e mëdhenj. Por këtu... na doli Gaqo Morramani pas një ferre dhe na e ngriu gjakun me atë zërin e tij të çjerrë!

— Ku shkoni kështu, o gjizanikët e djallit!?

Ne s'ju përgjegjëm fare, sepse ishim në hasmëri me të që prej asaj dite, të cilën Morramani e mbante mend fare mirë. Po se mos ai kishte fytyrë e cipë! Na u vu pas:

— Përse më bëni zhurmë ju, gjizanikë? A s'e dini se unë kam ngritur koshat e po gjuaj thëllëza? Përpara, jeni të arrestuar!

Edhe këtu guxova dhe ja ktheva:

— Nuk e di ti që fshati e ka të ndaluar të gjuash zogj, kur kloçitin vezë?

— Ti, gjizanik, do të më mësosh mua? — ma ktheu Gaqoja — Përpara!

Na kapi pér supesh dhe na afroi nga vetja. Dhe fare papritur zëri i tij u zbut dhe u pakësua. Ai u kërrus mbi ne dhe na tha:

— Do t'ju tregoj diçka të jashtëzakonshme, diçka të madhe, të çuditshme!

Ne u strukëm pas tij dhe e humbëm fare toruan. Atëherë ai na i ngjeshi kokët pas njëri-tjetrit dhe na i përpoqi si të ishim gogla lisi.

Mua më lëshuan sytë shkëndija! Aq fort më dhembi balli, aq fort më krisi një eshtër në kokë, sa menjëherë më kërceu një xhungë mu përmbi vetull! Cilja ja dha të qarit, Llaqi u mbajt, kurse Morramani na u kërcënua:

— Hë, këlyshët e djallit!

Më shumë nuk foli, po ne e kuptuam se ai e kishte inatin tek ajo dita kur e rrahu Pando Koxhari. Pastaj na kapi pér veshësh:

— Shët! Mos qani, se do t'ju vras fare!

Kështu që asaj dite Gaqoja na vuri përpara, na futi në një farë pylli me fier të thatë dhe na kërcënoi:

— Të mbërtheheni këtu në vend, as të flisni e as të thërrisni, se tremben thëllëzat dhe s'afrohen!

— Po dale, o Gaqo, ne...

— S'ka dale këtu, po bëtë shamatë... E shihni kopenë e deleve andej lart?

— E shohim.

— Deleve u ka rënë sëmundja e gëlbazës.

— E pastaj?

— Bariu po u jep dhenve ilaç gëlbaze... Po bëtë shamatë, do t'ju fus në gojë edhe juve nga një prej atyre ilaçeve si ullinj, që janë të hidhura si far-mak.

Ñeve na shkuan të ngjethura në trup dhe u shëmtuat në fytyrë.

— Po kjo s'është gjë, — vijoi Gagoja — po më zemëruat, do t'ju vë vezë të nxehta nën sqetullat...

Dhe përfytyrimi ynë asaj kohe punonte aq mi-ri, sa na u duk sikur grykët na u çanë prej ilaçit të gëlbazës dhe sqetullat na u përvëluan prej vezëve të nxehta.

Deshëm, s'deshëm, atje ku na dënoi Gagoja, u ulëm galic. Vinte era e tharme e fierit plak dhe e fierit të ri, lart dukej veç qelli dhe frynte flindi si me magji nëpër rrënjet e barit. Unë u shtriva pas kërcejve të fierit. Ishin aq të shumtë dhe aq të den-dur, si një pyll i tërë. Nuk di se q'm'u shkrep dhe rashë në një farë përgjimi. Këtë e bëra që të mos i lija kohë Cile Bukuroshit të më akuzonte se u tre-mba prej Gago Morramanit.

Në një farë kohe Cile Bukuroshi më foli:

— Hej, q'po bën ashtu ti, Niço?

Këtu më duhej të shtihesha si shumë i mençur dhe ja ktheva:

— Po dëgjoj zërat e erërave dhe pres prej tyre urdhëra se si duhet të sillemi kundrejt Gago Morramanit.

— ... Ashtu?

Të dy shokët e mi u habitën dhe gati çapëluan sytë. Llaqi më foli:

— Po si i dëgjon ti zërat e erërave?

— Po i dëgjoj, o, pos, mos jam si ju, gomarë, që s'dini kurrgjë nga bota e ngajeta? Aty përpara dëgjoja nja dy burra të mëdhenj që bisedonin e thoshin: «Në kohën e ilirianëve, në kohën e Pirros së Epirit dhe të Aleksandër Mollosit...»

— Ç'i ke këta emra, mo?

— Prisni, mos ma këputni fjalën në mes, se zemërohem e s'ju tregoj asgjë!

Ata u nemitën fare dhe desh plasën nga zilia.

— Pra, në kohën e Aleksandër Mollosit, i cili ishte vëlla me Selam Musa Salarinë me shokë, do bëhej luftë kundër Gaqo Morramanit.

— Psee?! Që atëhere rron Gaqo Morramani?!

— Po q'pandehët ju! I sotëm është armiku ynë? Po mos ma prisni fjalën edhe një herë! Pra në kohën e Pirros së Epirit që kishte vëlla Selam Musanë, shkonin disa të mençur në qytetin Dodonë dhe atje në mes të një pylli pyesnin ujërat, erërat dhe rrënjët e drurëve nën tokë, i pyesnin se si duhej vepruar për të mundur Gaqo Morramanin dhe gjithë armiqjtë e tjerë. Dhe ujërat dhe erërat, edhe rrënjët jepnin përgjegje: «Duhet bërë luftë! Ose: S'duhet bërë luftë! Duhet vepruar kështu e duhet vepruar ashtu!»

— Ikë, mo, ti, Niço, gënjen — ma ktheu Cile Bukuroshi tërë mëllef e zili.

— Mirë, o, unë gënjej, ti po deshe mos beso, veç lermë të mbaroj.

— Po mirë, — vijoi Cilja — pyeti atëhere ato rrënjët dhe erën, përsë nuk të erdhi sot në mëngjiez Maria...

Kërceva përpjetë:

— Kur të ta fut kështu hundëve, pa të t'i bëj pëershesh! Gjizanik!

Hyri në mes Llaqi, se besëlidhja jonë mund të prishej përgjithnjë dhe pastaj unë si njeri i fyera edhe mund ta varja fare Cilen.

— Hë, mo, fut, fut de, fut... — më provokonte Cilja.

— Por unë isha i përhumbur pas disa punërave

shumë më të mëdha dhe më të rëndësishme se ajo e grindjes me Cilen dhe përsëri u shtriva sikur do të mbaja vesh. Ciles tanë vërtet iu mbush mendja se unë dëgjoja erën, por më gjërgiste se ma kishte zili.

— E, mo, — foli Llaqi — ç'thotë era, si duhet vepruar?

E tunda kryet nja dy herë dhe fërkova buzët:

— Gjëra të rëndësishme!

— ... Më qafsh!

— Thotë se kundër Gaqo Morramanit duhet vepruar ashtu si bënte Skënderbeu kundër pashait turk, duhet vepruar ashtu si thotë edhe kënga e flamurit: «Rreth flamurit të përbashkuar, me një dëshirë e një qëllim!»

Cilja desh plasi nga marazi për gjithë ato fjalë të mëdha e të mençura që thosha unë, kurse ai s'dinte gjë prej gjëje!

Për ta treguar edhe më tej mençurinë time, nxora nga xhepi atë shaminë e bardhë, me të cilën nëna më kishte mbështjellë bukën e mëngjezit, shkula nga driza një shufër lajthie dhe e bëra si flamur. Pasi i kreva këto, fola:

— Tani, o shokë, si e thotë edhe kënga:

«Rreth flamurit të përbashkuar,

me një dëshirë e një qëllim!..»

Do të nisemi kundër Gaqo Morramanit dhe fitoja është jona!

Por Cile Bukuroshi ma punoi:

— Ikë, mo ti, qenke fare gjizanik... flamur të bardhë ngrenë ata që dorëzohen, jo ata që luftojnë.

Ah, ç'më erdhi inat që Cile Bukuroshi i ra pikës. S'kisha si t'ja bëja, më zuri ngushtë, i dhashë të drejtë duke ulur kryet, ndërsa ai nxori nga quesja e vet një shami të kuqe dhe na tha:

— Unë e di se në luftë shkojnë me flamur të kuq!

— Kjo është shumë e vërtetë, — plotësoi Llaqi — kështu thotë edhe babai im, bile një ditë tregonte se tani po bënte luftë në Spanjë me një flamur shumë të madh dhe shumë të kuq!

— Po kjo Spanja nga bie — pyeti Cile Bukuroshi.

Këtu më erdhi rasti ta poshtëroja Cilen dhe të viaj nderin tim në vend. Ja ktheva krenar, pa e shikuar fare në sy:

— Spanja bie aty prapa malit Tomorr, dhe ajo shqiponja që po fluturon tani atje lart përmbi Gurin e capit... ja, shiheni edhe vetë lart në qiell, ajo shqiponja pra, e sheh tani me sytë e saj luftën që po bëhet në Spanjë!

Këto fakte që parashtrova unë, s'kishte burrë që të m'i hidhte poshtë. Spanja shtrihej prapa Tomorrit dhe lufta dëgjohej gjer aty.

Shqiponja e shihte me sy prej shqiponje.

Llaqi diç u mendua dhe tha:

— Për një flamur të kuq fliste babai një natë me një shokun e tij në shtëpi, por mua më flihej dhe s'i dëgjova döt gjer në fund. Por... tani a nisemi kundër Gaqo Morramanit!

— Nisemi!

— Nisemi!

Por në çast dhe Llaqi u step:

— Shokë, — na u drejtua neve, duke ngritur lart gishtin — a e mbani mend atë ditë kur hëngri dru Gaqo Morramani?

— E mbajmë.

— A nuk m'u kanos edhe mua babai dhe më tha: «Dhe ti, shejtan, të rrish urtë?»

Ra heshtje. Asnjeri s'fliste. Frynte era, fluturonte veç shqiponja atje lart në quell përmbi Gurin e capit dhe shihte Luftën e Spanjës. Atëhere Cilja mangjeshi me bërryl në ije dhe më tha:

— Hë, mo i mençëm, jepi përgjegje Llaqit!

Unë u shtiva sikur më dhemb shumë ija nga bërryli i Ciles dhe desha të merrja hak. Gjeta shkak për agresion, si i thonë tani, por mendova se isha para një çasti historik dhe mendova se, kur nisesh për luftë kundër armikut, s'duhet të kesh sherr në radhët e tua, por duhet bashkim dhe disiplinë. I fola Llaqit jo me fjalët e mia, por me ato të hymnit kombétar:

«Prej lufte veç ai largohet  
që është lindur tradhëtar,  
kush është burrë, nuk frigohet,  
po vdes, po vdes si një dëshmor!»

Kështu u nisëm drejt Gaqo Morramanit me flamur të kuq përpara dhe me prezhdat ndër duar. Ai, sa na pa që u ngritëm dhe bëmë zhurmë, na u vërsul si bishë. E... mirë po unë e kisha bërë gati fjalimin, bile fjalim pa të shkruar dhe ja nisa:

— Ore Gaqo Morramani! Ti që na detyrove të rrnim këtu në burg, ti je armiku ynë! Hiq dorë nga ligësia jote, se përndryshe ne ja japim kujes sa të tunden Përrenjtë e mëdhenj!

— Ia jepni kujes, po hani dru — ma ktheu ai.  
Dhe, duke na vështruar me dhëlpëri, ma ktheu:

— Ti folë për veten tënde!

E kuptova. Ai desh të na përqante, kurse hymni i flamurit fliste shkoqur: «të përbashkuar!»

— Jo, jo, — ja ktheva unë — ne jemi shokë gjer në vdekje dhe nuk tundemi, ti mos harro sa dru hëngre asaj dite. Se ti, o Gaqo, u mësove të rrihesh

si gomari! E mban mend se ç'të punoi Pando Ko-xhari kur dënove Llaqin me varje në litar! E mban mend?

Gaqo Morramani ishte gati të na jepte përgjegjen, por u gëlltit një herë se, medoemos, ju kujtua druri që pat ngrënë. Por fare papritur ngriti krahët dhe na tha:

— Në këtë çast e në këtë minutë e në këtë orë, një kope me thëllëza mali sapo u ul në koshat që kam ngritur unë, po hanë kokrrat e misrit dhe do kapen të gjalla!

Kështu që Gaqoja duhej të nisej menjëherë drejt koshave të vet dhe dashur padashur na lejoi të dilnim te një çukë atje më lart dhe të bënim sehir. Kështu që në saje të vendosmërisë sonë dolëm nga burgu me fier të kalbur dhe morëm përpjetë kurri-zin e një kodre. Më lart qëndruam.

Sa bukur përhapej drita e diellit andej nga Përrrenjtë e mëdhenj. Dielli ndriste bukuri, dëllinjat e mëdha tundeshin ngadalë dhe nxirnin një aromë të këndshme që na i mbushte mushkëritë plot me erë të mirë. Përtej dukeshin ca shkëmbinj të bardhë me damarë të kuq. Qëndruam mu në majë të çukës dhe hodhëm sytë poshtë. Nën ata shkëmbinj me damarë të kuq shtrihej një livadh i gjatë dhe mu në mes të livadhit ishte si një lëmë me rërë të bardhë. Ajo që një kumishte në formë gjatoshe dhe nëpër të dallo-hej një vijë e vogël uji. Ja, atje dukeshin thëllëzat!

Veç t'i shihje se si luanin, si kërcenin e si gërgiteshin dhe si harbonin thëllëzat nëpër kum! Pastaj pinin ujë dhe ngrimin kokët e sqepat lart drejt qiellit, e u shpaloseshin ato gushëzat e bukura plot me pupla të verdha e të kaltëra, ngjyrë manushaqe e ngjyrë vishnje! Bukuria e sqepave të tyre! Sqepa

të kuq e lyer si me lëng thanash, si të lyer me manikyr. Pastaj ja morën këngës! Ç'farë të kënduare që bën thëllëza e malit! Zérin e saj s'e ka asnje shpend tjetër! Para thëllëzës së malit bilbili është një këngëtar çapaçul. E sa u ka hije kënga atyre thëllëzave hijerënda!

Thëllëzat e malit s'kanë pupla pa hije e pa bukuri, pa nur e pa shkëlqim si i ka radhazi bilbili i cili, kur këndon, ka turp dhe fshihet. Thëllëza jonë e malit e ka veshjen e saj si askush tjetër.

A dalin vajzat tona në valle me kostumet e veta? E këto kostume a s'janë qëndisur që në kohën e zanave dhe të shtojzavalleve, në kohën e pellazgëve, ilirëve, thrakëve dhe të dakëve që hiqnin valle nën Rozafat, në sytë e Teutës.

Ja, që atëhere e ndoshta edhe më tutje do të jenë zbukuruar thëllëzat tona me ngjyrat e agimeve, të yjeve dhe të deteve e të maleve tona! Se jo më kot i quajmë thëllëzat e maleve!

Pra atë ditë thëllëzat po këndonin. Na e ngriten zemrën peshë dhe ne s'ngopeshim së dëgjuari e s'nginjeshim së shikuari! E keqja është se me të shkruar nuk e tregoj dot, as në nota muzike s'e fut dot, s'ka as tel e as bori e as zë njeriu që t'i afrohet sado pak. Ja, në këto çaste më kujtohet poeti shqiptar që shkruan:

«Unë jam një arbëreshe, rroj këtu në rrëza,  
një gjak e një gjuhë kemi me thëllëza.

Pëllumb e sorkadhe jemi farë e fis,  
kemi dhe shqiponjën gjyshen e shtëpisë!»

Dhe u përhumbëm aq fort pas asaj bukurie, sa harruam që Gaqo Morramani kishte ngritur atje thi-

kat është kurthet e tij. Por ajo ditë ishte fatkeqe për thëllëzat. Ato luanin e këndonin e s'dinin se çfarë i priste, sepse në një çast kopeja e thëllëzave u ngrit lart në fluturim, pór me një befasi të frikshme. Rreth e qark u ngritën pluhur, pupla, pendë e rërë. Një nga koshat e Gaqos kishte rënë dhe kishte mbyllur brenda tri thëllëza.

Prandaj kopeja e madhe e thëllëzave fluturoi ashtu si ne duke krakavitur, duke utruar e duke gulçuar me frikë e shqetësim. Çuçurisnin në një mënyrë të habitshme. M'u duk sikur midis tyre ra hija e vdekjes, m'u duk sikur ato midis tyre po rënkonin, e nëna pyeste për bijat e për vëllezërit dhe vëllezërit për motrat: «Kush e pësoi, kush mbeti rob tek ai hajduti me kosor në brez, që s'na lë të qeta të pimë ujë!? S'na lë në punën tonë që të ngrohem i një diell e të mbledhim ushqim për të vegjilit tanë e tua shpiem në fole? A, moj motra, moj motra thëllëza, ai faqeziu prandaj kishte hedhur kokrra misri te shuriga, me ato kokrra na mash-troi...»

Ne të tre rendëm te vendi i ngjarjes! Atëhere i pamë ato tri thëllëzat e kapura, kur Gaqo Morramani i nxori që nga vrima e sipërme e kurthit të madh.

T'i shihje se si përpëliteshin, qëllonin me sqep, cirreshin të trembura, të egërsuara, të tmerruara. Cile Bukuroshit ju mbushën sytë me lot, edhe neve me Llaqin na hipi vaji dhe filluam të qanim.

— Po lëshoji, o Gaqo, se është gjynah, lëshoji o!

— Ikni tutje, më gjizanikë, kokëmiza! — na e ktheu ai.

Këtu m'u kujtua vjersha e Naimit që na kishte mësuar nëna dhe e thoshte zogu:

— Të mjerët ne, përse na ngini,  
në punën tënë pse nuk na lini?  
Më pret imëzë si ty jot ëmë,  
të mos i vete, ç'bëhet prëmë?..»

Thashë t'ja recitoja këtë Morramanit, po ku merrte pykë ai! I shtrëngonte fort thëllëzat pas atyre këmbëve të tyre aq të bukura, ndërsa ato s'qëndronin asnjë çast, po vetëm përpëliteshin. Ja kishin gjakosur duart Morramanit me sqepat e tyre, kurse ne i thërrisnim që prapa ferrave:

— I lig! I poshtër! Lakut! Hajdut! Morraman!

\*

\* \* \*

Në mbrëmje u kthyem në shtëpi zemërvrarë. Ngjarja e asaj dite na lëndoi aq shumë, sa s'mund ta harronim. Më dridheshin buzët dhe më shkonin lot faqeve. Natën fjeta keq. Në një kohë u zgjova dhe pashë nënën time që më rrinte pranë dhe më vinte në ballë lecka me uthull. Kisha pasur zjarrmi.

Pastaj mësova se nëpër èndërr kisha thirrur e bërtitur për zogjtë fatkeqë që më kot prisnin nënën t'u sillte ushqim, kisha thirrur emër më emër të gjithë burrat dhe djemptë e fshatit që të mblidheshin e ta lidhnin duar e këmbë atë të poshtrin, Gaqo Mcramanin.

Duke më vënë lecka me uthull në ballë, nëna desh të më qetësonte:

— Tani, biro, thëllëzat sapo kanë pjellë vezët. Më tutje i klloçitin, nxjerrin zogj e pastaj i rritin dhe i mëkojnë.

— Jo, i kanë klloçitur! — ja ktheva unë.

— Po ku e di ti, biro?

— E di unë, pashë ëndërr!

— Epo mirë, ashtu qoftë, tani qetësahu, unë nesër do të të jap një qese me gëzhuta ose me thërrime buke.

— Jo, jo, edhe gëzhuta, edhe thërrime.

— Epo mirë, edhe gëzhuta, edhe thërrime, merr shokët e tu, merr edhe Marien, do t'i them unë babaít të saj, se ti Marien e ke motër.

— Ashtu e kam.

— Dhe të shkoni pa t'i gjeni foletë e thëllëzave e t'u jepni gëzhuta...

— Po ai Morramani ç'i bëri thëllëzat, o nëne?

— Ah, katili, katili, do t'i ketë therur!

\*

\*

\*

Ne shkuam të nesërmen. Unë një, Llaqi dy, Cile Bukuroshi tre dhe katër... Maria! Por shkuam edhe të pasnesërmen, ditë pér ditë pér të gjetur foletë, por më kot. Ditën e shtatë na doli përparrë Gaqo Morramani. Mbante në duar me shumë kujdes kapelën e vet. E mbante sikur ta kish vorbë dhe druhej se i thyhej. Ai kishte gjetur një fole thëllëze dhe desh të na merrte me të mirë:

— Ejani, o gjizanikë, ejani t'jua tregoj...

Ne nuk deshëm t'i binim pas, por kureshtja na tërhoqi. I shkuam pas Morramanit. Kaluam një larin gjembash e halthe dëllinjash. Në fund të disa rrënjeve dukej një fole thëllëze, por fare e zbrazur. Atëhere Gaqo Morramani qeshi me të gjithë suratin e tij të parruar, gjithë dregëza dhe të çjerra. Na tha:

- E shihni këtë kapelen time?
- E shohim.
- Po ta dini se çfarë kam këtu brenda...
- Nuk e dimë.
- Po ku ju punon mendja juve gjizanikëve të djallit! Ju jeni kokëmiza, ja, këtu në kapelë kam të gjitha vezët e folesë së thëllëzës!
- Po si i gjete, o Gaqo?
- Si i gjeta! Me zotësi, me zgjuarësi, i shtrëngova thëllëzat që kapa.
- Për fytì?
- Ta pret mendja! I rraha, i mundova, i vara kokëposhtë, u vura tym në hundë... gjersa më tre-guan se ku i kishin foletë!
- Ti, Gaqo, je njeri i lig — i thamë ne njëzëri.  
Ai ja shkrepri gazit me të madhe e pastaj na tha:
- Unë jam shumë i mirë, dhe jam gati t'ju jap nga një vezë thëllëze, po të më jepni ju të gjithë çka keni nepër qeset.
- Përgjegjen ja ktheva unë ashtu si e desh:
- Ne ty s'të japim as barin e zgjabes!
- Po unë ju jap vezë thëllëze!
- Nuk i duam, mbaji për vete, i paç hair zana-tit, i lig! Si nuk t'i theu fare kockat babai i Llaquit?!
- Të dëshpëruar ikëm prej Morramanit dhe shkuam te Çuka lart. Atje bëmë një këshillë:
- «Ç'farë t'i bëjmë Gaqo Morramanit ne? T'u themi të gjithëve në fshat për vezët që u prishi edhe për thëllëzat që i mundoi derisa ua nxori shpirtin, t'u themi që ky njeri është lakut, i poshtër dhe pri-shanik!»
- Por, duke folur kështu midis nesh, na tërhoqën vëmendjen disa lëvizje të çuditshme të Gaqo Morramanit. E lamë këshillin në mes dhe zbritëm drejt

tij. Dhe, kur i vajtäm pranë... çfarë tē shihnim? Gaqoja kishte ndenjur mëgjunjaz pérpara kapelës së tij dhe po hante vezët e thëllëzës. I hante ashtu si ishin me gjithë guackë. Ne e shihnim me neveri.

— Kështu janë më tē mira, — thoshte ai — tē forcojnë kockën!

I derdheshin pas buzëve disa jargë tē verdha prej vezëve që i kullufiste si ndonjë qen lakut.

Maria filloj tē qante. Ne tē tjerët që i thoshim vetes burrë e përpjetë, u përbajtëm. Pastaj shkuam përsëri te maja e çukës dhe rifilluam këshillimin tonë:

— Unë them që Gaqo Morramanit t'i themi edhe një llagap tjetër!

— T'i themi fashist!

— Po ç'është ky fashist?

— Ky është një spanjoll me një sy tē vetëm që ha fëmijë tē gjallë!

— Mirë. I themi fashist.

Por unë dua t'i thërresim edhe një tjetër...

— Çfarë tjetër?

— T'i thërresim Stojan Viçi.

— Mirë, edhe Stojan Viçi.

— Po ç'është ky?

— Ky është një sërb, është një... s'e di mirë, por më duket se babai ja thoshte emrin Stojadinoviç, egërsirë me fytyrë njeriu.

Dhe që nga maja e çukës ua dhamë thirrjeve me sa na hante në kokë:

— Morraman! Fashist! Stojan Viç! Prishanik! Hajdut! Lakut!

Grykat dhe pllajat i rrëmbyen zërat tanë prej fëmijësh e ja dhanë jehonës dhe jehona i përhapi grykave, kodrave, nëpër pyjet, nëpër malet.

## ZOGU I ZI

Asaj kohe, kur unë isha vetëm gjashtë a shtatë vjeç, njerëzit bisedonin fshehur, por me shumë zjarr pér disa ngjarje të mëdha që unë nuk e dija pérse quheshin «ngjarje politike». Kësaj fjale unë nuk ia dija fare kuptimin dhe e pandehja herë të ishte mjekra e priftit, herë pushka e xhandarit, kur se disa herë më mbushej mendja se ishte vetë penda e madhe që vërtiste gurin e mullirit. Dhe ndër këto bisedat e fshehta që kryhesin netve të dimrit, kur dy-tri familje mblidheshin kokë më kokë rreth një zjarri të vetëm, zihej në gojë një i quajtur Fan Nol dhe shahej me të madhe një tjetër që quhej Zog. Unë vrisja mendjen të kuptoja se cilët ishin këta, edhe ai që shahej, edhe ai që lëvdohej, por nuk i bija dot në të.

Këtij Zogut, që e thërrisin edhe «Zogu i Zi», i ngarkohej faji se kishte vrarë prapa shpine e më të pabesë një patriot që quhej Avni Rustemi! Ky Avni Rustemi na ishte një shqiptar i madh, sepse mu në mes të Parisit kishte shtrirë pér tokë Esat Pashë Toptanin, i cili desh të copëtonte Shqipërinë dhe na ishte dajë i Zogut të Zi.

Jashtë binte borë me flokë të mëdhenj të trashë, veriu frynte e shfrynte, harabelat çukisnin në dritare dhe kërkonin thërrime buke e, kur s'gjenin, futeshin kashtoreve nëpër byk për të shuar urinë.

E shihja botën e ngrirë që prapa xhamit dhe më mardhnin edhe këtu këmbët e mia të zbatura! Pra shihja përjashta dhe mendohesha.

Dhe një ditë të tillë, ndërsa mendohesha, te degët e çapëluara të një shelgu plak erdhë dhe u ul një korb i zi. Dega u tund me gjithë të dhe ai krakaviti: «Krrau! Krrau!»

— O babagjysh, — pyeta unë plakun që po ngrohej te zjarri — ç'është ai zioshi atje që krakavit aq shëmtuar?

— Po do të jetë ndonjë zog, o bir i gjyshit!

M'u duk se këtu e zgjidha enigmën që më kishte munduar. Pra e vendosa me mend se korbi i zi që krakaviste mbi degën e shpalosur të shelgut na ishte vetë Zogu i parë, ai që quhej edhe mbret i shqiptarëve!

Dhe, meqenëse zogu ishte pranë meje dhe atje mbi degët rrinte me orë të tëra, unë, që desha të hyja nëpër ato bisedat politike si të mëdhenjtë, nisi t'i drejtohesha korbit të zi me ato gjykime dhe me ato fjalë që dëgjoja kur bisedonin të mëdhenjtë:

— Po misër pse nuk ka, o zog? Po ç'është kjo krizë, o zog? Po Avni Rustemin pse e vrave, o zog? Po Dhimitër taksidarin pse na e dërgon, o zog? Po Bajram Currin pse e ndjek, o zog?

Zogu nuk më përgjegjej e vazhdonte të rrinte mbi degë e kolovitej dhe mbretëronte si mbret që ishte.

Por nuk kaloi shumë kohë dhe shkova në shkollë. Shkolla jonë, si e kam thënë, asaj kohe ishte një

kthinë e vjetër me ca mure të lyera me humbe të bardhë. Dhe, apo nisa të shkoja në shkollë, e kuptova se Zogu i parë na ishte një njeri që quhej mbret dhe që mbretëronte në fron të mbretërisë atje në Tiranë, prapa maleve të Kërrabës. Në këtë qytetin prapa Kërrabës kishte shumë bejlerë e tregëtarë dhe në këtë qytet shitej bukë fiku dhe ciraga të kuqe.

Të gjitha këto i mësova një ditë kur në shkollën tonë erdhi një sundimtar i krahinës sonë, që asaj kohe quhej kryetar i komunës. Ky kryetari i komunës ishte një burrë i veshur me rroba të shtrenjta, si zotëri. Na hyri në klasë dhe na foli për gjëra që ishin krejt të ndryshme nga ato bisedat politike, me të cilat unë isha mësuar netve të dimrit. Më në fund, kryetari i komunës, nxori nga një çantë e madhe një fotografi të madhe dhe e ngriti lart.

— E shihni këtë? — na pyeti. — Ky, — dhe tregoi me gisht fytyrën e një burri në fotografi — ky është mbreti ynë, Zogu i parë! Merre ti, mësuese, këtë fotografi, mblidh fshatin dhe paret, blini një kornizë dhe një xham të madh, pastaj vareni në mur këtë, që ta shohin nxënësit mbretin tonë zemërluan!

Ja edhe një enigmë më lindi asaj dite. Luanin e dija se çfarë është, por që mbret Zogu t'i kishte shkulur zemrën një luani dhe ta kishte futur në krahërorin e vet, këtë **nuk** dija se si ta shpjegoja.

Ishte dimër. Ne shkonim në shkollë duke çuar atje **edhe** një copë druri për ta mbajtur me zjarr atë porin e vjetër, i cili, kur ndizej, shfrynte e bubullonte ashtu si bëjnë tani ato skapamentot e motoçikleta-ve. **Qyngjet** e poreve ishin të vjetra, aty-këtu ishin mbështjellë me disa rrathë prej gëlqereje të përzjerë me hi, po përsëri tymi dilte, dhoma mbushej plot e përplot, ne na digjnin sytë, por... por më **keq** nga të

gjithë e kishte Zogu i parë, mbreti i shqiptarëve, që ishte varur atje në krye të murit, sepse... gulshet e tymit ishin aq të dendura në tavan, sa Zogu nuk dukej fare. Unë mendoja se në mos atij do t'i qorrroheshin sytë nga tymi, me siguri që i digjin dhe i përvëlonin dhe kjo më jepte mua një kënaqësi të veçantë. Dhe kjo ndodhte kur, asaj kohe, në po atë shkollë na mësonin të këndonim hymnin e Zogut që fillonte kështu:

*«Si shkëndi që lëshohet prej qielli  
edhe tym, edhe mjegull shpërndan!»*

Pas ndonjë muaji u duk sërish, në shkollën tonë, ai kryetari i komunës që ishte veshur aq trashë dhe aq bukur. Po, me të hyrë në klasë, ai mori zjarr dhe gati u tērbua, i foli aq rreptë dhe aq rëndë mësueses, sa ne filluam të qanim. Por kryetari s'ish prej atyre që mallëngjehej nga lotët e fëmijëve. Dha urdhër dhe u mblodhën atje të gjithë burrat e fshatit. Menjëherë filloi t'u bërtiste:

— Ju nuk keni respekt për mbretin tonë të shkëlqyer! Ju të gjithë jeni fanolistë, jeni të poshtër dhe maskarenj, të pabesë e të poshtëruar. Budallenj nuk jeni, jo. Jeni djaj me brirë. Jeni kulishët e atij që mohoi Krishtin dhe u bë me antikrishtin. Keni lënë fotografinë e mbretit në këtë katandi, turp, pa xham dhe pa kornizë, i shkojnë Mizat sipër dhe i bie pluhuri në fytyrë!

— Po dale, zoti kryetar, — i foli një nga pleqtë — e ku kemi ne aq para sa të blejmë xama dhe korniza!

— Keni, s'keni, mua aq më bën. Kur të vij pas

një javë, dua t'i gjej të gjitha në rregull, sa për xhamin, atë do ta dërgoj vetë!

Kryetari i komunës iku i xhindosur dhe të nesërrmen dërgoi dy xhandarë, të cilët sollën në fshat një xham të madh. U mblodhën sërisht burrat aty në shkollë dhe thirrën të vinte zdrukthtarin Mikail. Pas pak ky erdhi. Mikaili ishte burrë kockëfortë, i veshur me ca rroba prej doku mavi. Në xhepin mbi krahëror i dukej një metër i verdhë druri. Mikaili ishte një tridhjetë vjeç, por dallohej se kishte shumë flokë, të cilat i përbante me një spring prej çeliku, që duhej të ishte ndonjë copë prej zemberekut.

— Aman, Mikail, — i foli një nga burrat e fshatit — merre këtë xham dhe na shpëto nga bezdia, se gjetëm belanë!

Mikaili u vërtit ndonjë orë, herë këtej, herë andej, gjersa na solli atje një kornizë të madhe prej dërrase. Ne nxënësit ishim shumë kureshtarë të shihnim si kalonte elmazi përmbi xham. Mikaili mbante erë rrëshirë dhe tallash, po nuk di përsë qeshte nën buzë e bënte, ç'bënte dhe kruante hundën. Më në fund ai e shkoi elmazin mbi xham, pastaj e ngriti xhamin, ja vuri gjurin përposh dhe e goditi në kupë... U dëgjua një krrak! Xhami u thye dhe u bë në pesë copë, por jo atje ku e shkoi elmazin Mikaili!

— Po si t'u thye kështu xhanëm?

— Epo xham është, se mos ka shpirt e veshë të më dëgjonte mua? Në ishte i zgjuar kryetari, le të dërgonte një xham të prerë në masë, të këtillë elmaz kam unë!

Tani burrat e fshatit nuk dinin si të bënин. E vendosën një herë xhamin mbi fotografi. Herë i mbe-tej koka jashtë Zogut të parë, herë i mbetej pëqiri dhe një pjesë e barkut, pastaj, kur ja ndërronin edhe

një herë, një xip prej xhami e shponte Zogun mu në grykë.

Por Mikaili nuk u mendua shumë. Ashtu si ishte xhami, ai vendosi ta përdorte. E vuri dosido përsipër dhe nisi t'i futte peronëzat. Dhe, kur ja fusste këto, i pështynte. Pastaj, kur afër tij ishim vetëm ne kalamajtë, ai tha:

— Kështu ja mbërthefsha edhe tabutin Zogut të parë. E jo vetëm Zogut të parë, por edhe gjithë shtypësve e tiranëve në jetë të jetëve.

Ne pamë njëri-tjetrin në sy, kurse mësuesja jonë vuri gishtin e saj mbi hundë. Pastaj e varën në mur Zogun e parë. Trupin e kishte të mbuluar me xham, kurse koka i mbetej jashtë.

Ne të nesërmen, pasi ndezëm zjarrin, filluam mësimin. Po përsëri tymi i zi i lëshohej kokës së Zogut dhe e mbulonte krejt. Tani koka e mbretit s'dukej aspak. Unë bëja çmos ta dalloja, por më dukej se ai ma lozte njërin sy, kurse tjetri s'i dukej fare. Atëherë përsëri m'u kujtua hymni i Zogut, që na e mësonin në shkollë:

«Si shkëndi që lëshohet prej qielli, edhe tym, edhe mjegull shpérndan!»

Po çfarë tymi dhe mjegulle ishte e zonja të shpérndante koka e Zogut, kur atë tani po e qorron-te fare tymi i porit tonë!?

## SEPETI I BARDHË

Ato ditë, për të cilat po shkruaj, të gjithë njerëzit e shtëpisë sime dhe të farefisit, prisnim të kthehej nga mërgimi daja i vogël, Filipi. Kishte shkuar në mërgim, sikurse thoshin, nja dy javë përrapa se të vritej princi Franz Jozef në Sarajevë, pak a shumë në ato ditë kur shpërtheu Lufta e parë botërore.

Unë, që s'e kisha parë kurrë dajën Filip, kisha një mall të madh ta shihja, sepse tezet gjithnjë më thoshin:

— Ti atij i ngjet aq shumë, sa... sikur të ka nxjerrë nga hundët!

Kjo më çudiste pér dy arësy: Unë s'e merrja dot me mend se si daja mund të nxirrte nipin nga hundët dhe pastaj ishte dhe një diçka fare e pakuptueshme pér mua: Si mund t'i ngjisja unë dajë Filipit, kur ai kishte ikur më shumë se dhjetë vjet para lindjes sime dhe s'qe kthyer më! Më thoshin gjithashtu se gjyshja ime nga nëna, ato ditë e pér herë të parë pas vitesh, kishte hedhur një valle duke tundur një shami të bardhë. Kishte gaz nënëgjyshja, sepse

kishte fejuar dajë Filipin me një vajzë nga të lagjes lart, kishin shkëmbyer nishanet dhe unazat me të gjitha rregullat e tjera, sipas kohës e sipas zakonit dhe tani... tani pritej ardhja e vetë Filipit!

Kështu që nëngjyshja, e cila ishte mësuar gjer atëhere të mbante në prehër fëmijë të vajzave të saj (duke përbledhur edhe mua vetë), donte të mbante në prehër edhe fëmijë të djemve, gjë që s'e kishte pasur fat gjer atëhere, sepse, sipas zakoneve tona të vjetra, pa dalë vajza nga shtëpia, djemtë s'mund të martoheshin kurrsesi.

Por ja, në vend që të vinte dajë Filipi me qiraxhijtë e udhës së Kosturit, na erdhi një kuti e madhe e dërguar nga daja i pritur.

Unë dëgjova këtë i habitur dhe u dëshpërova. Për kutinë e madhe duhej të kalonin ditë, pa ta shihja. Do të ndodhë kështu, sepse unë isha lindur dhe jetoja në fshat, kurse familja e dajë Filipit me gjyshen dhe dajallarët e hallat e tjera banonin në qytetin e vogël të krahinës ku mua më çonin më të rrallë.

Pastaj u tha se në atë kutinë e madhe dajë Filipi kishte dërguar një radio! Ky lajm më ra si bombë, sepse për radion kisha dëgjuar disa tevatura poshtë e përpjetë, por nuk e besoja kurrsesi që dikush të fliste e të këndonte larg e prapa maleve e prapa deteve dhe unë këtu ta dëgjoja. Kjo ishte përmua e pakapshme, e përmbinjerëzishme, fantastike! Vëllai im më i madh e kishte parë radion me sytë e vet dhe ngulte këmbë që...

Pra, prisja me pa durim ditën kur do të më çonin dhe habitesha se si nuk e kishte marrë malli nënëgjyshen përmua! Nuk e dija se nënëgjyshes, përveç mallit përmua, i qe vërsulur mbi krye një

brengë e një hall që unë në atë moshë nuk e kuptoja dot në asnënjë mënyrë.

Por, pasi qava disa ditë me radhë, gjyshja ime nga babai tha: «Djali do na shtihet në sëmundje, por... vëreni në vithe të kalit dhe shpjereni, se na çau veshët».

Unë atëhere nuk e dija, por e ndjeja se ajo lufta e të voglit për t'i çarë veshët të madhit, jepte gjithnjë frute të mira.

Kështu që në mëngjez herët më zgjuan nga gjumi shumë shpejt dhe unë nuk nxora zë, sikurse bëja në raste të tilla kur më nisnin të kullotja lopën ose gomarin e shtëpisë. Rruga gjer në qytetin e vogël mbante nja dy orë të mira (sikurse thoshin më të mëdhenjtë) dhe këtë rrugëtim e kreva duke mos vështruar për asnënjë çast bujqit që lëronin tokat, tokat që lëshonin erën e tyre të vjeshtës, vjeshtën që po hidhte fletët e verdha dhe fletët e verdha që endnin arave e rrugëve atë qilimin e tyre vjeshtak plot me lule lara-lara.

Sapo zbritëm nga kali, hyra në shtëpi dhe mora shkallët përpjetë për në odën e dajës më të madh, Llazit. Desh rashë më hundëzaj nëpër shkallët, sepse nga nxitimi aq herë shkela me këmbë të përparmen e fustanit tim (sepse asaj kohe, sa isha i vogël, për arësyen që kuptohen, më mbanin me fustan).

Dhoma e dajë Llazit m'u duk luks mua, që në atë kohë nuk kisha parë se si shtroheshin e mobilohe-shin dhomat në qytet. Unë isha mësuar të shihja dhoma shtruar me rrogoza, dritare me perde rrogo-zash dhe, në vend të dyshemeve, patozë prej balte të ngjeshur përmbi hunj druri.

Në qoshe ishte një krevat i madh me kunja si prej ari, me ca koka të verdha e shumë të ndritshme,

në vend të sustës kish disa springje të çelikta që lëshonin vezullime blu. Ishte shtruar atje një qilim i bukur leshi, kishte karrige me ca rrjeta prej shiritash të hollë shavari afrikan, pastaj kishte takatuke porcelani e në secilën prej tyre një sahat të gënjeshtërt porcelani që ishte ngjitur pas pjatëzës.

Po fotografitë e mureve? Nër to dukeshin dajat me radhë, Mitroja, Filipi, Llazi, Jorgji, nëna ime vajzë me shpinën e dorës në bel, tezja Zojo, kushëriri i vogël Jankoja, të cilit i dukeshin brekët ndër gjunjë nën pantallonat, gjyshja, e pastaj gjyshi Nikollë me ato mustaqet e mëdha! Në dritaret kishte perde, mbi parvazin e oxhakut ishte një llambë vajguri e bardhë si qumësht, që e quanin «llambë Stambolli» pastaj... në tryezë, fantastikja, e çuditshmja, e pakapshmja... r a d i o ! Ju afrova ngadalë. Kisha frikë se mos ajo niste e më fliste dhe pastaj nuk dija se nga t'ja mbaja. Mendova se... ndoshta përmua që isha i vogël, as fliste e as këndonte...

Me shumë kujdes e shikova prapa dhe e vështrova. Dukej në shpinë të saj një si rjetë e rrallëku munda të dalloja disa copëza teli e xhami, disa fije kauçuku, disa pllakëza të vogla, disa... Këtu fantazia ime u ndez dhe m'u duk se pashë qytete të mëdha, dete, oqeane, fabrika, njerëz, botën të tërë!

Papritur kérceva përpjetë... Në prak një zë burri! Ngrita kryet i trembur. Por ishte daja i madh, Llazi. Po më buzëqeshte, pastaj më mori hopa më qafë dhe më puthi në të dyja faqet!

Ky daja Llazi ishte artizan. Kishte një dyqan në rrugën kryesore të pazarit dhe gjithë ditën thurte vërzoma prej litari të hollë. Këto vërzomat ishin disa farë rjetash që bujxit i mbushnin me kashtë

dhe i çonin nëpër kashtoret për ushqimin e gjësë së gjallë në dimër.

Daja Llazi ktheu një çelës në radio. Në krye do-lën disa fishkëllima të holla, pastaj zëra... U dro-dha. Ishte një këngë popullore.

— Këndojnë nga Sofia — tha dajë Llazi.

Ishte zëri i një vajze që më kujtoi këngët e në-nës sime kur ishte gjallë. M'u mbushën sytë me lot. Se unë ende nuk e kisha të qartë se çfarë kishte ndodhur me nënën time dhe e kërkoja shumë herë në-për tavanet, nëpër dollapet, ndën shkallët, tutje nga kashtorja e Cfetkos. Nuk di se çfarë ngjau ashtu papritur në shpirtin tim prej fëmije e ja dhashë të qarit. Daja Llazi u mallëngjye dhe u mundua t'i fshihte lotët, kurse që nga radioja dëgjohej përsëri kënga.

Daja më mori hopa dhe një herë dhe më zbriti te gjyshja poshtë. Ajo më mori pranë dhe nisi të qante. Zaten unë, gjyshen nga nëna e mbaj mend vetëm duke qarë. Mundohem të rrëmoj e të trazoj nëpër kujtesën time se mos më dalë nënëgjyshja duke qeshur a duke folur me njeri, por... jo. Ajo më del gjithnjë duke qarë ose duke i diktuar letra për dajën mbesës Aspasi.

Nënëgjyshja më afroi dhe më nxori nga gjiri një kartë. Ishte një zarf me disa pulla të bukurë e plot me ngjyra, anët e zarfit ishin edhe ato me dhëmbëza të kuqe e blu. Gjyshja e puthi zarfin dhe më tha ta puthja edhe unë. Edhe unë e putha zarfin, ashtu kot, pa ditur gjë, por vetëm që t'i bëja qejfin gjyshes.

Shumë vite më vonë i kam parë ato zarfe të bukurë e i kam lexuar; ato shkruanin: San Lui, Misuri.

Përsëri u dëgjua një këngë që nga dhoma lart

ku ishte radioja. Unë përsëri desha të shkoja andej, por gjyshja nuk më la. Unë i fola:

— Po eja edhe ti, gjyshe, eja!

E kapa pas fustanit të saj të gjatë dhe të zi dhe u mundova ta ngrija, por ajo s'luante vendit. Vetëm qante. Qante dhe vështronte anash. Ashtu vështrova edhe vetë. Aty ishte një sepet i bardhë, mbi të cilin gjyshja kishte hedhur një shami të zezë. Nënë-gjyshja e shihte sepetin, sikur atje brenda të ndodhej ndonjë i vdekur. Unë nuk dija se ç'kishte atje dhe desha ta hapja e ta shihja, por gjyshja e mbuloi me kujdes.

Rreth e qark nëpër dhomë kishin ardhur edhe gra të tjera. Këto ishin nga të mëhallës si edhe tezet dhe hallat e mia. Të gjitha bisedonin me zjarr, ndërsa gjyshja qante e përshpëriste:

— Vaj lelem! Vaj lelem!

Më në fund munda të kuptoja se sepetin e bardhë e kishin dërguar që nga mëhalla e sipërme e qytetit të vogël, e kishin dërguar që nga shtëpia e vajzës që kishte qenë e fejuar me dajën tim, Filipin. Dhe bashkë me sepetin kishin dërguar edhe këto fjalë:

«Filipi, moj motër, s'ka ndër mend të kthehet vetë, por na dërgon kutira të vdekura. Por ne s'e martojmë çupën me kutira, se çupa jonë do të shohë fatin e saj. Juve djali t'ju rrojë e të trashëgojë, por gjer këtu e më tutje s'kemi gjë.»

— Gjyshe, o gjyshe! Është një burrë atje lart në radio, po flet e po këndon, eja ta dëgjosh, se unë s'e marr vesh, eja e ma trego ti!

Por ajo nuk luante vendit, sikur s'dëgjonte.

— Rri, biro, ti je i vogël e s'di.

Me siguri ajo e kishte mendjen te daja Filipi, i

cili nuk vinte vetë, por dërgonte radio që nga San Luizi. Mbaj mend se atë pasdite, daja Llazi më tregoi shumë gjëra pér atë dajën e largët, të cilit unë i ngjisja shumë, megjithëse ai kishte ikur shumë vjet përparrë lindjes sime.

Daja Filipi jetonte në një qytet të panjohur anës një lumi të madh dhe ky lumi i madh e kishte emrin Misuri. Ne misur atëhere quanim një farë çanaku prej cingoje dhe unë nuk dija se si ta shpjegoja apo ta futja lumin brenda në atë misur prej cingoje ku isha mësuar të haja pëershesh me dhallë.

Në atë qytetin e largët dajë Filipi punonte si qirinxhi. Kishte një odë të vogël e disa cilindra prej drûri, pastaj kishte si kambanë a si rrodhan prej llamarine të zezë. Dhe kjo këmbana kishte anash plot e plot gremçë e në çdo gremç daja varte një llambadhë të vogël. Filipi rrinte ulur në një fron, anash kishte një kazan me dyllë që e zjente mbi një zjarr. Në dorë mbante një lugë të madhe që e mbushte me dyll të shkrirë dhe ua hidhte llambadheve përsipër një nga një. Një nga një. Daja e vërtiste atë kambanën si rrodhan prej llamarine, hidhte sipër dyll të nxehthë e llambadhet trasheshin e trasheshin.

Pastaj këto llambadhat i blinin të pasurit e atij vendi të largët, i ndiznin dhe i faleshin zotit që t'u jepte shëndet e para dhe t'u shtronte gjakun punë-torëve që të mos bënin greva.

Por gjithë këtyre unë nuk u hyja dot dhe e kisha mendjen tek ai sepeti i bardhë i mbuluar me shami të zezë. Mësova se atë e kishte sjellë në mëngjerez gurgdhendësi Anastas. Në një çast unë tinëz munda ta zbulojta sepetin dhe atje pashë disa gjëra të thjeshta, të cilat, edhe pse ishin kështu, i shkak-

tonin gjyshes një dhembje aq të madhe, sa unë s'kisha se si ta shpjegoja.

Përmbi një shami të bardhë ishte një unazë e verdhë e anash unazës së verdhë ishte një pe i kuq. Peri i kuq ishte mbledhur e kruspullosur. U habita. Përse në gjithë atë sepet aq të madh kishin vënë ato gjérëza aq të vogla. Po gjyshja përse qante ashtu? Përse?

Pastaj e pashë gjyshen që thirri kushërirën time, Aspasinë. Kjo ishte një vajzë nga tetëmbëdhjetë vjeçë dhe unë kurrë s'munda ta harroja Aspasinë, se ajo ishte vajza më e bukur në të gjithë qytetin e vogël. Gjyshja i thoshte:

«I dashur biri im Filip!»

Aspasia shkruante.

«Të puth me mall të madh, unë, nëna jote e dje-gur dhe e shkrumbosur në të zeza. Ta shkruaj këtë letër me dorën e mbesës Aspasi. Të nisesh e të vish një sahat e më parë, e të vish domosdo, se zemra m'u mbush me helm e me vrer, e më s'duroj dot. Si nuk më ra pika, o bir, kur ma kthyen mbropsht nishanin! Kur u ngrita në këmbë që të merrja sepetin e kthyer, zu më dridhej shtëpia e muret, e këndet, çesma, oborri, e thashë se dërgoi zoti të më merrte. Po nuk dridheshin ato, po dridhesha unë vetë. Të ngrihesh e të vish një sahat e më parë, biro...»

Shkoi kjo letër, e pas saj shkuau edhe shumë të tjera.

Pastaj shkoi edhe gjyshja vetë, iku në botën tjetër, sikurse thoshte daja Llazi. Por më tej iku edhe dajë Llazi, ikën edhe tezet, edhe gjithë sa ishin në atë shtëpinë e nënëgjyshes sime, por... daja Filipi nuk u kthye kurrë.

E mbajti dheu i huaj.

## TROKTHET E KUAJVE NËPËR NATË

Ai s'është një burim i zakonshëm, as i vogël e as mesatar. Atje ujërat gufojnë aq me forcë dhe aq me shumicë sa, zhurma e atij shpërthimi të lëngshëm, dëgjohet njëmijë hapa anembanë. Dhe kanë shkuar për të pirë ujë atje, të mëdhenj e të vegjël, shkonte dhe shkon bagëtia që nga kullotat e pastaj... dikur thoshin se natën, dilnin shtojzavallet dhe lozni valle.

Te ky burimi i livadheve lart, tregonin dhe tre-gojnë se nëpër netët sa më të errëta në kohën e turkut, vinin e ngrinin prita redife e mylazime, halldupë dhe xhandarë. Mendonin turqit se medoemos do të shkonin atje për të pirë ujë ata kryengritësit e çetave e... këta do t'i prisnin me jatagane dhe me zjarre dyfeku.

Por ka pasur pleq nga fshatrat anembanë, (tashmë këta kanë vdekur) të cilët tregonin se pikërisht te ky burimi i livadheve lart, bashkë me Çeçon e me Bajon dhe me çetën e tërë ishin mbledhur në kuvend atje...

Nga ky rëmet i tillë që ka shkelur dhe shkel tro-jet aneqark, mund të mendohet se vendi vjen kerr

dhe i qethur. E vërteta është se atje ujërat gjithnjë punojnë nën dhe e u japid lëng rrënëjëve; gurgullimi dhe vërshimi i ujërave e sit ajrin... shto pastaj edhe dëshirën e njerëzve që të shtrohen te burimi me ujë shumë, me blerim për tokë e me hije mbi kokë, ku syri të të kullosoë e të të ngoset me atë bukurinë gjithnjë mitare e gjithnjë të ëmbël që na jep pleksja e degëve, e fletëve, e kulprave dhe e bisqeve!

Te ky vendi i burimit të magjishëm të liva-dheve lart, kisha pasur dëshirën, që kur mbaj mend veten... kam pasur dëshirën që të flija një natë!

Por asaj kohe, për të cilën dua të tregoj, djemtë e fshatit tonë si dhe të fshatrave anembanë, dilnin natën arave dhe ruanin misrat prej derrave të egër. Sepse kaq i shtënë është derri i egër pas misrave të njomë, sa shpeshherë gjendeshin burimeve dhe përrrenjve egërsira të tilla me plënc të çarë nga grykësia.

Në krejt trevën si luginë që zbatet nga Morava, mblidheshin djem grupe-grupe, ndiznin zjarre të mëdha, varnin teneqera të ndryshkura nëpër degët e gorricave... Flakët e zjarreve, britmat e djemve dhe sidomos zhurma e teneqeve të rrahura me topuze, i mbanin larg egërsirat.

E butë dhe e bukur kjo lugina jonë që zbatet nga Morava. Dhe, po ta shihje natën me gjithë ato zjarre siluetën e errët të vargmaleve, ishte një pamje me të vërtetë madhështore.

Por atij moti dëshira ime për të mësuar punët e të mëdhenjve, e për të fjetur jashtë një natë, përkoi me disa ngjarje të shënuara...

Plasi kryengritja kundër qeverisë së Zogut!

Të gjithë gazetat e vendit shanin e mallëkonin «rebelët», xhandarëve s'u zinin këmbët dhe, u ven-

dos shtetrrethimi dhe u mbyllën kufitë, postëtele-grafat s'punonin fare. Pastaj u tha se kryengritësit vranë gjeneral Xhilardin, kurse Zogu bëri gati vali-xhet. Thoshin edhe se e kishin parë Musa Jukën të gjunjëzuar përpara Zogut duke shkulur qimet e mje-kërës dhe duke kërkuar mëshirë!

Nëpër fshat, njerëzit rendnin nga njëra shtëpi te tjetra, sekush i pëshpériste shokut në vesh dhe fër-konte duart:

— Do të shpëtojmë! Po ngjallet shpresa e fuka-rasë! Do të marrim tokë!

Një zhurmë motori u dëgjua nga fundi i fshatit. Në rrugë u duk një «Ford» i zi dhe prej tij doli një goxha burrë veshur si zotni, me kollaro e me bastun të hollë, me tre xhandarë pas. Ky ishte nënprefekti i zonës. Ishte i parruar dhe fytyrëvralë. Mezi i hidhte këmbët nëpër rrugë. Kërkoi të mblidheshin te she-shi djemtë dhe burrat që kishte fshati dhe mbajti kë-të fjalim:

— Na vranë Xhilardin, krahun e djathtë të mbretit. Kryengritësit po mërzejnë maleve e rrëmbejnë ç'mundin. Ju, djema, që ruani natën derrat me katër këmbë, do të ruani domosdo edhe këta derra me dy këmbë që janë më të rrezikshëm. Do t'ju jap edhe fishekë të tjerë për çiftet tuaja dhe... me t'u afruar, bjeruni! Ndër këto anët tonë po sillet komiti më i xhindosur i kryengritjes! Është vrasës dhe kriminel. Sipër i kanë hipur morrat dhe leshrat e gjata. Buzët i ka të kuqe gjak nga gjaku prej fëmije që ka pirë. Është bolshevik i poshtër! Është i shpejtë dhe është trim. Jua them që ta dini. Po, sido që të jetë, plumbi e shpon dhe ta dini... ky rebel, para disa vjetësh ka djegur sarajet e mbretit në Burgajet të Matit!

\* \* \*

Ja, ishin netët e këtyre ditëve, kur im vëlla më mori edhe mua që të flija arave, sepse edhe unë do të rritesha dhe doemos duhet t'u mësoja atyre që vinin pas meje, se si flihet përjashta me zjarre e me britma për të ruajtur misrat e njomë nga grykësia e derrave.

Mu te gryka e lumi ishte ndezur një zjarr i madh. Nja dhjetë djem ishin shtruar atje. Ne u afroam duke u zvarrisur pranë një shkorse leshi. Ishte natë dhe flakët lëshonin hijet e tyre nëpër misrat. Pak mënjanë zjarrit, te një shelg, ishte varur një teneqe e ndryshkur. Çome Simaku, moshatar me tim vëlla, i binte teneqesë me topuz dhe bërtiste. Në shelg ishte varur edhe torba e Çomes dhe prej saj vinte era byrek e gjalpjë i djegur. Por nuk më lanë pas zjarrit. Im vëlla më shtroi poshtë fier dhe më mbuloi më velenxe.

— Fli aty!

Frynte era e situr e maleve që më guduliste guşhen dhe më hynte gjer në sqetulla. Era sillte edhe cikërima shkume nga lumi që e lëshonte si vesë nëpër thekët e velenxes. Unë shihja kupën e madhe të quillit... Yje! Sa shumë yje!

Come Simaku e ndërpree goditjen dhe foli:

— O Selim! Po ejani i bini edhe ju teneqesë!

— Hajde, hajde, bjeri atje, ti ke njëqind dynym tokë misër, ne së bashku kemi njëzet. Pas mesnate shohim e bëjmë!

Po Çome Simaku e la teneqenë dhe u afroua. Disa kallëpe misri u thyen nëpër arë, thyeleshin nga gjunjë njeriu që kalonte nëpër bimët. Djemptë brofër në këmbë. Por nuk ishte gjë. Afrohej një djalosh nga

zjarret më lart. Përsëri një zhurmë tjetër dhe shqetësimi u përsërit. Gjithkujt i dukej se po afroheshin komitët!

Unë vështroja errësirën me napën e saj të zezë. Ajo napë ma ndizte përfytyrimin dhe më bëhej se vjerdullat çanin tinëz nëpër rakitat e lumi, më dukej se zogjtë cicëronin nëpër bar e nëpër fletë, më dukej se dhëpërat nëpër gjerdhe e hendeqe i përqeshnin ata derrat e egër që kishin frikë nga zjarret dhe nga teneqetë. Sa për komitët nuk i përfytyroja... sepse unë gjer atëhere, komit nuk kisha parë!

Tani ishin mbledhur qark zjarrit gjithë ata djem. Por unë e kuptoja se në sy të Come Simakut, ata nuk flisnin dot për komitët. Dhe Selimi më atë gunëzën e vogël në majë të supeve të tij, nis e gërgjet Pançon...

Pançaja është dhëndrrri më i ri në fshat. Rri më gjunjazi te zjarri dhe sytë i mban të mbërthyer me urët e tymosura që priten nga flakët.

— Vërtet, ama zor e kanë nuset e reja të sapo-martuara, kur u ikin burrat për në kurbet...

— Janë mësuar.

— Një fjalë goje.

— Jetë qeni.

— Më mirë thuaj jetë murgu, sepse edhe qeni që është qen...

— Thonë, o vëllezër, thonë se prifti i fshatit tonë, papa Jani, del natën nëpër fshat dhe ndez qirinj nëpër portat ku ka nuse të reja... ndodh që kanati hapet e qiriri shuhet...

— Vërtet, o?

— Vërtet, o, posa, ja për atë bukë!

Dhëndrrri Panço vidhet nga zjarri dhe zhduket nëpër errësirë.

— O Çome! Do të shkosh tek teneqeja, apo ç'thua?

— Ore, për të shkuar kam, por... sikur të na vijnë ata komitët?

— E pastaj?

— Duhet t'u biem, kështu shkruan edhe gazeta «Arbeni», kështu na tha edhe nënprefekti...

— Po... po erdhën, del e bjeru...

— Jo xhanëm, po unë një fjalë thashë...

Dhe Çome Simaku niset për te shelgu ku varet teneqeja e ndryshkur. Dhe sa të mbërrijë Çomja në vend të vet, Selimi me kokë të varur pas zjarrit, me gazeten në duar nis e lexon diku nga faqja e fundit.

Përsëri flet Çomja që nga shelgu:

— O Zenel!

— Ç'ke, mo!

— Po sikur të vijë ai bollçeviku?

— Le të vijë, pastaj ku dihet...

— Jo xhanëm, po diku ka për të vajtur. Unë kam dëgjuar se komitë dalin ata, të cilëve u bëjnë magji, pastaj dalin edhe ca të tjerë për punën e ndonjë çupe të bukur...

Te zjarri Selimi e ngre zërin:

— Këtu në gazetë paska edhe një vendim gjyqi.

— Pa lexoje.

— Vendim. Gjyqi i rrethit nxjerr të pafaj Asaf Lemanin nga katundi Lubonjë. I pandehuri me datën kaq e aq ka vrarë me një lopatë hekuri motrën e tij, Sadeten, bashkë me dashnorin e saj, Nabil Seitin, sepse i gjeti të përqafuar... por, duke marrë parasysh nderin shqiptar «...Pastaj ka edhe një vendim tjetër. Dëgjojeni: «Vendim. Në emër të naltmadhërisë së tij, Zogut të parë, mbretit të shqiptarëve,

gjyqi i paqit me numër e datë kaq e aq vendosi: T'i njihet zotërimi i plotë mbi dhjetë dynym tokë të pante dehurit zotit Estref bez Zamanit, tokë e cila i ishte lënë rehem nga paditësi Hasan Sherifi, sepse ky i fundit i ka munguar detyrimit për t'i paguar borxhin bashkë me fajdenë. Gjyqi i paqit...»

— Ama gjyq paqi... paqe të bukur ka vendosur.

— Në fitoftë kryengritja, pa do ta marrë vesh edhe Estref beu, edhe gjyqi i tij bukuosh.

— Lexo gazetën nga faqja e parë, lexoje, Çomja nuk dëgjon dot tanë, mund të bisedojmë.

Ata ishin gati njëzet djem të kërrusur afër zjarrit, djem fshati të veshur me shajak e të mbathur me opinga kau. Selimi lexonte:

— ...Trembehjetë rebelë u pushkatuan në Tiranë, kryengritja do të shtypet me zjarr e me hekur...

— Pa lexo më poshtë...

— Gjithë ato fjalë janë, gazeta ha në grazhdin e Zogut.

— Do zoti e fiton kryengritja.

— Do t'i ndajmë tokat me litar, kaq ti, e kaq unë dhe shko matanë.

— Po vallë Fan Noli a ka marrë vesh?

— Domosdo që e ka mësuar, po rrahin telat nëpër Evropë.

— T'u vëmë drunë bezlerëve dhe agallarëve.

— Të shpëtojmë edhe nga kurbeti, se na hëngri shpirtin, martohu mirë e bukur dhe merr sytë...

Unë rrija në përgjim dhe dëgjoja bisedat. E gjithë lugina shushurinte nga fletët shamatore të misrave, që i ngiste era dhe tundeshin duke u fërkuar me njëra-tjetrën.

— Po lehin qentë, — tha njëri nga djemtë — mos afrohet njeri.

— Qentë lehin vërtet!

Heshtje te zjarri. Dikush i bërtiti Comes që të pushonte goditjet mbi teneqe. Thëllimi i erës dhe zhurma e potershme e ujërave të burimit të madh. Një zë midis djemve:

— Mua më duket sikur dëgjoj trokthe kuajsh nëpër natë...

— Mund të jenë udhëtarë, kushedi nga shkojnë.

Nëpër zhurmat e teneqesë, nëpër bisedat e djemve, nëpër flakët e zjarrit m'u afrua gjumi. Dhe po flija nën ushtimën e madhe të ujërave të burimit, po flija kur... fare papritur, në një çast u vendos qetësia, teneqeja s'kërciste më, u dëgjua trokthi i një kali dhe im vëlla bërtiti:

— Po dëgjoj trokthe kuajsh, trokthe kuajsh!

U zgjova dhe u drodha i téri. Ndjeva frymëmarrje të nxituara dhe pashë hijet e flakëve që i suleshin qiellit. Një kalë turfulloj dhe hingëlli nëpër natë, ai i erdhi rrrotull zjarrit, patkonjtë e tij shkrifëtuan plisat e u ngrit pluhuri i tokës nëpër dritën e kuqaloshe të zjarrit. Një zë krejt i panjohur u dëgjua:

— E, mo djema, a u ngrohët pas zjarrit!

U mblojha grusht pas jastëkut dhe pastaj, si të isha një sustë e shtrënguar fort, kérceva përpjetë. Një kalorës kérceu nga kali dhe u hodh mu te zjarri. Ishte një burrë i panjohur. Ashtu si ishte më kishte kthyer shpinën, por unë renda qark e qark dhe i dola kundrejt. Drita e zjarrit i rrihte fytyrën. Unë shihja flokët e tij të shumtë dhe të larë nga flakët. Kishte buzë të rregullta me tul, ballin tepër të gjerë dhe dy sy si turiela. Nofullat i kishte të plota e të njëjeshura. I dukej një kraharor prej vigani; të grisura i kishte dhe xhaketën, edhe pantollonat. Në bel,

i dukej kollani i fishekëve. M'u bë sikur mbante erë barut i djegur. Shihte anembanë dhe tundte kryet... thuajse nëpër luginë kishte shpërndarë komitët e tij.

— A u foli për mua nënprefekti, o djema?

— Po, kapelan.

— Tani do t'ju flas edhe unë. Ne, bukë e gjellë kemi pasur në shtëpi, askush s'na ka bërë magji, edhe çupa të bukurë kemi pasur, edhe misra kemi, por lamë vatrat dhe morëm malet kundër atij hallvaxhiut që e quajnë mbret. Ne kemi dalë malit për ju që nuk ngopeni me bukë, për ju që ngordhni kurbe-teve...

U zvarrisa dhe i shkova komitetit pranë. Koka ime mezi arrinte te gjunjët e tij. E vështrova mirë. M'u bë sikur diku e kisha parë. Por pastaj u kujtovat se kisha parë vetëm fotografinë e Themistokliut komit. Ai përsëri foli:

— Si jeni me bukë nga shtëpia, djema?

Im vëlla rrëmbeu torbën tonë dhe u ngrit, i shkoi aq afër komitetit, sa thua se u ngjit trup pas trupi me të.

— Merre bukën time, kapelan, merre!

Komiti nënqeshi:

— Jo, jo, falemnderit, trastën plot e kam, por unë desha të di për gjendjen tuaj.

— Nga tre muaj bukë mbledhim, kapelan, pastaj...

— Veç ai që i bie teneqesë është në gjendje.

— ...Ai le t'i bjerë teneqesë.

Por Çomja ishte kërrusur kokëposhtë dhe s'ndihet fare. Përsëri pyeti komiti:

— Po njeri tjetër a keni këtu?

— Jo... po ky i teneqesë s'ka për të hapur gojë, se e di... copëzën më të vogël, sa bulëzën e veshit ja bëjmë...

— Domethënë s'keni njeri tjetër këtu...

— Jam edhe unë! — kërceva dhe bërtita me të madhe.

I dola përballë komiti! Isha vocrrak, këmbëzbathur, me kërcinjtë jashtë, me një palë pantallona të shkurtëra shajaku, me fytyrë të hequr e të mprehtë. Komiti brofi pas meje dhe qeshi. U përkul dhe unë ndjeva dorën e tij përmbi fytyrën time. Ja kapa me të dyja duart dhe ja putha.

Qeshi komiti dhe ju dukën dhëmbët e bardhë dhe një palë mustaqe të zeza. Ai përsëri u foli djemve:

— Kështu, djema, ne kemi dalë të japim kushtrimin nëpër natë. Bujku i mirë e hedh farën nëpër errësirë, sa pa dalë korbat; edhe ne sot po hedhim farën e kryengritjes së re, nesër do ta korrim!

Nëpër grupin e djemve sikur kaloi një acar i ftohtë.

— Domethënë, kryengritja nuk fitoi?

— Nuk fitoi, djema, pushka e parë nuk na shkoi mbarë, në radhët tona kishin hyrë edhe nga tärrestarë, edhe bejlerë, edhe lepuj, por... në luftën e ardhme ne do ta ndajmë shapin nga sheqeri, do t'i ndajmë drurët e drejtë nga të shtrembërit, kryengritja e ardhme do ta përbysë gjendjen! Ne përsëri do të takohemi!

— Po ju cili jeni, kapedan? Si ju quajnë?

— Unë? Unë jam kryengritës si gjithë të tjerët, më quajnë Riza Cerova! Tani më duhet të largohem.

Pesë djem u vërsulën pas tij:

— Do të vijmë edhe ne me ty, kapedan Riza, do të vijmë me ty!

Ai ngriti duart përpara dhe përkuli pëllëmbët si për t'i përbajtur djemtë:

— Jo, djema. Sot nuk do të vini më mua, po ne përsëri do të takohemi maleve.

— Po ku do të të gjejmë ne, kapedan Riza?

— Ne mos më gjetshi mua, ju do të dëgjoni një ditë, do të dëgjoni trompetat e revolucionit dhe trokthet e kuajve nëpër natë!

Ai u nda me djemtë nëpër errësirë.

— Udhë e mbare, kapedan Riza!

Dhe komitin e përpiu nata. Dhe pastaj ra errësira e plotë, e dendur, e zezë. Djemtë rrinin aty si të gajasur, me tëmblat në duar, si të mekur, si të trethur në mendime. Pastaj era uturoi përsëri nëpër grykën e lumbit, drurët e korijeve frushulluan e ngritët lart zhurmat e tyre. Ujërat e burimit të madh nuk e rreshtnin gurgullimën.

Im vëlla dhe Zeneli rrinin më këmbë të shqetësuar, shihnin anembanë pa mundur të çanin errësirën. Gulçonin dhe merrnin fryshtë me zor. Pak më tutje, qentë lehën me të madhe. Foli im vëlla:

— Dikush po afrohet nëpër errësirë, ti, Zenel, ke vesh të fortë, vëre veshin pas toke dhe dëgjo...

Edhe unë kisha vesh të fortë dhe u shtriva. Vura veshin pas dheut, por Zeneli u ngrit shpejt e tha:

— Asgjë nuk ndihet.

— Jo, jo, — bërtita unë — dëgjoj...

— Çfarë dëgjon, mo?

— Dëgjoj ca çape të rënda, të shumta, të nxituar, dëgjoj edhe këngë!

Ishte natë e errët dhe që lart nga veriu afrohej era që vërsulej nëpër ujërat e burimit të madh. Tashmë unë kisha parë një komit. Dhe tani përfytyrimi im ishte ndezur. Po më bëhej sikur një aradhë djemsh të veshur e të ngjeshur si kapedan Rizai vini nëpër natë si komitë me kollane fishekësh, me

thika në brez, me pushkë në krah, me mjekra të gjata dhe me sytë që u lëshonin xixa. E në mes tyre m'u duk se pashë edhe veten time.

Im vëlla më shpoi:

- Ore ti, ç'mbete ashtu pas toke?
  - Po vijnë! Po vijnë! — bërtita unë.
  - Kush po vjen, more?
  - Po vijnë komitët! Po vijnë!
-

## **GRAMAFONI, XHAXHAI DHE NUSJA E TIJ BARDHOSHE**

Midis sendeve që rrethonin botën time të vëgjelisë, gramafoni ishte një pikë e lartë, ku përfytyrimi dhe habia ime kishin vend të mjaftë ku të shfrenin. Gramafonin e solli në shtëpinë tonë një xhaxhai im, që u kthye nga mërgimi. Ai erdhi natën në shtëpi me disa qiraxhinj, të cilët kishin mbi shpini guna të dhirta, kurse mbi samarët e kuajve kishin ngarkuar disa baule të zeza.

Unë që asaj nate dëgjova të flitej për gramafonin si për një nga çudirat e botës dhe prisja me padurim kur xhaxhai do ta nxirrte nga sëndyku. Kur gramafoni u vu mbi minder, mua m'u duk se u ktheva i téri në një sy të vetëm dhe shihja e përpjaja gjithshka rreth asaj kutie të zezë e misterioze që mbante një erë të çuditshme, krejt të huaj për ambientin e barit dhe të luleve ku isha lindur unë. Edhe sot e kësaj dite, sa herë futem në ndonjë kabinë elektrike, apo ndonjë impiant ku ka kabullo të trasha, më kujtohet menjëherë gramafoni që kam parë kur isha i vogël.

Nuk e di se si xhaxhai e kishte blerë gramafonin, por unë atëhere e përfytyrova sikur ai do ta kishte marrë prej një burri gjigant diku afër një oxhaku vaponi dhe, ai që do ta kishte shitur do të kishte qenë i mbathur me një palë çizme llastiku që i mbulonin edhe këllqet e tij tepër të gjatë.

Sapo u hap gramaferi, unë pashë një shtrojë të gjelbër e rrumbullake, pastaj një kunjëzë të ndritshme nikeli dhe përmbi to dukej fotografia e një qeni të bardhë, e anash disa të shkruara që i lexoi xhaxhai:

«His master voix».

Ai tha se këto fjalë donin të thoshin «zëri i të zotit», por këto nuk ishin asgjë përpara asaj habisë që ndjeva kur gramaferi filloj të këndonte. Unë hapa sy e gojë e veshë e duar dhe ngela i mahnitur. Kënga e gramaferit patjetër që ishte mrekulla më e madhe e kohës.

Pastaj për një javë me radhë unë munda t'i dëgjoja këngët e gramaferit ditë e për ditë, bile natë e për natë. Kjo sepse xhaxhai i porsaardhur nga kurbeti u martua dhë bëri dasmë.

Unë u përhumba gjithë ato ditë pas dasmës e pas gramaferit, por e dija se pas dasmës kushedi për sa kohë nuk do ta dëgjoja më gramaferin. Natyrishët kjo më dëshpëronte pa masë, aq më shumë kur thanë se një muaj pas martesës xhaxhai do të nisej përsëri për në kurbet.

Unë rashë në hall të madh. Kush do ta bënte gramaferin të këndonte? Sepse, që t'i hyje një pune të tillë, për mua asaj kohe ishte një diçka tepër e madhe, e pakuptueshme dhe e pakapshme.

Por ja se një rreze shprese filloj të ndriste! Dikush tha se xhaxhai do t'ja mësonte nuses së tij

përdorimin e gramafonit. Mirë kjo, po a do ta mësonte dot kjo nusja jonë? Këtu ishte gjithë halli im.

Kur mbaroi java e dasmës, të gjithë njerëzit e shtëpisë ja filluan menjëherë punës. Iknin që të gjithë, që herët në mëngjez, në fushë apo në mal, për të lëruar tokën apo për të prerë dru. Me ta ikte edhe babagjyshi plak, kështu që në shtëpi mbetej xhaxhai, nusja e tij, unë dhe... gramafoni. Unë i lutesha xhaxhait që ta vinte gramafonin të këndonte, por ai më nxori një problem tjetër. Më tha:

— Dëgjo ti, nipi im i vogël. A nuk sheh sa shumë njerëz na vijnë ditë e për ditë në shtëpi? Rrëmujë e madhe. Mua s'më mbetet hiç kohë që t'ja mësoj nuses se si ta përdorë gramafonin kur të iki unë. Prandaj do të bëjmë një punë: Në kohën që unë do t'i jap mësimë nuses lart në dhomë, ti rri roje këtu jashte te porta. Kush të vijë dhe të më kërkojë mua, ti i thuaj: «Nuk është xhaxhai, as edhe nusja, edhe ata shkuantë punojnë në arat e malit!»

Ja kështu, në emër të gramafonit, më mësuan të gënjeja për herë të parë në jetën time. Por unë gënjeja, sepse më ishte mbushur mendja se gënjeja «për një çështje të drejtë». Kusuri... aq më bënte.

Vinin njerëz nga fshatrat e largëta, vinin me kuaj e me mushka, dhe përmbi samarët e kuajve kishin shilte me ngjyra të bukura, nëpër samarët kishin të varura yzengji nga më të ndritshmet, vinin tërë shpresë e tërë qejf për të pyetur xhaxhain për të dashurit e tyre larg në mërgim, por... por unë ua prisja më kaç që te porta:

— Xhaxhai nuk është, ka shkuar edhe ai të punojë në arat!

Në të vërtetë xhaxhai me nusen e tij bardhoshe ishte atje lart në dhomën e miqve. Ai e mësonte nu-

sen se si kurdisej gramafoni, si i vihej gjilpëra, sì ndërrohej pllaka, si fshihej, si hapej, si mbyllej dhe mijëra e mijëra marifete të tjera që duheshin për t'u vënë gramafoni të këndonte dhe që të gjithave unë s'kisha se si t'u hyja brenda!

Aty nga drekëhera, pas një fishkëllimi që lëshonte xhaxhai, unë mund të hyja në shtëpi, sepse atëherë kishte mbaruar mësimi i ditës mbi gramafonin. I hidhja një vështrim truprojes sime të shenjtë dhe hyja brenda. Atëherë vinin edhe ata që pyesnin përtë dashurit e tyre në mërgim, kurse nusja e re, e lodhur shumë nga shkollimi mbi gramafonin, merrte hejbet, i mbushte me ushqime dhe shkonte e u shpinte drekën në arë njerëzve të shtëpisë.

Por... pasdite fillonte edhe pjesa e dytë e kur sit ditor mbi përdorimin e gramafonit. Unë si gjithnjë mbaja roje dhe gënjeja, gjersa ktheheshin njerrëzit e shtëpisë nga puna në ara. Në mbrëmje xhaxhai e hapte përsëri gramafonin, nusja i rrinte pranë, por s'guxonte ta kapte me dorë, sepse ende s'i kishte hyrë mirë. Duke dégjuar gramafonin, unë fillova edhe të mendoja për të. Kështu që krijova bindjen se atje brenda në gramafon ishin futur disa burra e disa djem, këndonin dhe u binin sazeve. Vetëm më mundonte diçka tjetër: Me se ushqeheshin ata? Mos vallë dilnin natën dhe shkontakte secili në shtëpi të vet dhe ngjishej me bukë? Por në fund të fundit përsë ta vrisja mendjen aq shumë, kur gramafoni këndonte për bukuri:

«*Ne Rrapi në Mashkullorë»,  
foli Çerçizi me gojë,  
lërni djemt' e mi të shkojnë,  
se ju skuq ju bëj me bojë!»*

Këtë Çercizin e përfytyroja komit me pushkë-në krah dhe me një tarkaçik në anën tjetër. Në këtë tarkaçik Çerçizi mbante bojë të kuqe dhe ca shtëllunga të mëdha prej leshi. Kush nuk i bindej Çerçizit dhe ja ndalonte djemtë në rrugë... ai fap, ngjyente një shtëllungë me bojë të kuqe dhe ja llangoste surratin atij të poshtri që u priste rrugën djemve.

Unë i shihja me sytë e mendjes gjithë ata turq të lyer e të ngjyer surratit me të kuq dhe qeshja e brohorisja sa s'stregohet. Kur pllakën e Çerçizit e kthenin së prapi, dëgjohej këngë tjetër i «Zogë, ku më qenke rritur? Anës së lumit, me mish të pëllumbit!» Kjo këngë nuk më pëlqente, sepse gënjenjtë. Sepse unë e dija fare mirë se zogat nuk hanin kurrë mish, ato çukisnin gjithë ditën pas lumit ose prisnin që nëna ime t'u hidhte gëzhuta.

Pastaj xhaxhai vinte një pllakë tjetër. Këtu këndohej një këngë shumë e bukur. Nuk di se kush kishte një vajzë me emrin Viktori dhe kësaj ia këndonte:

«*Viktori, t'u bëftë nëna,  
një shami me mollë të èmbla...  
...foli Taqit të ikë tutje,  
— Turçë dhe greqisht i fola,  
dot nga gjumi nuk e zgjova!*»

Ama gjumash i madh duhet të ishte ai Taqi. Të të flasin turçë mu në vesh, të të bërtasin greqisht mu në kokë dhe të mos zgjohesh!

Pyesja tim gjysh:

— Po kaq shurdh paska qenë ky Taqi, o bagjysh? I flasin turçë, i flasin greqisht...

— Eh... po tani, more bir, më s'pi ujë as gjuha turçe e as gjuha greqishte!

Kështu që unë përfytyroja dy gjuhë të thata e të tymosura varur atje te trari ku varnim llukani-kët; e këto dy gjuhët ishin terur e bërë trokë ngaqë s'kishin gjetur asnijë pikë ujë pér të shuar etjen.

Por kishte edhe ca pllaka, të cilat unë s'i kup-toja. Më thoshin se ishin në gjuhë të huaj. Po ç'më duhej mua se ishin në gjuhë të huaj, kur unë s'merrja vesh asgjë! Nuk desha t'i dëgjoja, por sidokudo unë edhe vargjet e tyre i kisha mësuar përmendsh me ndryshimin se të gjitha ato tekste e ato strofa unë i përktheja në gjuhën time prej kalamani dhe hyja aq thellë në kësi punësh gjuhësore, sa me lehtësinë më të madhe krijoja disa sallatëra gjuhësh të përziera, të sakatosura e të bëra përshest, sa... po të rronte e të më dëgjonte Samonkofi, ai i gjuhës esperanto, me siguri do të ma kishte zili, ose më saktë do të më kërkonte si ndihmës në punën e tij të më-vonshme.

Pastaj xhaxhai u nis përsëri në kurbet, kurse gramafonin e bënte të këndonte nusja e tij! Ky fakt më gëzonte pa masë, sepse në një farë mënyre edhe unë kisha dhënë ndihmën time në shkollimin e saj mbi përdorimin e gramafonit!

Por... : erdhi një ditë zie! Nusja jonë na lindi një djalë dhe pér djall merrej më shumë me të birin se sa me gramafonin. Kjo mua më tèrbonte. Unë kërkoja që ajo të vinte në jetë ato që kishte mësuar me ndihmën time të padiskutueshme, kur ajo e vinte gramafonin shpejt e shpejt dhe ikte përsëri. Dhe në një nga këto ikjet, papritur diçka krisi mu në bark të gramafonit dhe ai nuk nxirrte më as zë e as e vërtiste atë qilimin e tij gjelbërosh ku vërtitej plla-

ka e zezë. Heshtje dhe zi e vërtetë në shtëpi. Këtë ngjarje, patjetër me rëndësi, e mësoi Devolli i tërë qoshe më qoshe dhe thoshin se në kafenenë e qytit, mu në ditën e pazarit, nuk kishte fjalë e muhabet tjetër, veçse flitej për gramafonin tonë, të cilit ju këput zemberek!

Dhe unë rrija e vrisja mendjen: «Ç'është ky zemberek që është këputur? Pse është këputur?» Me këto mendime në kokë, pashë nusen tonë që po mendohej lart në ballkonin e shtëpisë. Ishte pikë e vrer. Me siguri për gramafonin! I thashë:

- Po si na ngjau kështu, o teta Krisë?
- Çfarë ngjau? — ma ktheu ajo tërë inat.
- Po ja de, si u këput ai zemberek?
- Ikë, ore, tutje me gjithë zemberek!

Një përbuzje e tillë më tronditi. Nusja jonë nuk po çante kryet për gramafonin e këputur. Kjo paska qenë firifiu nga mendtë!

Ika prapa shtëpisë atje te plehu afër qershisë, ku ishte logu i mendimeve të mia foshnjarake. Vështroja një për një gishtat e mi të vegjël e të njomë, mbyllja sytë përgjysmë dhe mendoja, përfytyroja, ngrija pandehma e ngrija pyetje. Kot që kot. Nuk i bija dot në të se ç'na kishte ndodhur. Ç'ishte vallë ky zemberek magjik që ishte këputur?!

Si thashë më lart, gramafoni më bëri t'u hyja disa çështjeve gjuhësore. Kështu që në këtë fushë unë e ndjeja veten më të fortë dhe me vetëdijen time mendova se në këtë drejtim duheshin bërë kërkimet. Mendova: Zemberek është afër fjalës bezemrek!

Asaj kohe nuk kishte llastik për të mbajtur të mbathurat e kalamajve. Kështu që mua mbathjet m'i shtrëngonin në bel me një farë lidhëseje që asaj

kohe e quanin b e z e m r e k, domethënë zemberek prej bezeje. Pra m'u mbush koka se atyre burrave e sazexhinje që rrinin strukur atje brenda në gramafon dhe këndonin u ishin këputur bezemrekët dhe tani... tani i mbanin pantallonat me dorë dhe nuk kishin nge të këndonin. Shpjegimi im ish fare origjinal, kjo më gëzoi pa masë, sepse munda t'i hyja një fenomeni fizik.

Dhe kaluan disa muaj që nga dita kur sazexhinjtë mbanin pantallonat me duar, gjersa na erdhi në shtëpi një njeri i panjohur që mbante nën duar një kaçavidë dhe një pincë. I panjohuri kishte një gjysmë kapotë prej lëkure dhe majat e gishtave i kishte me mëllërë të zez. Ky lëvizi disa vida, hoqi nja dy kapakë dhe...

Krejt imazhi im, krejt filozofia ime, krejt bota ime e përfytyrimit u shembën dhe ranë përdhe...

Brenda në barkun e gramafonit nuk kishte as gjë më shumë, veç disa vidave, një ingranazhi dhe zemberekut prej çeliku. Për herë të parë po i hyja jetës dhe realitetit, bota ime e përfytyrimit dhe e përrallave po më shembej.

## NË ACARIN E NJË DIMRI

Babai u nis për në mërgim më njëzet e katër të tectorit dhe u kthye mu në palcë të dimrit, në janar. Një mërgim i tillë, kaq i shkurtër dhe kaq i pa-pritur habiti pa masë jo vetëm shtëpinë tonë, por edhe të tërë fshatin. Thanë se babai ishte nisur për në Rumani me një vapor qomyri dhe u kthye me një tren. Unë vaporin e dija çka ishte, sepse thurja të tillë prej karte dhe i lëshoja bashkë me èndërrimet e mia në lumin e fshatit, por, meqenëse nuk e dija se ç'ishte treni, e kalamenda përfytyrimin tim në përgjasimet, tren, tra e kala e trenit, por nuk i rashë dot në të. Më shumë nuk mendova dot, sepse babai u kthye tepër i zbetë dhe kollitej shumë.

Dhe, meqenëse babai nuk kishte sjellë asnjë për hambarin apo për magjen e shtëpisë, duke më pësh-përitur ngadalë, më tha se kishte sjellë për mua një ngjarje të hidhur e një histori të dhembshme që ia kishte prishur mendjen fare. Asaj nate, kur kishin ardhur edhe disa miq të tij, ai filloi të tregonte:

«Kur kthehesha për këtej, kisha hipur në një tren të vjetër e të qelbur që mbante erë cironj të

prishur. Treni u prish dhe më la në një qytet të panjohur, diku nën Nish; mbeta përjashta mos më keq, pa bukë, pa para, pa njeri. Nuk dija ku isha dhe si quhej qyteti. Prapa më ndiqte si hije një xhendar sërb, i cili vërshëllente nëpër dhëmbë një këngë të turpshme:

«Krevat imam, çupa imam,  
lele badiava!»

Binte shi e kishte mjegull, sa era nuk e davariste dot. Nuk dija se nga t'ja mbaja, kur takova një çifut. Ky çifuti na ishte një mjekërxip i zgjuar, që të përgjegjej në çdo gjuhë që t'i flisje. Kishte një dyqan të vogël dhe kryente çdo punë që kishte të bënte me para dhe me tregëti. I qava hallin, kur mjekra e tij xipe i vajti mu në mes të kraharorit. Qeshte dhe më shihte nëpër xhamet e syzeve të veta:

— More shqiptar, — më tha — shih përjashta!  
Pashë.

— Të gjithë ata burra me feste të bardha që kalojnë poshtë e lart, janë të racës sate!

Dola dhe ndalova të parën «feste të bardhë» që më doli përpara. Ai, sa dëgjoi që i fola në gjuhën tonë, hapi krahët dhe më kapi për qafe, më puthi në të dyja faqet, më shtrëngoi fort në krahë dhe, kur unë isha në mëdyshje, më hoqi thuajse zvarrë:

— Pash zoten, hej burrë, — më tha — eja te shpija jeme!

Ishte një burrë i gjatë, i bukur, veshur me ca shallvare të bardha. Kishte një zë të thellë, që dukej sikur i dilte prej një kraharori të gjerë.

Këtë burrin na e quanin Hasan dhe shtëpinë e kishte larg trenit. E vjetër dhe e madhe ishte shtëpia e Hasanit, e ndërtuar me gurë të fortë, me trarë lisi dhe pa tavan. Era frynte nëpër trarët dhe çuçu-

riste nëpër hatullat. Si u mbyll porta me lloz hekuri, Hasani ndezi një cigare të madhe në dhomën e miqve, më shtroi përpara raki e meze, më drodhi cigare me gishtat e vet e pastaj më solli në dhomë fëmijët dhe gruan. Më pritën dhe më nderuan sa s'bëhet më mirë. M'u mblodhën të gjithë rrëth e qark dhe më shihnin të gjithë në sy. Pastaj Hasani, nuk di se nga hyri e nga doli dhe solli në dhomë një flamur të kuq me shqiponjë të zezë që e vari mu në krye të dhomës përmbi oxhak.

— Këtu në Kosovë, — më tha — po të ta gjejnë flamurin tonë, të varin në pazar!

— Të varin? — e pyeta unë.

— Po, po. Ne s'na lënë as të flasim gjuhën tonë, na ndjekin, na shajnë, na burgosin e na dërgojnë syrgjyn. Po ti, a ke ndonjë libër shqip me vete?

Nxora atë që kisha në torbë dhe ja dhashë.

— Mbaje, — i thashë — ta kesh kujtim nga unë.

I mbushi sytë me lot.

— Përse qan? — e pyeta.

— Sepse nuk di ta lexoj — ma ktheu.

Desha t'i thosha diçka dhe i fola sérish:

— S'ka gjë se nuk di... sot kemi dimër, apo jo?

— Po, dimër këmi.

— Por pas dimrit a nuk vjen behari?

— Vjen, por kushedi kur vjen...

— Vonohet, por një ditë ka për të ardhur, ja e dëgjon? Era nga jugperëndimi po fryn.

— Ashtu vërtet, nga mëmëdheu. Djemtë e mi mësojnë shqip, shkrim e këndim, por fshehur, me të vjedhur.

Ndenjëm gjithë natën duke folur si miqtë më të vjetër. Më tregoi për trimërinë e Isa Boletinit dhe

të Bajram Currit, për Luftën e Kaçanikut dhe të Shkupit. Në mëngjerez doli të më përcillte. Rrugët e qytetit ishin plot me feste të bardha që na jepnin mirëmëngjezin. U habita se si të gjithë ata burra shtatartë e kishin marrë vesh brenda natës se «nji shqiptar prej Shqipnisë së vjetër kishte ardhun mik ke Hasani!»

Nëpër qytet kishte plot xhandarë sërbë që mbanin koburet në brez dhe stemën e krajlit në ballë,

— Si shkoni me këta, o Hasan? — e pyeta.

— Pëllëmbë e tym, vëlla, duan të na zhdukin. Na e kanë sjellë shpirtin mu në majë të hundës, por ne s'jepemi! Kemi për të luftuar!

Mbërritëm te stacioni i trenit. Ishte i ndyrë dhe i shtrembër. Gjithë ato feste të bardha që pashë atje, kishin dalë për të më përcjellë mua. Miq dhe vellezër të panjohur, por të dashur. Zunë të më dhembnin shpatullat dhe krahët nga përqafimet. Hipa në tren dhe dola në dritare. Isha shumë i mallëngjyer, kur dëgjova një xhandar që shau rëndë:

— Bago majkata arnauti!

Katër xhandarë u hodhën përmbi Hasanin dhe nisen ta qëllonin me kondakët e pushkëve. Një kordon i gjatë xhandarësh doli te kreu i stacionit dhe u lëshua për këtej duke u fryrë bilbilëve! Në atë çast treni u nis, unë desha të hidhesha që nga dritarja, kur që prapa më kapi për supesh një xhandar sërb.

— Bego majkata arnauti!

Desha t'i shpëtoja, kur edhe tre të tjera m'u lëshuan sipër. I shtyva, i qëllova, i pështyva, i shava dhe arrita ta nxirrja edhe një herë kryet në dritare. Pashë ashtu vëllain Hasan. Ishte krejt i përgjakur, pastaj krisën disa armë, treni kërciti mbi

binarët e tij, unë shtyja dhe kafshoja me dhëmbë  
xhandarët që donin të më përmbanin dhe dola pér-  
sëri te dritarja e trenit...

Unë në atë çast për habinë time, pashë diçka të  
papritur... Hasani mundi t'u shpëtonte xhandarëve  
dhe u vërsul mbi oficerin sërb që kishte përpara.  
Një të qëlluar me grusht dhe sërbi me stemën e kraji-  
lit në ballë u përmbys përtokë me surratin tërë gjak.  
Kosovarë të tjerë u derdhën përmbi xhandarët.

— Hej Hasan! Më të lumtë, vëlla! Bjeruni!

Pastaj treni ulëriti dhe e humba nga sytë pam-  
jen e betejës që sapo kishte filluar.»

Kaq më tregoi babai në atë acar dimri.

Ishte e para dramë e dhembshme që po dëgjoja  
në jetën time prej fëmije. Dhe si e para mbi të pa-  
rat, kurrë s'e harroj dot. Dhe kosovari me fytyrën  
gjak, kosovari me festen e bardhë dhe me grushtin  
e rëndë, më ndjek gjithnjë nëpër jetë e nëpër botë  
dhe unë kurrë s'mundem ta harroj. Kurrë!

## DHIMITËR TAKSIRATI

Ishte aq ftohtë atij dimri të rëndë, sa nuk na zinte gjumi tërë natën. Të ftohtët ngrinte e priste brenda në dhomat aq sa ata më pleqtë ndiznin zjarrët e mëdha në vratat dhe i ushqenin gjithë natën me kërcunj prej lisi, ose me rrënje prej vidhi.

Por e keqja nuk ishte vetëm te njerëzit, nga ahuret ku mbanim gjënë e gjallë dëgjoheshin pëllitjet e zgjatura të bagëtisë. Hatullat dhe vrimat i mbyllnim me paçavure e me baltë, por... edhe kështu të ftohtët dhe cingërima se ku gjenin të çara dhe hynin gjer në ahuret e ulëta ku kafshët e shtëpisë rrinin përpara grazheve, duke përqapur kash-tën e duke u dredhur nga të ftohtët. Atëhere, gratëtona në merak pér shëndetin e gjësë së gjallë, i kthe-nin saçet përmbyss, i mbushnin me prush lisi dhe i çonin poshtë në ahuret. Kështu bagëtitë ndjeheshin më mirë dhe medoemos lopa balashe do të lëshonte qumësht pér të njomur lugën e neve çamarrokëve, që nuk ndjenim të ngopur edhe se rrnim gjithë ditën shtrirë e të struktur nëpër qoshet nga droja e atij dimri të rëndë që s'bënte shaka, por... po ta

nxirrje goftë edhe majën e hundës përjashta, të vërtitej me fishkëllima dhe të bënte të hyje, jo në dhomë, por të futeshe brenda në sëndykun e gjyshes, ku kishte shumë lecka, disa lëmshe me lesh të butë dhe dardha fice.

Në këtë palcë dimri ne kishim në shtëpi edhe një fëmijë të huaj. Ishte një vocrrak si unë me emrin Luli dhe' unë bashkë me Lulin, përqafoheshim fort dhe ashtu na merrte gjumi.

Familjes së Lulit i kishte ndodhur një ngjarje tepër e dhembshme. Aq e hidhur dhe aq e dhembshme ishte, sa nuk e përbante dot kurrsesi zemra ime prej fëmije.

Luli nuk kishte më shtëpi dhe strehë ku të fuste kryet.

Sepse kishin kaluar vetëm një dy muaj që kurse na kishte ardhur në fshat Dhimitër taksirati!

Ky Dhimitri na ishte mbledhës i taksave në atë kohë dhe për zanatin që kishte quhej «taksidar», por, ngaqë ardhja e tij në fshat shkaktonte frikë dhe pështjellim, njerëzit e thërrisin Dhimitër taksirati. Tagrambledhës quhej shqip, taksidar quhej që në kohën e Turqisë, por, meqë fjala «taksidar» ishte e afërt me fjalën «taksirat» (turqisht edhe kjo) njerëzit ja kishin ngjitur: Dhimitër taksirati. Dhe «taksirat» në turqishten popullore do të thotë «fatkeqësi». Pra ky taksirati ish një burrë i shëndetëshëm, gjak i kuq nga faqet dhe nga zverku, rrumbullak nga ftyra, me disa sy të lëvizshëm dhe me disa rrudha ugurzeza në ballë. Kur rrudhat e taksiratit mblidheshin... atëhere, ruajna, zot, të hapje sytë, se e pësoje.

Taksirati erdhi në fshat atëhere i shoqëruar nga tre xhandarë, njëri prej të cilëve kishte gradat e kap-

terit. Ata kishin pushkët në krah, koburet në brez, disa bote prej lëkure të zezë në pulpët, kurse në kokë kishin ngulur disa kapela si kutira rrumbullake, në ballë të të cilave kishin ngjitur nga një germë «Z» prej hekuri.

Ishte vjeshtë, rigonte shi i hollë dhe mblidhë rrugëve bykun e beharit.

Taksidari thërriste e bërtiste:

— Sokrat faqeziu më gënjeu, i ardha në shtëpi për taksat dhe më nisi me shoshë për ujë. «Ikë më tha, se ditën e pazarit do të shes lopën dhe do të t'i nxjerr paratë në qytet...» As u duk fare, po krisi e iku në kurbet, maskarai, gënjeshtari... Tashti... tashti, me urdhër ligjor dhe mbretëror plaçkat në rrugë, do t'i sekuestroj shtëpinë!

Teto Vana, gruaja e Sokratit, nusja më e dashur dhe më e ëmbël e mëhallës, mundohej t'i jepte përgjegje:

— Po dale, zoti Dhimitër... e ku ta gjente këtë lopë që ta shiste burri im! Ne lopë s'kemi pasur kurë... me se...

— Aq më bën mua, të mos më gënjente, ty leckat në rrugë, që të mësojnë të tjerët...

Xhandarët i hynë punës. Unë pashë se si u nxorën në rrugë një tog sendesh: një djep fëmije, një shkorsë e vjetër, dy rrogoza, një kurorë misri, pastaj Luli i vogël si i shastisur në prak dhe në krah të tij, motra më e vogël, Nula njomëzake me një thi-thëzë llastiku në gojë që e ndukte... Pastaj xhandarët nisën të nxirrnin jashtë magjen e shtëpisë, kapaku i saj u hap dhe disa copa misérniqeje ranë mbi baltë...

Gjer këtu dhe teto Vana, nusja më e urtë dhe

më e ëmbël e mëhallës, nuk u përmbajt dot. Ajo ju vërsul xhandarit me thonj e me dhëmbë:

— Egërsirë! Egërsirë!

Xhandari, në vrull të parë s'u përmbajt dot, u praps, por grushti i nusës e arriti te hundët, pastaj gishtat e saj të egërsuar e çorën ku mundën.

— Egërsirë!

Xhandari shkau nëpër baltë, rripi i nëngushës ju këput, kapela i fluturoi nga koka, i ra përdhe e u rrrotullua nëpër baltë. Rrotullimin e saj e ndaloi streha e zezë që kafshoi baltën. Kur kapteri u derdh ta ngrinte, mu në baltën e lëmuar dallohej qartë germa «Z» e vulosur së prapthi.

Fshati ishte në zi e dridhej. Unë e shokët ishim mbledhur mu nën strehët e kashtores kundrejt. Shiu na rrihte sipër e na rridhte fytyrës e trupit, këmbët i kishim në llucë, flokët na qenë ngjitur pas tullgës, era e vjeshtës na thante duar e faqe e fletët e tha-ta të shelgjeve na binin fytyrës si të ishin presa prej shavari. Por ne s'iknim prej andej, lotët na rridhnin faqeve e ne s'i ngrinim duart që t'i fshinim. Ishte diçka e jashtëzakonshme dhe e paparë. Ne ishim të mitur, po për herë të parë në zemrat dhe në shpirtë-rat tanë prej fëmije po ndjenim një lavë të nxehjtë.

Në qoshe u dha prifti i fshatit. Pas tij vinin një dhjetë gra me rroba të zeza që qanin e shkulnин faqet, shihnin nga qielli dhe i luteshin uratës. Qielli ishte pus i zi, shiu binte i hollë dhe i dendur, kurse veriu rënkonte nëpër hatullat e nëpër rrugët, fishkëllente aq me vrull, sa hynte edhe nëpër rason e madhe të papa Janit që e frynte nga brenda, e zmadhonte, e mbushte me erë sikur të ishte ndonjë kacek prej lë-kure bualli, pastaj ia ngrinte lart sa i dukeshin këll-

qet stërmëdhenj veshur me benevrekë leshi, ngjyer në çacaник.

Prifti i shkoi drejt kapterit e, sa t'i afrohej, ai ja priti:

— Uratë, ti shih ungjillin dhe trisahitet!

Dhe që asaj dite shtëpia e teto Vanës u mbyll me zinxhir dhe me një kyç të madh dhe vendi përmbi kyçin u vulos me dyllë të kuq. Teto Vana jetonte një natë këtu e një ditë atje, kurse Luli i vogël flinte me mua.

Por kaluan dy muaj dhe një natë dimri taksi-dari i zonës sonë merr vendim të niset të na vijë. Niset nga qyteti pasi hëngri drekë te Qamil Gega, merr kalin, i vë samarin, një jasték të vogël përsipër, përmbi të një shilte të butë, hedh edhe hejbet me defterët mbi kocaqet, frerin në gojë dhe... o burra, dori, brenda dy orëve gjendemi në Gropar!

Gjellëtorja e Qamil Gegës, e mbushur me kundërmimet e gjellëve, kishte qenë shumë e ngrrohtë asaj dite; tasqebapi me pipere djegëse që kishte ngrënë Dhimitraqi edhe ai kishte bërë të tijën, por nja dy kupa verë të kuqe gjak e kishin ndezur keq kokën e taksiratit, sa atij i qe mbushur mendja top se asaj pasditeje në majë të kalit dori, jo vetëm që në Gropar mund të vinte shpejt e shpejt, por «besa-besën, edhe në majë të Gramozit mund të ngjitem!» kishte thënë.

Sa kapërceu urën e madhe prej druri afër Selës, sa mori atë të përpjetën e Dubravës e sa doli në atë fushën kërr, era dhe suferina e sulmuani aq rëndë, sa Dhimitraqi u shkund përmbi kalë dhe e ngriti një herë pagurin e plumbtë mbushur me raki. Por edhe prej rakisë suferina s'desh t'ja dinte. Atëherë Dhimitraqi mendoi një ilaç tjetër. I kapardisur mbi sama-

rin me shilte jalli, ktheu kryet nga lindja dhe bëri kryq tri herë me radhë: «Në emër të atit, të birit dhe të shpirtit të shenjtë!» Nga të ftohtët e madh Dhimitraqi e kishte tundur dorën porsi kopaçë të thastë, por sidokudo kryqin tri herë saktë e kishte bërë! Por as ati e as i biri e as shpirti i shenjtë nuk mund të mbreheshin me veriun e asaj dite. Kështu që Dhimitraqi vendosi që, gjer të soste në Gropar, nëpër këtë rreptësi të kohës, të bënte kryq vazhdimisht: «Zot e shën Mari, shën Koll i udhëtarëve dhe i detarëve!»

Si për inat, sápo mbaroi këtë lutje, veriu ulëriu si ndonjë bishë e goditur dhe ju përvesh fytyrës së Dhimitraqit me disa si gjilpëra prej akulli që e bënë të dridhej e të rënkonte sikur ta kishte kapur ajo punë!

Taksirati u rrëqeth dhe e kuptoi se e kishte pisk. Por, meqë duart ju bënë si kopaçë të ngrira, ai filloi të bënte kryq me majën e gjuhës mu në qiellzën e tij që ende ishte e llangosur me lyrën e tasqebapit që, ndjesë pastë, aq mirë e gatuante Qamil Gega në Bilisht!

Kali shfrynte e turfullonte, kërcente e hidhej nga të ftohtët, një, nga bora e madhe, dy dhe tre, nga ajo barra e rëndë si plëndës që kishte mbi shpinë. Por freri i hekurt që kishte në gojë ia godiste me tërbim nofullat, sa zunë t'i kullonin gjak.

Kur doriu me kalorësin u gjend mbi Kodrën e madhe që bie pikërisht midis tre copë fshatrave fqinjë, ai ngriti krahun me mundim dhe e vuri mbi fytyrë. Nëpër renë me borë që i vërvitej fytyrës ai vështroi fushën e tërë me atë zbardhëllimin e mje-gulluar, pastaj fare papritur që pas një gorrice të egër diçka lëvizi. Dhimitraqi u drodh i trembur. «Ujk!»,

mendoi në të parë, po, kur shkoi edhe një pesë hapa, dalloi një njeri që çalë-çalë po i afrohej. I panojohuri ishte si i kallaisur i téri me borë e me okitë.

— Tungjatjeta!

— Tungjatjeta e me nder!

— Ç'je ti, ore?

Tjetri ju afrua aq shumë, sa fytyrën e kishte mënë gjurin e djathjtë të takシリatit, e vështroi mirë këtë dhe e njohu:

— A... ti zoti Dhimitraqi je?

— Unë, po ti ku shkon?

— Më kanë mbetur fëmija pa bukë, po shkoj të një mik i fushës!

— Lëre mikun e fushës dhe eja pas meje se, si po duket, kemi pér t'ja falur shpirtin djallit sot...

— Jo, jo, — ja ktheu fshatari — unë s'mund të kthehem, po nuk më thua zotrote, ku shkon kështu?

— Ku shkoj? Dhe pyet pa! Detyra, ore... ja atje në fshatin tënd po shkoj, janë ca kokëderra atje që më premtuan se do të dilnin ditën e javës në Bilisht e do të m'i sillnin, por më gënjen. Sot po shkoj vetë përsëri dhe kam pér t'ua ndrequr samarin...

Fshatari përkëdheli jelen e kalit me dorën e djathjtë, kurse me dorën e tij të majtë zuri të fërkonte barkun e kafshës, sikur kështu të desh ta ngrohte sado pak. Por mendja e tij prej fshatari praktik punonte po aq nxituar, sa edhe gishtat e tij aty anash barkut të doriuat ku ishte lidhur qengla e samarit...

— Hajt me të mira, zoti Dhimitraq! Vija me gjithë qejf pas zotërisë sate, por, si të thashë, kam fëmijën pa bukë...

— Kthehu, or, gjetsh belanë, — bëriti Dhimitraqi — kthehu, se kam pér të të paguar! Kthehu më tre go rrugën, se do ta humbas! Të paguaj!

— Falem nderit, po paratë as që shkojnë në këtë: kohë, hidhja qenit e nuk i ha, unë kam fëmijën pakukë... hajt mirë vajtsh!

Dhe pa e zgjatur shumë, fshatari i thirri vrapijtatëpjetë. Desh, s'desh, Dhimitraqi ja ngjeshi kalit me mamuzet në bark, kafsha kërceu përpjetë dhe u nis.

— Hë, pis i poshtër! — shau me inat taksirati — në më rënëq në dorë, pa qindin kam për të të punuar!

Hoqi frerin në çast dhe qëndroi, u kthyte përgjysmë nga iku i panjohuri dhe i bërtiti:

— Ore tiii!

Fshatari e dëgjoi dhe ja ktheu:

— Ç'deshe zotrote?

— Si e ke emrin?

— Emrin! Po ç'e do emrin tem ti, pastaj, ja atje në defterat e tu e ke, hape dhe gjeje!

Dhe nëpër erën dhe suferinën që frynte, i panjohuri ja dha vrapijt nëpër borë.

Por nuk kaloi as edhe një minutë, kur kali me kalorësin u gjend në fillimin e një të përpjete. Dhimitraqi e nguci doriun që ta merrte me nxitim dhe ja ngjeshi me mamuzet, kali u hodh përpëra e fare papandehur, Dhimitraqit iu bë sikur e humbi ekuilibrin, samari i kafshës shkau përmbi kurrizin e saj, freri i shpëtoi nga duart dhe taksirati u përmbyss nga kali. Kur ra, nuk u vra aspak, sepse bora qe e trashë, por doriu i lehtësuar nga barra e rëndë, ja thirri vrapijt nëpër borë!

Dhimitraqi u lemeris. Menjëherë i shkoi ndër mend:

— Ai qen fshatari më punoi qindin, qeni, o qeni, kur bënte sikur ngrohte duart pas kalit, më ka zgjidhur qenglën e samarit!»

U ngrit rrëmbyer dhe rendi pas doriut. Por kafsha tinzare, e cila mezi shpëtoi nga gjithë ajo barrë, as që e afronte... Taksirati s'mund të gjente rrugë tjetër, veçse të vërsulej me vrap pas kalit. Doriu ekte ngadalë, por, sa i afrohej i zoti, hingëllinte me inat dhe hidhej me vrull përpara. Atëhere Dhimitraqi mendoi të rendte anash nëpër borë dhe t'i priste rrugën. Ashtu bëri dhe, falë ngricës që e kishte ngurtësuar borën dhe e mbante përsipër bëri t'i dilte doriut përpara.

— Na, dori! Dale, or xhan, shpirt dori, po ne jemi miq të vjetër, o i mallëkuar! Në këtë kallkan kërkon të më lësh rrugëve!

Dhimitraqi tani nuk e kishte kaluar më shumë se tri çape. Ja preu rrugën dhe ju vërsul t'i kapte bishtin e frerit. Por në çast kafsha ja ktheu vithet dhe lëshoi një shqelm aq të fortë, sa për një qime do t'i kishte vënë pikë tregimit tonë.

— Ah, dori, qen, po mos, o i mallëkuar! Eh, unë i ziu, ç'kanë për të më zvarrisur ujjqërit nëpër Dubravë! Nga shkohet nëpër këtë qamet tashti?

Kur Dhimitraqi mori një start tjetër, këtë herë nga ana e majtë, doriu u xhindos dhe ja lëshoi një shqelm. Por kësaj radhe nuk i shkoi kot. Dhimitraqit i përvëloj kofsha e djathë. Atëhere nisi një lojë e pabarabartë. Kali ik e Dhimitraqi ndiq, kali ik, Dhimitraqi ndiq, derisa taksiratit ju prenë fuqitë dhe e pa se e kishte davanë të humbur. Në çast ndërroi fletën dhe nxori revolverin. Vendosi të jepte alarmin me krismat e armës. Ja ngriti lart grykën dhe: Gau! Gau! Gau! Tri të shtëna në mes të të ftohitit dhe cingërimës. Atëhere ju kujtuan hejbet ku kishte dëfterët.

— Bobo, i ziu unë! Po defterët?

Veriu fishkëllonte, gjurmët e mbetura prapa as

që dalloheshin fare. Ato i fshinte era dhe i mbushte bora. Shenjë rruge nuk dallohej. Ai desh që, medomes, të kthehej prapa, të gjente hejbet me defterët, t'i merrte më krahë dhe pastaj... «Pastaj si ta kem të thënën»!

Te kreu i Kodrës së madhe ai dëgjoi zëra një-rijesh.

— Ho, ho, hooo! bërtiti Dhimitraqi.

Dhe vetëm pas nja dy minutash, tre fshatarë burra të shëndoshë me një sëpatë në duar e gjetën Dhimitraqin shtrirë mbi borë.

— Ti, zoti Dhimitraq, je?

— Unë jam që mos qofsha, po a e dini se ç'duhet bërë?

— Urdhëro, zotrote, jemi gati!

— Së pari duhen gjetur hejbet me defterët që më mbetën mbi borë, pastaj ai i mallëkuar kalë!

— Hiç mos ki gajle, — e siguruan ata të tre — njëri prej nesh do të merret me zoterinë tuaj, veriu ju paska katandisur keq, edhe për një qime dhe të rrëmbeu gojën, njëri do të sulet pas kalit, tjetri të gjejë hejbet e zotërisë sate.

— Hë m'ju lumtë, do t'jua shpërblej!

— C'është ajo e shpërbyer, zoti Dhimitraq, ne e kemi për detyrë!

Dhe si me magji nëpër qoshet e mjegullës dhe të dumanit me borë që ngrinte era, nisën të dukeshin forma njerëzish. Ata dilnin fare papritur nga ajo gjysmerrësire dhe flisnin:

— E kush je ti, oreee!?

Një gatishmëri e tillë e njerëzve për të ndihmuar një udhëtar, të panjohur, i pëlqeu Dhimitraqit. Vërtet se ai tani ishte me gjysmë goje, vërtet se duart i kishin rënë përthonjsh, ishte me kokë të rënduar

e me mendje të turbulluar, thembrat e këpucëve i qenë rritur dhe i qenë bërë si taka me gunga... por ja se ku po nxitonin fshatarët pér ta ndihmuar! Dhe Dhimitraqi sa mundte dhe si mundte, shante e tërbohej, mallëkonte e betohej se kishte pér ta bërë zapatë maskara kalë. Po fshatari që ja punoi?

Një farë ngërçi e bënte të dridhej pa pushim, barku i lëkundej si prej ethesh të liga, kurse fshatari e ngarkoi mbi kurriz dhe nisi ta zvarriste tatëpjetë Kodrës së madhe pér në Gropar!

Më në fund atë e çuan te kryeplaku i Groparit, e sollën në vete me ujë të ngrohtë, me të shkundur e me të fërkuar, deshën ta vinin të flinte, por ai nuk pranonte.

— Defterët! — bërtiste ai i shkalluar. — Defterët, se u mora më qafë! Aman defterët e taksave, se mbarova!

Në mëngjez u kap kali!

Ishte një mëngjez mavi dimri që e kishte kthyer botën e tërë në kallkan dhe në okitë. Duart e fshatarëve që mbanin pér freri dorinë ishin trashur nga të ftohtët, fytyrat e tyre ishin të zeza, kurse dhëmbët u zbardhnin nga disa të qeshura tinzare e dhelprake, që e bënë Dhimitraqin të ulërinte si bishë.

— Hejbet! Aman, hejbet, se sharrova!

— Po kërkua, zoti Dhimitraq, nuk gjetëm gjëkundi!

— Mos i kanë shqyer ujqërit, zoti Dhimitraq?

— Po çfarë ujqërish, mor maskarenj, defterët e mi nuk janë prej mishit, defterët janë kartë, letër, mor të humbur! Ujku nuk ha defterë e as kartë!

Kaloi një javë e tërë me kërkime nëpër borë. As shenjë e nishan hejbesh e defterësh. Vonë pas nja tetë ditësh, kur Dhimitraqi e mori veten e doli vetë

të bënte kërkime, në një përrua me ca erëra të dyshimta, ai gjeti disa copëra fletësh prej defterëve të tij! Po si i gjeti dhe ku i gjeti se! Më në fund ai e kuptoi. Dikush i kishte shqyer dhe i kishte bërë fije-fije defterët e tij. Por e keqja ishte se nuk e dinte nëse «ishin shumë, apo ishte një njeri i vetëm që kishte bërë këtë krim, këtë turp e këtë çnderim dhe këtë batërdi që drejtohej kundër shtetit e kundër larmadhërisë së tij, mbretit!»

Pastaj u përhapën fjalë se nëpër atë dimër të rendë, nëpër majat e maleve, nëpër pllajat e nëpër grykat, nëpër drizat e nëpër shkëmbinjtë e mbuluar me borë, fluturonin fletë të shkruara e të bëra fije-fije! Dhe nëpër çdo copë letër që endej maleve bashkë me erën e bashkë me shqotën, lexohej nga një emër. Dhe përbri çdo emri shkruhej me radhë: Filani, i biri i filanit, ka për të paguar për koshin e ble-teve, kaq për taksën e të dhjetave, aq për xhelepin e bagëtisë dhe kaq për taksën e shtëpisë!

\*  
\*      \*

Nënprefekti i zonës po ngrohej mbi mangallin e zyrës së vet. Sytë i kishte prush, por ballin e kishte të zbetë. Karrigeja e tij kërciste e lëkundëj, ai gultonte e mundohej të fuste nën hì bishtin e cigares. E fuste, po përsëri tymi i keq i dilte përpjetë. Përballë tij rrinte si i shastisur dhe i nemitur Dhimitraq taksirati.

— Ja që na ngjau hataja, zoti nënprefekt! Do të bëjmë gjashtë defterë të rinj, kjo do të na hajë ca kohë, do të kemi edhe ca ngatëresa me fshatarët...

Nënprefekti ngriti kryet dhe kafshoi buzën e poshtme, mbylli njërin sy dhe nënqeshi me dinakéri:

— Dëgjo këtu, Dhimitraq!

— Urdhëroni, zotëria juaj...

— Mua nuk ma hedh dot, Dhimitraq, lojën tënde unë s'e ha. Ti vetë i zhduke defterët dhe vetë i bëre copë-copë, që paratë e mbledhura t'ja hedhësh xhepit.

Sytë e taksiratit kërcyen përjetë, sikur po i shkulej stomaku:

— Si ju shkon mendja kështu, zotëria juaj...

— Lëri pelivanallëket, Dhimitraq, se unë jam më pelivan se ti... tashti zgjidh e merr, ja t'i ndajmë përgjysmë paratë që i hodhe në xhep, ja...

Taksirati kërceu përpjetë, sikur e thumbuan grerat:

— Të puth dorë e këmbë, zoti nënprefekt, të betohem për Krisht e pér shën Marinë, pér nderin e gruas dhe pér jetën time...

— Lëri këto profka, Dhimitraq, të ishe betuar pér djajtë e skëterrës, do të besoja. Shkurt tashti, zgjidh e merr, ja paratë përgjysmë, ja në gjyq!

— Në gjyq! Në gjyq! Në gjyq! .

Dhimitraq taksirati i gajasur dhe i trembur përsëriste këto fjalë si papagall dhe ishte gati të kafshonte gjuhën e vet, por nënprefekti nuk i ndahej:

— U trembe, hë? Po të vjen bota vërdallë, Dhimitraq, hë? Unë t'i zbulova të palarat, qen, bir qeni, unë...

Papritur Dhimitraqi u vërsul i trimëruar:

— Dhe atje në gjyq unë kam pér t'i thënë të gjitha këto...

— Atje, Dhimitraq, bjeri legenit sa të duash. Unë asgjë s'të kam thënë.

— Po si guxoni, zotëria juaj... a s'u vjen keq për mua, kam qenë besniku juaj më i shquar, juaji dhe i lartmadhërisë, për ju jam bërë hasmë me Devollin e tërë, për ju kam shkulur gra e fëmijë nga vatrat, për ju...

Por Dhimitër talkiratin më s'e dëgjuan. Xhendarët ja hodhën zinxhirët në duar, kurse nënprefekti pregetiti aktakuzën.

## KUR SHTRYDHESHIN RRUSHTË. . .

Një ditë vjeshte, kur isha i vogël, më thanë:

— Do të shkojmë miq te një kushëriri ynë, tuje nga këneta, andej nga janë ata bujxit gjysmatarë. . .

Nga e gjithë fraza e thënë, meqenëse hynte brenدا edhe fjala kënetë, mua më mbeti në kokë vetëm fjala e fundit dhe i përfytyrova këta «bujxit gjysmëtarë» si gjysmë peshq e gjysmë njerëz.

Pra, babai hipi në samar mbi kalë, mua më hipën në vithe të Kuqos, prapa shpinës së babait. Palltoja e tij mbante erë borzilok dhe plisa të thatë ugari.

Kur u afruam në Kallamas, u habita nga kuatja e vazhduar e bretkosave, nga pamja e trishtuar e kënetës me gjithë ato ujëra të ndenjura, u habita me shavarin qe s'e kisha parë ndonjëherë, por mbi të gjitha u habita nga pamja e fshatit. Shtëpi të ulëta prej plithari, dritare shumë të vogla, pullaze të mbuluara vetëm me kashtë thekre dhe tym që dilte në-për këtë kashtë, sepse i gjithë fshati nuk kishte oxhaqe. Atëhere, në Kallamas, për të pasur oxhak

dhe pér tē pasur tē drejtén tē hipje nē kalë, duhej tē ishe i një rangu më tē lartë se sa ai i një bujku gjysmatar...

Fshati e kishte nē mes edhe një lumë tinëzar që derdhej aty pari e përdridhej nëpër shelgje, kulta e rakita, nëpër ferra e nëpër plepa.

Përmbi fshat, nē rrezet që zbrisnin nga malet, krejt tokat dhe pllajat ishin vreshtë. Vreshta tē pa-fundme dhe anash tyre drurë tē bukur ftoi. Një mori njerëzish punonte nëpër vreshtat dhe unë dallova midis tē rriturve djem dhe vajza tē vogla që vilnin rrush nē sepete, tē tjerë, që mbartnin rrush nē kuaj e gomarë dhe, kur ngjiteshin sérish nē vreshtë, i mbushnin koshat me pleh pér tē mos u kthyer bosh.

Kur hymë nē fshat, nē buzë tē kënetës, atje ishte një farë hajati i gjatë ku qenë radhitur nga dyqind voza e bute. Këtu mësova se i gjithë fshati me toka e me shtëpi ishte pronë e Yzeir bej Vilës dhe njerëzit punonin vetëm pér tē. Prandaj u thoshin bujq gjysmatarë. Babai e ndali kalin përparrë një burri këmbëzbathur tē veshur me rroba shajaku tē zi, me shumë leshra mbi fytyrë. Ky kushëriri vente e vinte rreth një buti tē madh dhe me dy copëra hekuri ndër duar qëllonte rrathët e butit pér t'i shtrënguar më fort. Rreth e qark zbrisnin kafshët e ngarkuara dhe nga koshat e mbushur me rrush, pikonte lëng i kuq.

Kushëriri më mori hopa nē krahë dhe, duke më vështruar, i tha babait:

— Ky ngjet tamam si gjyshi Mitrush!

Kur arritëm nē shtëpi tē kushëririt, pashë atje plot njerëz, por nuk më dalloi syri as edhe një moshatarin tim. Kështu që, dashur, padashur, nisa tē

merresha me të rriturit. Më têrroqi vëmendjen një djalosh shtathedhur dhe zeshkan, i cili më mori hopa në qafë dhe më puthi në të dyja faqet. Ndërkokë babai më tha:

— Ky është yt kushëri, Stefani!

Ky kushëri Stefani ishte aq i shkathët, sa më vërtiti mua në erë, si të isha fugë. Dhe nuk më la të mërzitesha. U nisëm. Rrugës më pyeti:

— Ke ashikë?

— Kam, po nuk i solla me vete.

— Do të të jap unë.

Stefani më fliste, por e shihja se mendjen s'e kishte fare tek unë. Në atë fytyrën e tij zeshkane, aq krenare dhe të bukur, ai shihte diku larg, kurse këmbët e tij të mbathura me opinga lëkure kau nxitonin fort. Unë mezi e ndiqja. Shkuam dhe hymë tek ai hajati që pashë kur arritëm në fshat. Brenda në të kishin shtruuar shumë rrogoza ku dergjeshin kupale me rrush, pastaj kishin vendosur shumë govata druri dhe vetëm te njëra govatë ishte ulur më gjunjë një vajzë e re që po shtrydhëte me duar rrush të kuq e rrush të zi. Sa na pa ne, vajza u çua më këmbë. Llërët i kishte të kuqe nga lëngu i rrushit, sytë i kishte të ndezur nga aroma e mushtit, pëllëmbët i kishte të lagura e ndoshta prandaj më përkëdheli duke më kapur kryet vetëm me të dy bërrylet e saj topolake dhe pastaj u përkul dhe më puthi në të dyja faqet. Edhe kjo vajzë duhet të ishte kushërrira ime, sepse, jo vetëm që më përshëndeti me shumë dashuri, por, një çast, kur unë ndjeva bërrylat e saj mbi kokën time, ajo diç pëshpëriti dhe guiti fytyrë mbi fytyrë me Stefanin. Unë medoemos u gëzova që kisha edhe një kushërrirë kaq të bukur, e cila, pasi hetoi nga trema, më vuri ndër duar një

vile rrushi me ca kokrra aq të zeza e aq të mëdha, sa mund t'i krahasoje me sytë e saj, që ishin aq të qeshur, aq të dashur dhe aq të ëmbël.

— Amali, — i tha Stefani vajzës — ende s'të kanë ardhur shoqet?

— Po ti pse erdhe kaq shpejt? — pyeti ajo në vend që të përgjegjey.

Ndoshta ai kishte dashur t'i thoshte «erdha përtty», por unë, këtë atëhere nuk e merrja dot me mend, ashtu sikurse nuk e dija se shpeshherë, djemtë e vegjël ose vajzat e vogla, dashur, padashur, bëhen mbrojë për çiftet e rinj.

Pra kushërirën e re e quanin Amali, Stefani i tha asaj disa fjalë që nuk i kapa dot, e pastaj ai më tregoi me dorë një kupale të madhe me ftonj verdhashë andej nga fundi i korridorit. Unë renda përatje dhe ngela i hutuar. Qetësi. Jashtë bretkosat kuatinin gjithnjë; më tutje kërcisinin çekanët mbi rratët e buteve, kurse këtu... lëngu i rrushit ziente e fermentohej nëpër vozat, ftonjtë kundërmonin dhe rrushtë atje te govata shtrydheshin e shtrydheshin gjithnjë!

Me Stefanin u kthyem sérish në shtëpi. Ishte koha e drekës. Këtu papritur takova edhe një kushërirë tjetër. Këtë e quanin Sofi dhe e kishte lëkurën ezmere si të Stefanit. Kjo i ngjiste tamam Stefanit, jo si motra Amali, e cila nuk i ngjiste fare. U shtrua dreka. Njerëzit u mblodhën rrëth sofrës e u shtruan këmbëkryq; Sofia mbeti më gjunjë, por ende nuk po fillonim. «Medoemos, mendova unë, presin edhe motrën Amali». Pastaj krisi dera, unë ktheva kryet të shihja kushërirën Amali me faqet e bukura, kur në vend të saj hyri plaku i shtëpisë. Nuk di se si u habita aq shumë, sa guxova dhe i pëshpërita Sofisë:

— Po kushërirën Amali nuk e presim?

Në vend që të merrja përgjegje, Sofia qeshi me zë, ngriti lart grushtat dhe me shaka e qëlloi të vëllain:

— ...Edhe kalamajtë të morën vesh...

Unë nuk kisha marrë vesh asgjë, por hajde t'ia mbushje mendjen kushërirës Sofi.

Pasdreke shkuam përsëri në atë korridorin e madh. Tani ai ishte mbushur plot me vajza që shtrydhnin rrushtë ndër govata. Mu në krye të vendit ishte një but i madh, rreth të cilit nisi të punonte Stefani duke qëlluar me çekan rrathët e hekurt: «Dang! Dang! Dang!»

Shtrydhej rrushi, ftonjtë priteshin thela-thela dhe nuk di përse sitej hi zjarri që mblidhej ndër tagarë të mëdhenj. Po vija vërdallë poshtë e lart, herë duke vështruar Stefanin që punonte, herë duke piritur buzëqeshjet e kushërirës Amali, e cila më vështronte me shumë mirëdashje... kur, papritur, m'u duk sikur atje fryu një acar i ftohtë... Dikush tha:

— Po vjen Yzeir beu! Po vjen Sadush beu!

Vërtet! Në prak u dha Yzeir bej Vila, barkalec, me qeleshe të zezë në kokë, me gravatë mëndafshi në grykë, me xhaketë Evrope e me pantallona kilota, kishte një qostek ari mbi kraharor dhe shumë dhjamë nén gushë. Në krah të tij i biri, Sadush beu, delikat, por shtathedhur, i rruar bukur e me shije, lënë një mustaqe të hollë, kishte një kapelë prej liceisti, me sahat në dorë, këmishën prej mëndafshi të bardhë, në xhep të xhaketës një gazetë, kurse në dorën e majtë një libër blu, të cilin e mbante të kapur me një shami të bardhë e shumë të pastër.

Bashkë me ta hyri edhe Ristoja nja gjashtëdhjetë vjeç burrë, me dy sy të vegjël e të guxim-

shëm, i gatshëm t'i shërbente beut të vet. U vendos heshtje e qetësi. Risto qehajai nisi të shfletonte një defter të madh e diçka i thoshte beut nëpër dhëmbë. Beu tregohej i pakënaqur nga ato që dëgjonte e pastaj ngriti zërin:

— ...Edhe unë kam harxhe shumë, xha Risto, e sheh këtë birkon? — Tregoi me gisht të birin. — Do ta nis për në shkollë të madhe sivjet, në Francë do ta dërgoj, i jam lutur për në Stamboll, po s'i mbushet koka, e heqin frëngeshat me cullufet e prera, xha Ristooo! Po nejse... nëpër tirat e Anadollit rru-shi lëshon më shumë sheqer...

Unë që s'dija se si rruishi mund të lëshonte sheqer, e pandeha beun për të krisur nga mendtë, kur Sadush beu ja ktheu të atit:

— Andej nga Anadolli yt, baba, si edhe këtu, punohet me mënyra të vjetra... (nga xhepi ai nxori gazetën dhe e tregoi) në kantinat e Bordosë, në tirat e Sherburgut, apo në disteleritë e Tuluzës...

Mua m'u bë mendja pëershesh nga ato që dëgjoja, kur Sadushi vijoi:

— Prodhimi duhet vënë mbi baza moderne!

— Lërna me ato èndrra, — ja ktheu i ati — nuk shkojnë këtu marifetet e frëngut, këtu i thonë rripi i kuq i djallit... shtrëngo rripat që të bësh hair...

Beu i madh kërkoi me sy anembanë, pastaj dalloi një kazan bakri të vendosur përmbyss, nuk e zgjati, por u ul mbi të. Që atje filloj të fliste... kur papritur më dalloj mua nëpër këmbët e të mëdhenjve:

— Po ky karkalec, ç'kërkon këtu?

Unë ngeca e s'dija ku të futesha, kur ai ju kërcënua qehajait:

— Apo mbledh me hundë kokrrat e rrushit?

Beu mbushi çibukun me duhan dhe kërkoi zjarr.

I biri nxori nga xhepi një shkrepse, xha Ristoja rendi pas buteve dhe u lëshua këtej me një urë zjarri ndër duar. Beu i madh e vështroi shtrembër të birin dhe pranoi urën e zjarrit që i zgjati qehajai i tij.

Si thithi nja dy herë çibukun, Yzeir beu kërceu përpjetë nga kazani. Në pantallonat prapa i ishte vu-losur një rrumbullake e zezë, ai thirri:

- Xha Risto? Si je «me dorën» këto ditë?
- Mirë, bej efendi.
- Atëhere shko në kënetë e hidh pezaulin, na duhen meze.

- Po... cironj ka tashti, bej efendi.
- Na... hajvan që je, po ti hyrë më thellë, unë dua krape, pres miq këtu, në kapsh ngjala, je qehjai më i shquar dhe tashti... lavdi allahut që jemi bektashinj! Do ta pi një herë mushtin si merhumi baba....

Në rrëzë të një buti Risto qehajai shtroi një rrogoz të ri. Yzeir beu u ul atje, pastaj u shtri në shpinë sa gjatë e gjerë, dhe, ashtu si bën viçi me sisën e lopës, kapi me gojë rubinetin e drunjtë e fill pastaj me ca sy të zgurdulluar, ja bëri me shenjë qehajait. Ky rendi e çeli rubinetin. Beu nisi të pinte musht me gllënka të mëdha e të dendura duke gulçuar si derr e duke gogësitur si panterë. Plëndësi i lëkundej dhe në grykë molla e Adamit i vente e i vinte si sovajkë e ndonjë avlëmendi të prishur. Pastaj sytë i kërcyen përpjetë, barku i ngjallur nisi t'i dridhej e një cërkë e kuqe i rrodhi pas faqeve bullafiqe e nisi t'i derdhej grykës.

M'u duk atëhere sikur beu po pinte gjak e s'kish-te të nginjur. Pastaj ai i ngriti këmbët në erë e i përpoqi. Risto qehajai rendi e ja mbylli rubinetin

dhe beu u ngrit çakérqejf, i qeshur, i gëzuar, me  
këmbët që i merreshin:

— Lavdi allahut që jam bektashi! — dhe, duke  
vështruar anembanë, ai bërtiti si egërsirë: — Po ju  
të gjithë ç'më jeni mbledhur këtu si grerat, hë?  
Qërromuni! Në punë!

Njerëzit u shpërndanë. Vajzat ulën kryet dhe  
ja filluan shtrydhjes, një tog burrash dalin përjashta,  
unë u struka në një qoshe, kurse Stefani, mu atje  
në krye të korridorit, nisi përsëri punën e vet duke  
qëlluar me çekan rrathët e një buti të madh: «Dang!  
Dang! Dang!»

Sadush beu, me kapelën e liceistit në kokë, kaf-  
shonte buzën e poshtme dhe bënte çmos që të mos  
queshte. Ai po tallej me të atin faqe bujqve të tyre  
gjysmatarë:

— Nuk pihet mushti alla turka si puna e shta-  
zës, babait po i rrjedhin trutë, bëhet qesharak pa  
shkak.

Si duket, beut të ri i bëri përshtypje ftyra gaz-  
more dhe krenare e Stefanit dhe ju drejtua:

— Po ju, djalosh... rrush shtrydhni këtu?

— Jo, — ja ktheu Stefani — unë merrem me  
butet që rrjedhin...

— Bukuri, bukuri; të punosh nën zhurmën e  
rrushit që shtrydhet, éshtë diçka... si ta them...  
Po ju mos u habitni me atë, vate punë e tij, këtu ka  
shumë gjëra pér të ndreqr, djalosh; më pëlqen  
pamja juaj, ne do të jemi miq e shokë...

Ai nxori nga çanta një diçka. Ajo ishte e mbë-  
shtjellë me një letër të hollë e, kur ai grisi letrën,  
u duk një gotë e bukur kristali. Beu djalosh vështroi  
një herë gotën, pastaj hodhi sytë nga vargu i vaj-  
zave të gjunjëzuara dhe ju drejtua Amalisë:

— Ju lutem, vajzë, ma lani pak këtë gotë?

Amalia u turbullua, por u ngrit. Një fletë larushe rrushi i varej mbi kraharor. U dukën pulpat e saj të xhveshura e të përskuqura nga të ndenjurit gjatë më gjunjë. Mori gotën dhe u nis për ta larë diku, prapa buteve. Por në këtë çast të qëlluarat e Stefanit mbi rrathët e hekurt u bënë më të dendura, pastaj më të forta, zhurma e tyre u bë e padurueshme, e çjerrë e pastaj... fare papritur një rrapëllimë e egër. Nga të qëlluarat një rreth i hekurt u këput e ra përdhe. Sadush beu u skuq në fytyrë, po u shti si i qetë. Pyeti djalin:

— Si ju quajnë, djalosh?

— Stefan.

— Pra rrathi u këput, Stefan?

— Po, u këput.

Sadush beu u kërrus, e mori me duart e veta rrethin e këputur, e vështroi, e peshoi, e hodhi tej dhe tha:

— Natyrisht, rreth hekuri i ndryshkur, me dy rumba të vetëm, por unë sot solla rrathë të rinj. Hej! Xha Risto! Sill një nga ata rrathët e rinj!

— Si urdhëron!

— Po vëre re mirë, të jetë me katër rumba të perçinosur.

— Si urdhëron.

Yzeir beu ishte ulur përsëri mbi kazanin e vënë përmbyss dhe po fërkonte tëmblat me duar. Diç pë- shpëriste, e më dukej se llomotiste gjithnjë:

— Lavdi zotit që jemi bektashinj!

Por ja se Sadushi i ri, ngriti kryet me rrëmbim:

— Gotën... ç'u bë vajza?

Në atë çast Amalia doli këtej duke pasur në dörë vetëm fronin e gotës, kupëza ishte thyer.

— M'u thye — tha ajo e uli sytë.

Risto qehajai kérceu:

— Do ta paguash shtrenjtë.

Por Sadushi i bërë spec në fytyrë u përmbajt:

— Asgjë, asgjë, — tha ai — im atë për këtë gotë kristali do të kërkonte kokën e një vajze, por nuk trajtohen njerëzit me egërsi, xha Risto. U thye gota? Punë e madhe. U këput rrethi i hekurt? Ne i vëmë një rreth tjetër... merci, vajzë, merci... s'ka gjë

Yzeir beu pa ditur se çka ndodhët ngriti zërin:

— Xha Risto, atë butin e madh me musht ta prisni me alësivë, hidhni brenda edhe ftonj, e dua atë musht për nuset e miqve...

Duke ju afruar Stefanit, djaloshi bej i hodhi dorën në krah dhe e hoqi nga puna. Yzeir beu me këmbë që i dridheshin doli jashtë. Të dy djemtë vënët e vinin nëpër korridor nën sytë e vajzave që shtrydhnin rrushin. Kishin të dy njerëzit. Ishin të dy të pashëm e të bukur, por krejt ndryshtë nga njëri-tjetri. Fliste Sadushi:

— Kurrë të mos më thërrisni «Sadush bej», nuk më pëlqen. Në Francë fisnikët i thërrasin me disa emra më të bukur dhe më të denjë, këtu te ne na përpijnë emrat turkoshakë. Po babai im trutharë, Stefan, i ka të shkurtëra. Ne do të punojmë bashkë, do të vendosim këtu rregulla të reja dhe të qyettëruara. Ja për shembull, bujqit këtu nuk e kuptojnë dot figurën e jashtme të njeriut; me pagesat më të para unë do të ble për të gjithë veshje e mbathje për të qenë, ju visheni sikur jetoni në Madagaskar...

— Po nuk na del hesapi — e ndërpren Stefani.

— E sheh! Ju gjithnjë aty e sillni fjalën. Njeriu

e pamësuar e mbyt grykësia, por s'kemi faj, jeni mësuar me shekuj kështu. Por duhet ndryshuar jeta, bota shkon përpëra, s'duhet menduar vetëm për të ngrënë...

— Domethënë se ju keni ndër mend të na shtonit të ardhurat? — pyeti Stefani duke dashur ta shohë beun në sy.

— E sheh! — ja ktheu Sadushi. — Kësaj i thonë të mos kënaqesh me atë që ke... Hej! Hej! — i bërtiti ai Risto qehajait. — Ç'do të bësh me atë toshe?

— Do të përziej bërtistë në tirë — ia ktheu plaku.

— Mirë, mirë, po më parë pastroje mirë toshen... Stefani përsëri nguli këmbë në të tijën:

— E kishim fjalën në të ardhurat, Sadush...

— Ajo është një punë tjetër, e cila duhet parë me nge, por unë për ty, djalosh, kam menduar diçka të bukur, të madhe. Ti këtu më dukesh, dhe je, krejt ndryshe nga të tjerët. Kur ndërrohen brezat, vjen një epokë e re, gjithnjë të rinjtë, bijtë janë kundër të vjetërve, kundër etërve. Edhe ne. Ikën Yzeir beu, vjen Sadushi modern dhe oksidental, po bashkë me Yzeir beun i duhet vënë druri dhe Risto qehajait. Ai është një Sanço Panço. Në vend të Ristos vjen Stefani, djaloshi, i riu, energjiku...

Stefani u prish në fytyrë dhe u shkëput nga Sadushi.

— Ku po shkon? — e pyeti habitshëm pronari.

Nga fytyra Stefani dukej sikur po i vinte të trazuar. Sadushi, duke mos marrë përgjegje, përsërishte pyetjen:

— Ku po shkon, Stefan, ku?

Ndërsa ai, krenar dhe i egërsuar, duke shtrën-

guar dhëmbët dhe çekanin, filloj përsëri të qëllonte me duf dhe egërsi rrathët e hekurt.

Jashtë vesonte shi, kurse larg, tutje nga malet, një napë ngjyrë plumbi varej përmbi qiell dhe nuk i linte të dukeshin majat e maleve. Dhe vetë qielli ishte i shtrembër, i ulët, i turbullt, dhe si i kredhur në tym. Vinte era batak dhe dru i kalbur.

\*

\*

\*

Të nesërmen, sapo hapa sytë, ndjeva të ftohtë dhe ajrin të rënduar dhe të lagësht. Menjëherë vëshët sikur më buçiten nga një zhurmë e madhe. Dola te xhami i dritares së vogël. Qielli ishte pus i errët, kurse fshatit i qe vërtitur lumi i fryrë tej çdo mase, i turbullt, i egër, zhurmëmadh. U habita nga gjithë ato ujëra të ndërkryera të mbushura me llum e me driza, me bajga e me kashtë të kalbur. Nga vërshimi i lumenit, fshati ishte ndarë me dysh dhe çdo lidhje midis të dy lagjeve të tij ishte krejt e pamundur. Unë shtypa hundën pas xhamit e atëhere dëgjova britma njerëzish dhe blegërima bagëtish. Nja njëzet kokë dele po lëkundeshin e përplaseshin nëpër valët e lumenit të rrëmbyer, kurse zëri i Stefanit u ngrit mbi të tjerët. Unë e dëgjova qartë kur ai tha:

— Dje na erdhi beu të na shtrydhë, sot erdhi lumi të na marrë! .

Që këtej dukej bregu tjetër i lumenit. Atje ishin plot njerëz. Ata deshën të hidheshin në këtë anë për të punuar në korridorin e madh ku shtrydheshir rrushtë, por kjo ishte krejt e pamundur. Dhe midis asaj turme të vogël, unë dallova qartë sytë e mëdhenj

të Amalisë. M'u bë sikur edhe ajo më dalloi mua dhe pikërisht për mua ngriti lart dorën e saj dhe më pëershëndeti. Diku që nga korridori u dëgjua zëri i Yzeir beut që bënte të dëgjohej në anën tjetër të fshatit. Ai thoshte:

— Djalli t'ju marrë! Djalli! Merreni andej me punë të tjera!

Por shkoi mëngjezi, pastaj kaloi mesdita, shiu s'kishte të pushuar dhe ujërat e lumit nuk kishin ndër mend të binin më poshtë. Në këtë kohë që nga bregu tjetër, përmes rrropatjes së dallgëve të lumit, dëgjoheshin thirrjet e një kënge të kënduar nga zëra burrash. Më dhanë edhe mua një copë thes të vjetër, mbulova kryet me të dhe renda te korridori i madh i tirave. Por nuk munda të hyja në hajat, se atje dukej beu që vente e vinte duke sharë e mallëkuar, prandaj u futa nën hajatin e vogël të çesmës. Edhe atje kishte plot voza dhe unë gati u fsheha nëpër to. U ula në postafin e drunjë dhe prita të largohej beu. Por ai doli përpara me një dylbi në duar. Me të shihte në bregun tjetër. Pastaj dëgjova qartë, kur i foli Risto qehejait:

— A e sheh, o truthorë? Andej po bëjnë orgjë me kamjen time, u ramë në dorë butet e mbushura dhe kazmën kanë për t'u vënë, do t'i zbrasin nga vera dhe do të m'i rrafshojnë me ujë...

— Kurse me sa di unë, — ja ktheu Risto qehejai — andej kanë shkakun e një dasme...

— Çfarë dasme, mor matuf, dasmë në këtë kohë?!

— Po, po, bej efendi, ditët e tjera njerëzit rendin për punë, sot s'kanë se ç'bëjnë, kështu e kanë këta...

Por edhe beu i ri, i cili qëndronte e shihte me dylbi në anën tjetër, edhe ai mori krahun e të atit:

— Janë prishanikë të pështirë, e prishin kamjen e tjetrit dhe s'e kanë për gjë.

Në këtë çast ndodhi diçka që u dha zjarr dama-rëve të beut të ri. Në bregun tjetër u duk Amalia. Dalloheshin leshrat e saj të zeza, ngjitur pas kokës së lagur, dukej fustani i saj larush i ngjitur pas trupit dhe gjithë ajo vajzë e bëshme dhe krenare, duke mbajtur në dorën e djathtë një broke të mbushur me musht të kuq, e ngriti lart në erë si një shenjë fitimi, urimi, apo grishjeje...

Sadush beu i hodhi dylbinë të atit dhe u vërsul nga ahuret tej korridorit. Këmbët i merreshin, zver-kun e kishte të kuq. Dukej që edhe ai e kishte pirë mushtin pa kursim.

Pas pak erdhi; për dore mbante frerin e kalit, kurse pela e zezë, e kashaitur dhe e lastuar me shalën e kuqe sipër, me saraposhin e bardhë, turfullonte e nuk përmbahej. Yzeir beu i doli përpëra të birit dhe i foli:

— A je në vete, djalë?

Por Sadushi nuk përmbahej:

— Nuk mbrohet pasuria me llafe, baba, do të më shikosh se cili jam...

Sadushi kërceu mbi shalën e pelës, i rrahu kaf-shës barkun me thembrat e këmbëve dhe e nxiti të nisej. Por sa u gjend në breg të lumit, pela u step. Atëherë Sadushi ia lëshoi me kamxhik vitheve:

— Përpëra, e mallékuar!

Pela turfulloi edhe një herë, u ngrit pas përpjetë mbi këmbët e pasme dhe hingëlliu me të madhe. Por Sadushi nuk i ndahej, ai ia qëlloi barkun me mamuzet, ia përcëllói vithet me kamxhik... Pela, desh, s'desh, u bind. Por ajo nuk mund të ecte atje, lumi ishte i madh, i fryrë dhe kafsha nisi të no-

tonte drejt bregut tjetër duke pasur në shpinë bej-  
çen e ri me musaqen e hollë, me syrin xixë, me kam-  
xhik ndër duar dhe me thembrat e këmbëve si të  
ndezura.

— Përpara, e mallëkuar!

Lumi frynte e shfrynte, dallgët përplaseshin mbi  
njëra-tjetrën, kurse matanë Amalia ende mbante ndër  
duar lart, atë broken e bardhë me musht të kuq!

Te çesma nën korridor, gjindja mori zjarr. Ku-  
shërirri Stefan u bë i papërmajtshëm. U zgjatën di-  
sa duar ta ndalonin, u dëgjuan disa thirrje që ta që-  
ndronin, por ai u dha bërryleve, shtyu kë mundi, tre  
bute u rrokullisën, pastaj u përpoqën, zhurma e tyre  
e zemëroi beun e madh, por Stefani nuk përmbahet.  
Ai hungroi si ujk dhe bërtiti si ndonjë bishë e pla-  
gosur. U fut në korridor dhe doli. Në duar mbante  
një lopatë druri, pastaj iu afrua çesmës; këtu me  
një të tërhequr shkuli nga vendi postafin, dhe e  
zvarrisi. Po në këtë çast Yzeir beu bërtiti me lemeri  
duke çuar krahët lart.

E gjithë turma vështroi drejt lumit të rrëm-  
byer. Edhe Stefani nguli lopatën në mes të postafit  
dhe ngriti kryet. Lumi ulërinte, shiu mbi të dhe  
në mes të dallgëve të turbullta pela me gjithë kalot-  
rësin po vinin vërdallë.

— Ranë në gjeneratorë! — bërtiti dikush.

— Djalën! Djalën! Amani, miq, vëllezër, shpë-  
tomëni djalën! — po thërriste e bërtiste Yzeir beu.

Stefani shtrëngoi dhëmbët e rrudhi ballin. Ashtu,  
nofullat e tij, u dukën edhe më të gjera. Ai s'po luante  
vendit. Yzeir beu iu lëshua:

— Merre kalin tim, o bir, merre dhe vërvitu,  
shpëtomë djalën...

Stefanit ju drodh mjekra dhe vështroi me inat:

— Jo, jo, bej, se bejllëku juaj nuk lejon që harbuti të hipë në kalë...

— Po unë po ta jap, unë...

— Nuk dua.

Beu desh të lutej edhe më, por në mes të dallgëve të lumit gjendja ndryshoi. Pela u shkëput nga vorbulia dhe u lëshua drejt bregut tjetër. Tani dalloheshin vetëm koka e kalit dhe koka e Sadushit.

Atëhere Stefani u vërvit; e shtyu postafin në ujë, ja hipi sipër dhe, duke ngulur majën e lopatës në breg... u shkëput. Ujërat e rrëmbyen menjëherë.

Si një gogël e lehtë, si një gjysmë arre e vogël, postafi kërcente rrëshqitaz përmbi format e turbullta të ujit të rrëmbyeshëm. Dhe Stefani e arriti Sadushin afër bregut tjetër. U duk se ata do të zinin tokë të dy njëherësh, por nga një vështrim që hodhi anash beu i ri u tërbua dhe ngriti lart kamzhikun. Duket që ata diçka i bërtisin njëri-tjetrit. Veç kuptohej se në fjalët që shkëmbenin shfrynin duf dhe urrejtje për njëri-tjetrin. Postafi i kaloi fare pranë Sadushit dhe beu i ri s'e bëri të gjatë. Ai ngriti lart kamzhikun dhe e qëlloi Stefanin mu në fytyrë. Bishti i kamzhitkut u përdrodh pas fytyrës së djalit dhe (mënyrë e çuditshme) Stefani e kapi me dhëmbë. Sadushi bëri ta tërhiqte, por nofullat e Stefanit ishin të shënshosha. Atëhere beu zgjati dorën, e kapi postafin dhe... i rëndoi. Stefani humbi drejtpeshimin, bëri të përmbahej, por nuk mundi. U përblys në ujërat. Dallgët rrëmbyen britmën e tij. Por tashmë atje ishte cekëtina, këmbët i zunë tokë.

I pari doli në breg Stefani. Dukej më i hollë dhe më i gjatë, sytë i kishte të nxirë, kurse kamzhiku i varej në gojë si gjarpër. Sadushi doli në breg duke u zvarrisur pas kalit, pantallonat prej stofi të mirë

i dukeshin si lëkura e qullur e një maçoku. Sa i zunë këmbët tokë, ai e pështyu Stefanin sy më sy. Por Stefanin nuk iu nda. E ngriti lart kamzhikun dhe e lëshoi me një forcë të tillë, sa fishkëllima u dëgjua gjer këtej bregut. Beu i ri u drodh, por edhe ky kapi me dhëmbë lëkurën e kamxhikut e nuk e lëshoi. Kur kamzhiku i ngeli qarkuar në fytyrën e beut, Stefanin e tërhoqi me vrull. Ashtu Sadushi erdhi rrotull si fugë duke u shpërdredhur.

Por unë isha vocrrak e përleshjen nuk e shihja dot, sepse valët e lumit që buçiste e ulerinte, ngrishin lart, epoheshin, binin e gulçonin e mua më dukej se po lëkundej bota e téré bashkë me atë logun ku po rriheshin ata... Sadush Vila e Stefan Pila!

Përfytja vazhdonte. Dhe, kur ujërat e lumit ranë, vetëm atëhere, në kumin e bregut tjetër, unë dallova gjurmët e asaj përleshjeje. Dallova gjurmët e këmbëve, gjurmët e shpatullave, gjurmët e përplasjeve, të urejtjes dhe të tèrbimit.

---

## THELËZAT E MOLLËS

Një ditë shkova të mblidhja lajthi në pyllin afër fshatit, por, sado që kërkova, nuk gjeta asnje kokërr. Patjetër që lajthitë i kishin mbledhur të 'tjerrë, ose i kishin ngrënë dhitë. Desha të shkoja më tutje nëpër pyjet, por isha vetëm, isha ende i vogël dhe nuk ma mbante. Kështu që nisa të sillesha pas kopshteve që ndeheshin në të dalë të fshatit. Nëpër kishte mollëdheu, por këtu edhe s'ishin arrirë, se pse ende nuk kishin lëshuar atë lulen e verdhë, aq kreko dhe aq të bukur. Piva ujë në dy-tri burime, sa m'u fry barku dhe atëhere e ndjeva më fort urinë. Kështu që u shtriva ndën vrimën e një gardhi dhe zvarrë-zvarrë hyra në një kopsht. Kopshti ishte i mbjellë me rila; rilat ishin rritur gati dy pash burri njëra, bishtajat e tyre ishin mbushur me kokra gjelbëroshe, të njoma dhe të shijshme. Që të mos më shihte njeri, hyra më thellë, kur... papritur ndjeva një diçka që zvarrisej. Dikush po ikte fshehtas nëpër kopsht. Në një çast u tremba, por pastaj u vendos qetësia dhe unë mendova se ndoshta do të kishte qenë atje ndonjë mace apo ndonjë shpend. Laku-

tëria ime po më shkonte mbarë, kur ndjeva një erë të rëndë duhani. Ktheva kryet aneqark, vështrova, nuhata, u zvarrisa më tej, kur... zbulova një diçka krejt të papritur. Brenda tumbës me rila, rrënjet e bimëve ishin shtruar përdhe dhe dukej atje një farë strofke, aq sa mund të shtrihej më krahëzaj një burrë. Kur hapa sytë mirë, dallova atje plot bishta cigareje dhe fije shkrepshesh. Me siguri që atje do të kishte mërzyer ndonjë njeri për kushedi sa ditë. Nuk dija se si ta shpjegoja këtë dhe, pasi u ngjesha mirë me rila nëpër xhepat e në gjii, krisa e ika i trembur duke vështruar herë djathtas e herë majtas, por më shumë prapa.

Të nesërmen në mëngjez, shkova në shkollë. Si ju kam thënë edhe tjetër herë, shkolla jonë asaj kohe ishte një dhomë përdhese, që teto Kalia ja kishte lëshuar fshati me qira. Pas dhomës ishte një korridor i ngushtë e pas korridorit ishte kthina ku banonin teto Kalia dhe vajza e saj, Lirika, që ishte moshatare me ne dhe së bashku e mësonim abetaren.

Kalia ishte një grua, atëhere nga tridhjetë vjec, e shkathët dhe e menduar gjithnjë. Nën dritaret e shkollës sonë ishte rruga nga ku kalonin fshatarët për në mal. Dhe, kur kalonin njerëz nëpër rrugë, nedallonim fare mirë nëse ishin çape burri apo çape djali, nëse ishin çape mushke apo kali. Teto Kalia herë rrinte e tirrte shtëllunga me lesh atje në krye të klasës dhe mbante vesh se si mësonim ne, herë lante këmishët apo pikte lakinorin, kurse, herë të tjera niste e vetëkuvendonte për një njeri e për disa gjëra që unë nuk i kuptoja dot. I shoqi i Kalisë kishte shkuar në kurbet shtatë, a tetë vjet më parë dhe s'kishte ardhur asnjëherë për të parë vajzën e tij që ishte shoqja jonë. Por babai i Lirikës, sikurse thuhei nëpër

fshat, i shkruante disa letra të rënda së shoqes dhe i kërkonte një dokument ku teto Kalia të firmonte se nuk e kishte dhe nuk e njinte për burrë Tolin e Dhimës. Por Teto Kalia nuk ua vinte veshin këtyre letrave, që i vinin në krye të çdo muaji dhe fliste shkoqur nëpër fshat:

— Ai, në është burrë, le të vijë dhe të më ndajë këtu, në i paska marrë koka erë e të martohet andej nga theu qafën. Në djall të vejë!

Por asaj dite teto Kalia ishte shumë e mërzitur dhe nuk zinte vend. Ajo vente e vinte nëpër shtëpi dhe nuk fliste fare. Ne mësonim abecenë, mësuesja vinte bankë më bankë dhe na shihte pllakat e zeza ku ne mundoheshim të zhgarravisnim shkronjat e alfabetit, kur... që nga dritarja e korridorit, u dëgjuar zëri i teto Kalisë, i ashpër dhe i egër. Ajo dikë po shante e po mallëkonte në rrugë. Njeriu që po hante të sharat po bënte çmos që të mbrohej duke i folur:

— Po dale, moj e uruar, po mblidh mendjen, moj e gjorë, po ç'pate me mua, moj Kali zeza!

Po teto Kalia thërriste e cirrej, e shante njeriun që hipur mbi kalë shkonte në mal për dru.

Si kam dëgjuar dhe kuptuar më vonë, e gjithë puna na paskësh qenë se... Tole Donaçi, natës së më-parshme i kishte shkuar teto Kalisë te deriçka e pasme e shtëpisë dhe e kishte shtyrë, duke dashur të hynte tinëz brenda...

— Të pashë, ore, të pashë, — cirrej e bërtiste Kalia — të pashë ja me këta sy, kur s'e hape dot, more rrugën e ike... A s'ishe ti me kapelë të bardhë, a s'ishe ti me opinga të lehta, a s'ishe ti? Turp të kesh, turp!

Në fshat u bë tevaturë për këtë ngjarje të rrallë. Tole Donaçi nuk u mbyll në shtëpi. Përkundrazi, ai

me kokë të zbuluar dhe me zë të ngritur mbrohej rrugëve të fshatit nga të gjithë ata që e takonin:

— Fëmijët t'i gjej shtrirë në shtëpi... — betohej  
— shtrirë t'i gjej, as që më ka shkuar ndër mend kurrë!

Erdhi mbrëmja. Mbi fshat ra nata. Në oborrin tonë nënëgjyshja kishte ndezur furrën me dëllinja të thata, kurse mamaja ime kishte gatuar bukët, i kishte mbuluar me disa kuverta të leshta që të vinte brumi. Në këtë kohë teto Kalia po zbriste nga mali, gati e palosur më dysh nga barra e rëndë e druve, që kishte ngarkuar mbi shpinë. Marika e njomë, fëmijë e mitur, e ngarkuar edhe ajo me dru, po vinte pas së ëmës.

Hëna apo nxori vetullën e saj mbi malet e Pisoderit, dele të shkëputura po rendnin nëpër rrugët, ujërat e lumit po ndiheshin më shumë. Por hëna s'po dukej e plotë, sepse ende s'ishte ngritur përmbi çatitë e shtëpive të fqinjëve.

Teto Kalia shkarkoi barrën e vet, tërhoqi litarin këtej, u mbush me frymë dhe ktheu kryet prapa. Nja njëzet çape më tej, u duk një si lëmsh i përciptë që sikur po zvarrisej nëpër udhën e ngushtë. Anash ngriheshin tumbat e dendura të manaferrave, ku fishkëllinen bulkthit e natës. Lirika po gulçonte, zemra e saj e vogël rrihte nxituar nga mundimi dhe nga barra e rëndë, gjymtyrët e saj të njomë dridheshin. Po arrinte në oborr. Ajo nuk trembej nga hijet e zeza që lëkundeshin nëpër tumbat e manaferrave, edhe xixëllonjat endacake, që i prisnin rrugën, nuk i linin asnje vragë. Ajo ishte e mjerë, sepse e kishte përfshirë uria sa i dridheshin gjunjët dhe ndjente një farë djegësire përmbi të përparmen e kraharorit të saj vocrrak. Ishte një fëmijë e mjerë, e mësuar të luftonte me skamjen.

me vuajtjen dhe me urinë që në moshën e ëndrrave, të gjumit dhe të qumështit të nënës.

Teto Kalia pshërëtiu dhe ngriti duart për të rregulluar shaminë e zezë të kokës, kur... diçka krejt e papritur dhe e paparë i ra mbë ftyrë!

Ishte një gulsh drite! Një shuk rrezesh të bardha drite elektrike i ranë mbi ftyrë. Pas befasimit të parë, duke tkurrur rrathët e syve, ajo dalloi turbull një njeri që doli papritur te qoshja e shtëpisë dhe mbante në duar atë diçkanë që lëshonte ato rrezet e bardha të dritës.

Kalia ngriti duart mbi ftyrë si për t'u bërë hije syve të saja, për të parë e dalluar, kur... njeriu që kish përpala foli:

— S'më njeh, a?

Nga zëri ajo u habit edhe më shumë dhe u drodh. E çuditshme! Njeriu që kishte përballë, ishte burri i saj!

— Nuk më njohe, a?

Ajo u nis drejt tij:

— Ti! Ti, Kolë, je?

Fatkeqja desh ta përshëndoshte, sidokudo, letrat e marra, apo fjalët e dërguara me gojët e botës...

«...E ç'na duhen ato, kur ai erdhi vetë, tan po, burrë e grua gjithshka e zgjidhin...»

— Koli! Ja edhe Lirika po vjen, ja...

Ajo i tregoi me dorë fëmijën e tyre, por ai tashmë ishte një njeri i zvetënuar. Atë e kishte rrëmbyer vala e atij vendimi që kishte bluar me kohë në kokën e tij.

Dhe teto Kalia dëgjoi se si shpërthyen disa krisma të forta e të thata, disa lloj xixash dilnin që diku nga duart e të shoqit, e pastaj ajo e kuptoi. Ai po e vriste. Ato farë kafshimesh të panjohura në trup,

ato si rryma të nxehta që i hynë në mish, ishin plumb...

Kalia ndjeu t'i mpihej krahu i majtë, pastaj i djathiti, gjunjët ju lëkundën dhe vështrimi ju drodh. Ajo ra dhe u përmbyss pér tokë.

Nëpër fshat u përhap lajmi i vrasjes. Unë u struka sa më thellë nën velenxen e trashë dhe menjëherë më shkoi mendja te strofka që kisha parë asaj dite kur vidhja rila në kopshtin jashtë fshatit.

Të nesërmen bashkë me shokët dhe shoqet e klassës u nisëm pér në shkollë.

Nën dritaret e shkollës sonë dalluam disa thelëza rrumbullake prej molle. Dhe këto thelëzat rrumbullake ishin të ngjyera në gjak. Brenda gratë e fshatit qanin mbi të vdekurën. Dikush na tha se gjatë natës gratë ishin munduar ta shpëtonin tetë Kalinë duke i vënë mbi plagët thela molle.

Dhe fytyra e Kolë Dhimës, një fytyrë e panjohur dhe e paparë ndonjëherë, m'u ngul në kokë si surrati më i egër dhe më i shëmtuar që pér herë të parë më bëri ta jetoja atë dramën aq të egër e aq të dhembshme të vrasjes.

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Nënolja dhe unë .....	3
«Për shpirt të atij që mbeti majë hurit» .....	24
Kur punoja me qerren ndërkombëtare .....	32
Papa Jani .....	44
Ne dhe Gago Morramani .....	54
Zogu i zi .....	81
Sepeti i bardhë .....	87
Trokthet e kuajve nëpër natë .....	95
Gramafoni, xhaxhai dhe nusja e tij bardhoshe .....	107
Në acarjn e një dimri .....	115
Dhimitër taksirati .....	120
Kur shtrydheshin rrushtë .....	134
Thelëzat e mollës .....	151